ОУРЦ „ИДНИНА“ - СКОПЈЕ

Touch the Goal
Football for Every Child
Фудбал за секое дете

Lloreta Andreevska
Katerina Veliçkovska
Irena Novaçeska Makaloska

TOUCH THE GOAL
PREKE GOLIN

Doracak praktik për krijimin e mjediseve sportive gjithëpërfshirëse përmes futbollit

Lloreta Andreevska
Katerina Veliçkovska
Irena Novaçeska Makalloska

TOUCH THE GOAL
PREKE GOLIN

Doracak praktik për krijimin e mjediseve sportive gjithëpërfshirëse përmes futbollit

Me mbështetjen e Federatës së Futbollit të Maqedonisë (FFM)
dhe UEFA Foundation for Children (Fondacioni i UEFA-s për fëmijët)

Shkup, 2026

Redaktore:
Lloreta Andreevska

Bashkëpunëtore profesionale:
mr. Irena Bakrevska Milloshevska, Federata e Futbollit e Maqedonisë (FFM)

Autor i programit të aktiviteteve të futbollit:
Zoran Pançevski

Përkthimi:
Lindita Daci, Adelina Haskaj

Dizajni grafik dhe përgatitja për shtyp
PRINT TIM SHPK SHKUP

Fotografi dhe ilustrime
Fotografitë nga stërvitjet: arkivi fotografik i ShFQR „Idnina“ – Shkup. Gjatë përgatitjes së kartelave të komunikimit janë përdorur disa nga piktogramet e ARASAAC. Autor: Sergio Palao. Burimi: https://arasaac.org. Bartësi i të drejtave: Gobierno de Aragón (Qeveria e Aragonës), Spanjë. Licenca: CC BY-NC-SA.

Realizimi i „Touch the Goal“
Me mbështetjen e Federatës së Futbollit të Maqedonisë (FFM) dhe UEFA Foundation for Children (Fondacioni i UEFA-s për Fëmijët)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem kërkimi të të dhënave ose të transmetohet në çfarëdo forme dhe me çfarëdo mjeti (elektronik, mekanik, me fotokopjim, inçizim ose në ndonjë mënyrë tjetër), pa pëlqimin paraprak me shkrim të autorëve dhe botuesit.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

796.332:37.043.2-056.26/.36(035)

АНДРЕЕВСКА, Лорета
Touch the goal = Допри го голот : практичен прирачник за создавање инклузивни спортски средини преку фудбал со поддршка од Фудбалската федерација на Македонија (ФФМ) и UEFA Foundation for Children (УЕФА Фондација за децата) / Лорета Андреевска, Катерина Величковска, Ирена Новаческа Макалоска. - Скопје : ОУРЦ Иднина, 2026. - 124 стр. : илустр. ; 25 см

Клучни поими: стр. 110-111. - Библиографија: стр. 112. - Содржи и: Анекс 1-5

ISBN 978-608-66772-1-3

1. Величковска, Катерина [автор] 2. Новаческа Макалоска, Ирена [автор]
а) Фудбал -- Инклузивно образование -- Деца со попреченост -- Прирачници

COBISS.MK-ID 69969157

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE 5
Nga nevojat e identifikuara te zbatimi praktik 7
KUJT I DEDIKOHET DORACAKU 8
SI TË PËRDORET DORACAKU 8

KAPITULLI 1.
FUTBOLLI SI HAPËSIRË PËR PJESËMARRJE, BASHKËPUNIM DHE PËRKATËSI 9
1.1. Nga prania te pjesëmarrja aktive dhe e rëndësishme 9
1.2. Mundësi të ndryshme, mënyra të ndryshme pjesëmarrjeje 11
1.3. Futbolli si mundësi për komunikim, bashkëpunim dhe lidhje 12
1.4. Dinjiteti, zgjedhja dhe kontributi individual i fëmijës 14
1.5. Parimet bazë për planifikimin dhe udhëheqjen e aktiviteteve gjithëpërfshirëse të futbollit ... 16

KAPITULLI 2.
PËRGATITJA E NJË MJEDISI MBËSHTETËS PËR FUTBOLL 19
2.1. Njohja e pjesëmarrësve dhe e nevojave të tyre për mbështetje 19
2.2. Identifikimi i pikave të forta, interesave dhe mundësive të pjesëmarrësve 21
2.3. Identifikimi dhe mënjanimi i pengesave për pjesëmarrje 22
2.4. Planifikimi i një aktiviteti gjithëpërfshirës të futbollit 25
2.5. Hapësira e futbollit që mundëson lëvizje të sigurt dhe pjesëmarrje aktive 26
2.6. Rrugë të ndryshme drejt të njëjtit qëllim në futboll 28
2.7. Gatishmëria për pjesëmarrje: komunikimi, parashikueshmëria dhe mbështetja individuale 30
2.8. Gati për lojë: kontroll praktik para, gjatë dhe pas stërvitjes 31

KAPITULLI 3.
MJETET INOVATIVE TË „TOUCH THE GOAL“ 33
3.1. Kartelat e komunikimit në futboll (Football Talk Cards) 34
3.1.1. Përgatitja për përdorimin e kartelave të komunikimit në futboll (Football Talk Cards) 36
3.1.2. Shembuj të prezantimit të kartelave dhe lidhjes së tyre me veprimin 37
3.1.3. Shembull praktik i përdorimit të kartelave të komunikimit në futboll (Football Talk Cards) 38
3.1.4. Mësimet e nxjerra nga përdorimi i mjetit 40
3.2. Kutia mobile gjithëpërfshirëse POP-UP 41
3.3. Këndi i përshtatur për punë dhe pushim 42
3.3.1. Udhëzime për përdorimin e këndit të përshtatur 44
3.4. Pasaporta për mbështetje nga bashkëmoshatarët 47
3.5. Programi për zbatimin praktik të futbollit të përshtatur 53
3.5.1. Qëllimet e programit 54
3.5.2. Struktura dhe realizimi i programit me 20 stërvitje 54
3.5.3. Aktiviteti përmbyllës – qetësimi pas stërvitjes 56
3.5.4. Përshtatja dhe mbështetja individuale 56
3.6. Përzgjedhja e mjetit të përshtatshëm sipas mbështetjes së nevojshme 59

KAPITULLI 4.
ZBATIMI PRAKTIK I AKTIVITETEVE GJITHËPËRFSHIRËSE TË FUTBOLLIT 65
4.1. Realizimi i aktiviteteve praktike 65
4.2. Modeli për planifikim dhe përshtatje 68
4.3. Aktivitete për njohje dhe ndërtim të besimit 73

4.4. Aktivitete për orientim dhe lëvizje....75
4.5. Aktivitete për zhvillimin e aftësive themelore të futbollit....77
4.6. Aktivitete për komunikim dhe bashkëpunim....78
4.7. Aktivitete për ndërtimin e ndjenjës së përkatësisë....80
4.8. Aktivitete ekipore dhe lojëra bashkëpunuese....82
4.9. Mini-ndeshje gjithëpërfshirëse....83
4.10. Shembuj të një seance të plotë gjithëpërfshirëse të futbollit....90
4.11. Zbatimi në mjedisin shkollor....97
4.12. Zbatimi në shkollat e futbollit dhe klubet sportive....103
4.13. Përshtatja e aktiviteteve në kushte të ndryshme....104

KAPITULLI 5.
NGA PRAKTIKA TE ZBATIMI....113
5.1. Pilotimi....113
5.2. Nga modeli në praktikë: planifikimi dhe realizimi....114
5.3. Zëri i praktikës: përvoja nga projekti....115
5.3.1. Përvoja nga trajnimi i mësimdhënësve të arsimit fizik dhe shëndetësor....115
5.3.2. Përvoja nga stërvitjet dhe aktivitetet e realizuara....116
5.4. Çfarë mësuam: monitorimi i pjesëmarrjes dhe përmirësimi i praktikës....119
5.5. Nga përvoja e projektit te praktika e qëndrueshme....120

FJALËT KYÇE....122
LITERATURA DHE BURIMET....124

SHTOJCA 1.
FORMULAR PËR PLANIFIKIMIN E NJË AKTIVITETI GJITHËPËRFSHIRËS TË FUTBOLLIT....125

SHTOJCA 2.
LISTA E KONTROLLIT PËR AKTIVITETIN GJITHËPËRFSHIRËS TË FUTBOLLIT....127

SHTOJCA 3.
FORMULAR PËR VËZHGIM, PËRSHTATJE DHE REFLEKTIM....129

SHTOJCA 4.
FORMULAR PËR PLANIFIKIMIN DHE ORGANIZIMIN E MBËSHTETJES NGA BASHKËMOSHA TARËT....131

SHTOJCA 5.
FOOTBALL TALK CARDS – KARTELAT E KOMUNIKIMIT NË FUTBOLL....134

SHTOJCA 5.
KARTELA SHTESË NGA ARASAAC....135

EKIPI I REALIZIMIT TË PROJEKTIT NGA SHFQR „IDNINA“ – SHKUP....136

SHKOLLAT DHE ANËTARËT E EKIPIT....136

PARATHËNIE

Shkolla Fillore me Qendër Resurse „Idnina“ – Shkup, krahas punës edukativo-arsimore me nxënësit me aftësi të kufizuara, ofron mbështetje profesionale për arsimin gjithëpërfshirës në 78 shkolla fillore, në 16 komuna të Rajonit të Shkupit dhe Rajonit Verilindor. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me shkollat, nxënësit, mësimdhënësit, asistentët arsimor dhe familjet mundëson të kuptohen drejtpërdrejt nevojat e ndryshme të fëmijëve për mbështetje, duke vënë në qendër mundësitë dhe pjesëmarrjen e tyre aktive.

Nga kjo përvojë lindi ideja për „Touch the Goal – Preke Golin“, një projekt njëvjeçar i Shkollës Fillore me Qendër Resurse „Idnina“ – Shkup, i realizuar me mbështetjen e Federatës së Futbollit të Maqedonisë (FFM) dhe UEFA Foundation for Children (Fondacioni i UEFA-s për Fëmijët). Puna u përqëndrua në krijimin e mundësive praktike që fëmijët të marrin pjesë në aktivitete futbolli, të komunikojnë, të bashkëpunojnë me bashkëmoshatarët dhe të kontribuojnë në lojën e përbashkët.

Në realizim u përfshinë nëntë shkolla fillore partnere dhe Shkolla Fillore me Qendër Resurse „Idnina“ – Shkup, pra gjithsej dhjetë shkolla. U përfshinë 130 nxënës: 117 nga shkollat partnere, nga 13 për secilën shkollë, dhe 13 nxënës nga SHFQR „Idnina“. U trajnuan 18 mësimdhënës të arsimit fizik dhe shëndetësor, ndërsa zbatimi praktik u zhvillua përmes 20 stërvitjeve të realizuara.

Në bazë të nevojave të identifikuara, ekipi i SHFQR „Idnina“ zhvilloi dhe përgatiti mjete inovative, e më pas përgatiti dhe realizoi trajnime për përdorimin e tyre. Puna me nxënësit dhe mbështetja profesionale për shkollat mundësuan që mjetet dhe aktivitetet të shqyrtoheshin në situata konkrete dhe të përshtateshin sipas përvojave dhe reagimeve të marra.

Ky doracak bashkon udhëzimet praktike, mjetet, shembujt dhe formularët e punës që dolën nga bashkëpunimi. Ai është përgatitur si burim afatgjatë dhe i përdorshëm për mësimdhënësit, trajnerët dhe personat e tjerë që ofrojnë mbështetje gjatë aktiviteteve sportive. Filmi dokumentar paraqet, gjithashtu, përvojat e pjesëmarrësve dhe rrjedhën e realizimit.

Qëllimi i doracakut është që përvoja e fituar të mbetet e qasshme edhe pas përfundimit të aktiviteteve, duke mundësuar zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të saj në mjedise të ndryshme shkollore dhe sportive. Në themel mbetet vëmendja ndaj çdo fëmije: çfarë e ndihmon ta kuptojë aktivitetin, të bëjë zgjedhje, të marrë pjesë me bashkëmoshatarët dhe ta ndjejë kontributin e vet në ekip.

TOUCH THE GOAL
PREKE GOLIN

Loja na lidh.
Pjesëmarrja na afron.
Përkatësia na forcon.
Doracak praktik për krijimin e mjediseve sportive gjithëpërfshirëse përmes futbollit
Me mbështetjen e Federatës së Futbollit të Maqedonisë (FFM)
dhe UEFA Foundation for Children (Fondacioni i UEFA-s për Fëmijët)

NGA NEVOJAT E IDENTIFIKUARA TE ZBATIMI PRAKTIK

Fazat e realizimit të „Touch the Goal“

1. **Vendimi i FFM-së për nominimin e ShQRC „Idnina“**
   Përvoja e shkollës dhe bashkëpunimi e mbështetja e vazhdueshme në procesin e inkluzionit (gjithëpërfshirjes) janë baza e kësaj iniciative, me fokus te fëmija.
2. **Hartimi i projektit dhe përgatitja e aplikacionit**
   Zhvillohen qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet e pritura, si dhe dorëzohet aplikacioni për shpërblimin.
3. **Rezultatet nga përzgjedhja për çmimin**
   Shpallen rezultatet e procedurës së përzgjedhjes.
4. **Marrja e shpërblimit**
   Shpërblimi që konfirmon mbështetjen për realizimin e projektit të propozuar.
5. **Fillimi i aktiviteteve të planifikuara**
   Organizohet ekipi, bashkëpunimi me shkollat dhe realizimi sipas planit të projektit.
6. **Dizajnimi dhe krijimi i mjeteve inovative**
   Përgatiten mjetet sipas nevojave të identifikuara për pjesëmarrje, komunikim dhe mbështetje mebashkëmoshatarët.
7. **Përgatitja dhe realizimi i trajnimeve**
   Mëimdhënësit njoftohen me qasjen, mjetet dhe mundësitë për zbatimin e tyre praktik.
8. **Zbatimi praktik dhe monitorimi**
   Realizohen trajnimet, ndiqet pjesëmarrja dhe përshtaten aktivitetet sipas nevojave.
9. **Ndarja e përvojave dhe rezultateve**
   Doracaku, filmi dokumentar dhe mjetet mundësojnë që përvojat të përdoren edhe në të ardhmen.

Figura1. Fazat e realizimit të „Touch the Goal“
Paraqitja e rrugëtimit nga nevojat e identifikuara dhe nominimi, përmes aplikimit dhe marrjes së çmimit, deri te aktivitetet e planifikuara, zbatimi praktik dhe ndarja e rezultateve. Nëntë fazat e paraqitura ndjekin rrjedhën konkrete të „Touch the Goal“ dhe janë përgatitur nga autorët. Referenca për shembullin fillestar vizual me faza: FIFA (2025), FIFA Disability Football Toolkit [Doracaku i FIFA-s për futbollin për personat me aftësi të kufizuara], botimi i shtatorit 2025, f. 50.

Fazat lidhen me njëra-tjetrën dhe pjesërisht mbivendosen, ndërsa përvojat nga zbatimi shërbejnë për përmirësimin e mjeteve dhe përshtatjen e aktiviteteve.

KUJT I DEDIKOHET DORACAKU

Doracaku u dedikohet mësimdhënësve të arsimit fizik dhe shëndetësor, trajnerëve, edukatorëve special dhe rehabilitatorëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe asistentëve arsimor. Mund të përdoret edhe nga ekipet shkollore, organizatat sportive dhe familjet, në bashkëpunim me personat që i udhëheqin aktivitetet.

Ai mund të jetë veçanërisht i dobishëm për trajnerët që punojnë me grupe fëmijësh me aftësi të kufizuara, si dhe për trajnerët që udhëheqin aktivitete të përbashkëta futbolli për fëmijë me dhe pa aftësi të kufizuara. Ofron mbështetje praktike edhe për trajnerët që, në grupin e tyre ekzistues, kanë një fëmijë të cilit i nevojiten udhëzime ose përshtatje shtesë për t'u përfshirë në lojë. Çdo trajner mund të zgjedhë shembujt dhe mjetet që përputhen me programin, kushtet e punës dhe nevojat e pjesëmarrësve konkret.

Udhëzimet nuk lidhen vetëm me një diagnozë apo me një kategori të paracaktuar fëmijësh. Ato zbatohen sipas interesave, mundësive, mënyrave të komunikimit dhe nevojave konkrete për mbështetje të pjesëmarrësve. Shembujt shërbejnë si bazë për përshtatje dhe jo si model i detyrueshëm që zbatohet njësoj me çdo grup.

SI TË PËRDORET DORACAKU

Kapitulli i parë paraqet parimet e pjesëmarrjes të rëndësishme. I dyti trajton përgatitjen e mjedisit dhe të aktiviteteve. I treti prezanton mjetet dhe programin e strukturuar të aktiviteteve të futbollit. I katërti ofron aktivitete praktike dhe mundësi përshtatjeje, ndërsa i pesti i lidh përvojat me zbatimin e mëtejshëm. Shtojcat përmbajnë formularë pune dhe materiale për përdorim të drejtpërdrejtë.

Kapitulli 1

FUTBOLLI SI HAPËSIRË PËR PJESËMARRJE, BASHKËPUNIM DHE PËRKATËSI

Hyrje

Prania e fëmijës në fushën e futbollit nuk nënkupton gjithmonë pjesëmarrjen e tij të vërtetë në aktivitet. Fëmija mund të jetë pjesë e grupit, të mbajë të njëjtën pajisje sportive dhe të ndjekë të tjerët, por përsëri të ketë mundësi të kufizuara për t'u përfshirë në lojë, për të bërë zgjedhje ose për të kontribuar në detyrën e përbashkët.

Prandaj, gjatë planifikimit të aktiviteteve gjithëpërfshirëse të futbollit, është e rëndësishme të përqëndrohemi jo vetëm në faktin nëse fëmija është i pranishëm, por edhe në mënyrën se si merr pjesë, çfarë roli ka dhe nëse kontributi i tij njihet nga të tjerët.

1.1. Nga prania te pjesëmarrja aktive dhe e rëndësishme

Tabela 1. Nga prania te pjesëmarrja aktive

01. PRANIA Fëmija është pjesë e grupit.	**02.** MUNDËSIA Aktiviteti dhe mbështetja përshtaten.	**03.** PJESËMARRJA Fëmija ka rol, zgjedhje dhe kontribut.

Pjesëmarrja aktive dhe e rëndësishme nënkupton që fëmija të ketë mundësi reale të përfshihet në aktivitet në një mënyrë që u përgjigjet aftësive, interesave dhe nevojave të tij aktuale për mbështetje. Kjo nuk do të thotë se të gjithë fëmijët duhet të kryejnë të njëjtat lëvizje, të arrijnë rezultate të barabarta apo të marrin pjesë me të njëjtin ritëm.

Në një aktivitet futbolli, për një fëmijë pjesëmarrje e rëndësishme mund të jetë pasimi i pavarur i topit, për një tjetër ndjekja me sukses e një detyre të paraqitur vizualisht, ndërsa për një të tretë vendosja e komunikimit me bashkëlojtarin ose pjesëmarrja në një veprim të përbashkët me mbështetjen e duhur. Është e rëndësishme që detyra të ketë kuptim për fëmijën dhe të lidhet me aktivitetin e ekipit.

Kjo kërkon një qasje tjetër ndaj organizimit të lojës. Në vend që fëmija të përshtatet me rregulla të përcaktuara paraprakisht, të cilat nuk mund t'i ndjekë, mësimdhënësi ose trajneri duhet të shqyrtojë cilat elemente të aktivitetit mund të ndryshohen pa humbur qëllimin e tij kryesor.

Përshtatja mund të lidhet me madhësinë e hapësirës, kohëzgjatjen e detyrës, numrin e pjesëmarrësve, mënyrën e dhënies së udhëzimeve, përdorimin e mbështetjes vizuale ose rolin

që fëmija merr në ekip. Ndonjëherë një ndryshim i vogël, si koha shtesë për reagim ose një pozicion i shënuar qartë në fushë, mund ta rrisë ndjeshëm mundësinë për pjesëmarrje të pavarur.

Është veçanërisht e rëndësishme që mbështetja të mos e zëvendësojë pjesëmarrjen e fëmijës. Kur i rrituri e kryen vazhdimisht detyrën në vend të tij, ia drejton çdo lëvizje ose vendos në emër të tij, fëmija mund të jetë i përfshirë formalisht, por të mos ketë hapësirë të mjaftueshme për nismën e vet. Prandaj mbështetja duhet të jetë e matur me kujdes, me mundësinë që të zvogëlohet gradualisht kur fëmija shfaq më shumë siguri dhe pavarësi.

Bashkëmoshatarët kanë rol të rëndësishëm në këtë proces. Mbështetja e tyre nuk duhet të kufizohet në ndihmë të vazhdueshme, por duhet të mundësojë komunikim të natyrshëm, shkëmbim dhe vendimmarrje të përbashkët. Fëmija duhet të njihet si bashkëlojtar me kontributin e vet, jo vetëm si marrës i ndihmës.

Shembull praktik:
Përshtatja e ushtrimit të pasimit të topit

Gjatë një ushtrimi ku nxënësit ia pasojnë topin njëri-tjetrit në çifte, një fëmijë ka vështirësi ta ndjekë shpejtësinë e pasimit dhe shpesh nuk arrin ta prekë topin.

Në vend që të veçohet nga aktiviteti, mësimdhënësi mund ta zvogëlojë distancën ndërmjet bashkëlojtarëve, të përdorë një top që kontrollohet më lehtë dhe të përcaktojë një sinjal të shkurtër vizual ose verbal para çdo pasimi. Bashkëmoshatarit mund t'i shpjegohet se duhet të lërë kohë të mjaftueshme për reagim dhe ta respektojë ritmin e partnerit.

Në këtë mënyrë, detyra themelore mbetet e njëjtë – pasimi i ndërsjellë dhe bashkëpunimi – por kushtet përshtaten që të dy nxënësit të marrin pjesë në mënyrë aktive..

Pyetje për vlerësimin praktik

Gjatë planifikimit dhe monitorimit të aktiviteteve, mësimdhënësi ose trajneri mund të shqyrtojë:

- A ka çdo fëmijë një rol të qartë dhe të realizueshëm në aktivitet?
- A ka kohë të mjaftueshme dhe mbështetjen e duhur për të reaguar ose vepruar?
- A ka mundësi për zgjedhje, nismë dhe komunikim me bashkëmoshatarët?
- A mundëson përshtatja më shumë pavarësi apo krijon varësi nga ndihma?
- A është kontributi i fëmijës i dukshëm dhe i njohur në aktivitetin e përbashkët?

Këto pyetje ndihmojnë për të dalluar përfshirjen formale nga pjesëmarrja që ka vlerë të vërtetë për fëmijën.

Parimi bazë: Një aktivitet i suksesshëm gjithëpërfshirës i futbollit nuk matet nga fakti nëse të gjithë fëmijët bëjnë të njëjtën gjë, por nga fakti nëse çdo fëmijë ka mundësi reale të marrë pjesë, të kontribuojë dhe të ndihet pjesë e ekipit.

1.2. Mundësi të ndryshme, mënyra të ndryshme pjesëmarrjeje

Në çdo grup fëmijësh ka dallime në mënyrën e lëvizjes, komunikimit, kuptimit të udhëzimeve, ruajtjes së vëmendjes dhe krijimit të marrëdhënieve me bashkëmoshatarët. Këto dallime kanë rëndësi të veçantë gjatë organizimit të aktiviteteve të futbollit, pasi loja kërkon njëkohësisht ndjekjen e lëvizjes së topit, orientimin në hapësirë, kuptimin e rregullave, bashkëpunimin dhe reagimin ndaj situatave që ndryshojnë.

Te fëmijët me autizëm dhe nevoja komplekse për mbështetje, disa karakteristika të mjedisit sportiv mund të ndikojnë më tej në pjesëmarrje. Zhurma, lëvizjet e paparashikueshme të bashkëlojtarëve, ndryshimet e shpejta të aktiviteteve ose udhëzimet e shumta njëkohësisht për disa fëmijë paraqesin ngarkesë të konsiderueshme. Për të tjerët, sfida më e madhe mund të jetë koordinimi motorik, kuptimi i rendit të detyrave ose vendosja e komunikimit me bashkëlojtarët.

Megjithatë, diagnoza në vetvete nuk e përcakton mënyrën e pjesëmarrjes. Dy fëmijë me karakteristika zhvillimore të njëjta ose të ngjashme mund të kenë interesa, aftësi, mënyra komunikimi dhe nevoja për mbështetje të ndryshme. Prandaj planifikimi nuk duhet të mbështetet te supozimet se çfarë mund ose nuk mund të bëjë fëmija, por te njohja e drejtpërdrejtë e mundësive dhe sjelljes së tij në aktivitetin konkret.

Diversiteti nuk është një kufi i paracaktuar

Dallimet në komunikim, lëvizje dhe ritëm nuk janë kategori të pandryshueshme pjesëmarrësish. Ato tregojnë se një qëllim i vetëm futbollistik mund të kërkojë rrugë të ndryshme për pjesëmarrje.

Prandaj, në vend që të përcaktojmë se çfarë nuk mund të bëjë fëmija, është e rëndësishme të pranojmë se pjesëmarrja e tij varet edhe nga mënyra si organizohet loja. Hapat praktik për njohjen e pjesëmarrësve trajtohen në pjesën 2.1.

Mënyra të ndryshme pjesëmarrjeje në të njëjtin aktivitet

Një aktivitet gjithëpërfshirës i futbollit mund të ketë një qëllim të përbashkët dhe të mundësojë mënyra të ndryshme për ta arritur atë. Për shembull, në një detyrë për shënimin e golit, një fëmijë mund ta udhëheqë topin dhe të gjuajë vetë, një tjetër të gjuajë nga një distancë më e afërt, ndërsa i treti ta drejtojë topin drejt portës nga një pozicion i përgatitur paraprakisht dhe me mbështetjen e duhur.

Të tre mënyrat lidhen me të njëjtën detyrë sportive, por kërkojnë kushte të ndryshme për pjesëmarrje të suksesshme.

Kjo qasje nuk nënkupton uljen e pritshmërive ndaj fëmijës. Përkundrazi, ajo mundëson që detyra të jetë mjaftueshëm e qasshme që fëmija të fillojë të marrë pjesë, por edhe mjaftueshëm sfiduese për të nxitur zhvillimin.

Prandaj, është e rëndësishme që përshtatjet të mos mbeten të pandryshuara. Me fitimin e përvojës, sigurisë dhe pavarësisë më të madhe, mësimdhënësi ose trajneri mund ta rrisë gradualisht shkallën e ndërlikueshmërisë së detyrës.

Zbatimi praktik:
Një detyrë – disa mënyra realizimi

Detyra e përbashkët: Nxënësi ta drejtojë topin drejt portës së shënuar.

Tabela 2. Mënyrat e pjesëmarrjes dhe përshtatjet e mundshme

Mënyra e pjesëmarrjes	Përshtatja e mundshme
Udhëheqja e pavarur e topit dhe gjuajtja	Rrugë standarde ose e përshtatur drejt portës
Gjuajtje nga vendi	Distancë më e shkurtër dhe top i vendosur në mënyrë të qëndrueshme
Gjuajtje pas një sinjali vizual	Kartelë, shenjë ose demonstrim para realizimit
Realizim me mbështetje	Ndihmë për pozicionimin ose fillimin e lëvizjes, sipas nevojës dhe pëlqimit të fëmijës
Realizim në çift	Bashkëlojtari e pason ose e vendos topin, ndërsa fëmija e kryen gjuajtjen përfundimtare

Mundësitë e paraqitura nuk janë kategori të veçanta fëmijësh dhe as nivele aftësish të përcaktuara paraprakisht. Ato janë shembuj përshtatjesh që mund të kombinohen dhe ndryshohen në varësi të situatës konkrete.

Parimi bazë: Mënyrat e ndryshme të pjesëmarrjes nuk e cenojnë lojën e përbashkët. Ato mundësojnë që çdo fëmijë të përfshihet sipas mundësive të tij aktuale, duke pasur hapësirë për përparim, pavarësi dhe kontribut personal.

1.3 Futbolli si mundësi për komunikim, bashkëpunim dhe lidhje

Loja e futbollit krijon shumë situata në të cilat fëmijët duhet të shkëmbejnë informacione, të bashkërendojnë veprimet dhe të reagojnë ndaj aktiviteteve të bashkëlojtarëve. Pasimi i topit, lëvizja e përbashkët drejt portës, ndërrimi i roleve dhe festimi i një aksioni të suksesshëm janë mundësi për zhvillimin e aftësive komunikuese dhe sociale në një kontekst të natyrshëm.

Megjithatë, vetëm organizimi i një loje në grup nuk garanton bashkëpunim ndërmjet fëmijëve. Disa nxënës e fillojnë lehtë komunikimin dhe përfshihen në mënyrë të pavarur në aktivitetet ekipore, ndërsa të tjerëve u duhet më shumë kohë, strukturë e qartë ose mbështetje për të vendosur kontakt me bashkëmoshatarët.

Prandaj, komunikimi dhe bashkëpunimi duhet të përfshihen qëllimisht në planifikimin e aktiviteteve të futbollit, si pjesë përbërëse e detyrës sportive.

Komunikimi ka forma të ndryshme

Në lojën e futbollit, komunikimi nuk realizohet vetëm përmes të folurit. Shikimi, lëvizja, gjesti, tregimi me dorë, orientimi i trupit ose përdorimi i simboleve vizuale mund t'i përcjellin një mesazh bashkëlojtarit.

Një fëmijë që nuk përdor të folurin ose ka komunikim verbal të kufizuar mund ta kërkojë topin me gjest, të tregojë se ku dëshiron të lëvizë ose ta zgjedhë aktivitetin përmes një kartele komunikimi. Këto mënyra të të shprehurit duhet të njihen dhe pranohen si forma të barabarta komunikimi.

Mësimdhënësi ose trajneri ka për detyrë të krijojë kushte në të cilat bashkëlojtarët mund t'i kuptojnë dhe respektojnë mënyrat e ndryshme të komunikimit. Kjo nënkupton udhëzime të shkurtra dhe të qarta, demonstrim, mbështetje vizuale dhe kohë të mjaftueshme që fëmija ta marrë informacionin dhe të përgjigjet.

Është veçanërisht e rëndësishme që të rriturit të mos e marrin përsipër të gjithë komunikimin në emër të fëmijës. Kur është e mundur, mesazhet duhet të shkëmbehen drejtpërdrejt ndërmjet bashkëlojtarëve, me mbështetje vetëm aq sa nevojitet.

Bashkëpunimi mësohet përmes një detyre të përbashkët

Detyra e përbashkët u jep fëmijëve një arsye konkrete për të komunikuar dhe bashkërenduar aktivitetet e tyre. Në vend që bashkëpunimi të shpjegohet vetëm përmes rregullave verbale, ai mund të zhvillohet përmes ushtrimeve të futbollit të zgjedhura me kujdes.

Për shembull, gjatë pasimit të topit në çift, të dy nxënësit duhet të ndjekin lëvizjen e partnerit, ta përshtatin çastin e pasimit dhe ta vazhdojnë aktivitetin e përbashkët. Në një grup të vogël, fëmijët mund të merren vesh se kush do ta nisë aksionin, kush do ta pranojë topin dhe kush do ta kryejë gjuajtjen përfundimtare.

Në këto situata, detyra sportive bëhet njëkohësisht mundësi për të ushtruar pritjen e radhës, kërkimin e ndihmës, marrjen e vendimeve të përbashkëta dhe respektimin e rregullave të dakorduara.

Megjithatë, rolet nuk duhet të mbeten vazhdimisht të njëjta. Një fëmijë që merr mbështetje në një aktivitet mund ta ndihmojë bashkëlojtarin në një tjetër, të propozojë një zgjidhje ose të marrë përgjegjësinë për një pjesë të caktuar të detyrës.

Mbështetja nga bashkëmoshatarët si marrëdhënie e ndërsjellë

Mbështetja nga bashkëmoshatarët ka vlerën më të madhe kur zhvillohet si një marrëdhënie e natyrshme dhe e ndërsjellë, jo si ndarje e përhershme mes fëmijëve që ndihmojnë dhe atyre që marrin ndihmë.

Detyra e bashkëmoshatarit nuk është ta kryejë aktivitetin në vend të partnerit, por të kontribuojë në pjesëmarrjen e tij përmes bashkëpunimit, inkurajimit, komunikimit të kuptueshëm dhe respektimit të zgjedhjes personale.

Për këtë qëllim, mësimdhënësi ose trajneri mund t'i udhëzojë fëmijët të pyesin përpara se të ndihmojnë, të lënë kohë për përgjigje, ta respektojnë refuzimin dhe ta njohin kontributin e secilit anëtar të ekipit.

Është e rëndësishme gjithashtu që bashkëmoshatarët të mos ngarkohen vazhdimisht me mbështetjen e të njëjtit fëmijë. Ndërrimi i partnerëve dhe roleve në ekip mundëson komunikim më të gjerë dhe parandalon krijimin e varësisë nga një bashkëlojtar i vetëm.

Shembull praktik: Aksion i përbashkët drejt portës

Qëllimi i aktivitetit: Nxitja e komunikimit dhe bashkëpunimit përmes pasimit të përbashkët dhe gjuajtjes drejt portës.

Organizimi: Tre fëmijë vendosen në distancë të shkurtër nga njëri-tjetri. I pari e nis aksionin, i dyti e pranon dhe e pason topin, ndërsa i treti gjuan drejt portës.

Para fillimit, mësimdhënësi i prezanton rolet përmes një demonstrimi të shkurtër. Fëmijët mund të përdorin të folurin, gjestin ose një shenjë vizuale për të treguar se janë gati ta pranojnë topin.

Pas çdo realizimi, rolet ndërrohen, në mënyrë që çdo fëmijë të ketë mundësinë të nisë aksionin, të bashkëpunojë me partnerët dhe të kryejë gjuajtjen përfundimtare.

Nëse një fëmijë ka nevojë për mbështetje shtesë, mund të zvogëlohet distanca, të ngadalësohet ritmi ose të përdoret një renditje e shënuar vizualisht e aktivitetit.

Çfarë nxitet: shkëmbimi i mesazheve, bashkërendimi i veprimeve, vëmendja e përbashkët, pritja e radhës dhe njohja e kontributit të bashkëlojtarëve.

Nga aktiviteti i përbashkët te lidhjet mes bashkëmoshatarëve

Miqësitë dhe ndjenja e përkatësisë nuk mund të krijohen vetëm duke organizuar një stërvitje të përbashkët. Ato zhvillohen gradualisht, përmes përvojave pozitive të përsëritura, besimit të ndërsjellë dhe mundësive që fëmijët të njihen përtej roleve të caktuara paraprakisht.

Prandaj, krahas detyrave të strukturuara të futbollit, është e rëndësishme të parashikohet kohë për ndërveprim të lirë, zgjedhje të përbashkët të aktiviteteve dhe shkëmbim të shkurtër përshtypjesh pas lojës.

Mësimdhënësi ose trajneri mund t'i nxisë fëmijët të identifikojnë bashkëpunimin e suksesshëm, ta falënderojnë bashkëlojtarin ose të tregojnë se çfarë i ndihmoi gjatë detyrës së përbashkët. Këto aktivitete duhet të jenë të shkurtra, të natyrshme dhe të qasshme përmes mënyrave të ndryshme të të shprehurit.

Parimi bazë: Komunikimi dhe bashkëpunimi nuk janë detyra shtesë përkrah futbollit. Ato zhvillohen brenda vetë lojës, kur çdo fëmijë ka mundësi të dërgojë një mesazh, të kuptohet dhe të kontribuojë në aktivitetin e përbashkët.

1.4. Dinjiteti, zgjedhja dhe kontributi individual i fëmijës

Pjesëmarrja në një aktivitet sportiv duhet të jetë një përvojë ku fëmija ndihet i respektuar, i pranuar dhe i sigurt. Mënyra si të rriturit dhe bashkëmoshatarët i drejtohen, i ofrojnë mbështetje dhe e përfshijnë në vendimmarrje ndikon drejtpërdrejt në gatishmërinë e tij për të marrë pjesë.

Në futbollin gjithëpërfshirës, respektimi i dinjitetit të fëmijës nënkupton marrjen parasysh të aftësive, interesave dhe nevojave të tij pa krahasime ose veçime të panevojshme nga grupi. Fëmija duhet të njihet si pjesëmarrës i barabartë, për të cilin, sikurse edhe për të tjerët, krijohen kushte të përshtatshme për lojë.

Mbështetja që ruan pavarësinë

Mbështetja ka kuptim kur i mundëson fëmijës të bëjë diçka që pa të do të ishte e vështirë ose e paarritshme. Ajo nuk duhet t'ia kufizojë pa nevojë nismën personale.

Mësimdhënësi, trajneri ose asistenti arsimor duhet të vlerësojë kur është e nevojshme të ndihmojë dhe kur është më mirë t'i lërë kohë fëmijës të provojë vetë. Përpara se të ofrohet ndihmë fizike, është e rëndësishme të kontrollohet nëse fëmija e pranon atë dhe nëse i njëjti qëllim mund të arrihet përmes demonstrimit, një shenje vizuale ose një udhëzimi të shkurtër verbal.

Për shembull, kur vendoset topi para gjuajtjes, i rrituri mund ta tregojë fillimisht veprimin dhe t'i japë fëmijës mundësinë ta përsërisë në mënyrë të pavarur. Nëse nevojitet ndihmë shtesë, ajo ofrohet vetëm në masën minimale që mundëson pjesëmarrje të sigurt dhe të suksesshme.

Zvogëlimi gradual i mbështetjes nuk duhet të jetë qëllim më vete. Për disa fëmijë, një formë e caktuar mbështetjeje do të mbetet e domosdoshme, por kjo nuk e ul vlerën e pjesëmarrjes së tyre.

E drejta për zgjedhje dhe refuzim

Zgjedhja është një tregues i rëndësishëm se fëmija ka ndikim mbi pjesëmarrjen e vet. Në aktivitetet sportive, ajo mund të lidhet me zgjedhjen e topit, partnerit, pozicionit, mënyrës së realizimit ose nevojën për pushim.

Po aq i rëndësishëm është respektimi i refuzimit. Fëmija mund të mos dëshirojë të marrë pjesë në një detyrë të caktuar për shkak të lodhjes, parehatisë, mbingarkesës shqisore, moskuptimit të mjaftueshëm ose thjesht për shkak të dëshirës personale.

Në një situatë të tillë, nuk është e përshtatshme të këmbëngulet për pjesëmarrje me çdo kusht. Në vend të kësaj, mësimdhënësi ose trajneri mund të ofrojë një rol tjetër, një aktivitet më të thjeshtë, një pushim të shkurtër ose mundësinë që fëmija të rikthehet kur të jetë gati.

Respektimi i zgjedhjes nuk nënkupton mungesë rregullash. Ai nënkupton vendosjen e kufijve të qartë, të sigurt dhe të kuptueshëm, brenda të cilëve fëmija ka mundësi reale për të vendosur.

Njohja e kontributit individual

Në lojën e futbollit, më të dukshme janë shpesh goli i shënuar, shpejtësia ose suksesi teknik. Megjithatë, kontributi në ekip mund të shprehet edhe përmes një pasimi të suksesshëm, ndjekjes me vëmendje të bashkëlojtarit, respektimit të marrëveshjes, inkurajimit ose marrjes së përgjegjësisë për një detyrë të përbashkët.

Është e rëndësishme që këto kontribute të njihen në mënyrë të natyrshme, pa theksim të tepruar ose veçim të fëmijës nga pjesëmarrësit e tjerë.

Në vend të një lavdërimi të përgjithshëm si „Bravo, je i shkëlqyer!“, mësimdhënësi mund ta theksojë konkretisht kontributin: „E priti bashkëlojtarin dhe ia pasoi topin kur ai ishte gati“.

Një reagim i tillë është i qartë, i lidhur me aktivitetin dhe i dobishëm për të gjithë grupin.

Njëkohësisht, edhe vetë fëmija duhet të ketë mundësi ta shprehë kënaqësinë, pakënaqësinë ose mendimin e tij për pjesëmarrjen, përmes një mënyre komunikimi që është e qasshme për të.

Situatë praktike: Kur fëmija nuk dëshiron të gjuajë drejt portës

Gjatë një ushtrimi, fëmija e ndjek aktivitetin, por nuk dëshiron ta kryejë gjuajtjen përfundimtare.

Në vend që të këmbëngulet ose të supozohet se fëmija nuk mund ta kryejë detyrën, mësimdhënësi mund të kontrollojë nëse ai e kupton udhëzimin dhe t’i ofrojë dy mundësi: të gjuajë nga një pozicion më i afërt ose t’ia pasojë topin bashkëlojtarit.

Nëse fëmija nuk zgjedh asnjërën nga mundësitë e ofruara, mund t’i mundësohet një pushim i shkurtër dhe rikthimi në aktivitet më vonë.

Qëllimi i kësaj procedure nuk është që fëmija ta kryejë patjetër aktivitetin e caktuar fillimisht, por që të ruhen dinjiteti, ndjenja e sigurisë dhe mundësia për pjesëmarrje të mëtejshme.

Përgjegjësia profesionale e të rriturve

Mësimdhënësit, trajnerët dhe profesionistët kanë një rol të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi sportiv ku çdo fëmijë ndihet i pranuar, i respektuar dhe i vlerësuar si anëtar i ekipit.

Një mjedis i tillë ndërtohet përmes komunikimit të kujdesshëm dhe dinjitoz, respektimit të veçorive individuale dhe nxitjes së marrëdhënieve pozitive ndërmjet bashkëmoshatarëve. Është veçanërisht e rëndësishme që mbështetja të ofrohet në mënyrë të natyrshme dhe jo ndërhyrëse, pa e veçuar pa nevojë fëmijën nga grupi.

Gjatë ndarjes së informacioneve dhe dhënies së udhëzimeve për bashkëpunim, duhet të respektohen privatësia dhe dinjiteti personal i çdo fëmije. Vëmendja duhet të përqëndrohet te mënyrat e komunikimit, mirëkuptimi i ndërsjellë dhe pjesëmarrja e përbashkët, jo te vështirësitë individuale ose rrethanat personale.

Parimi bazë: Dinjiteti i fëmijës respektohet përmes veprimeve të përditshme – kur zgjedhja e tij dëgjohet, mbështetja nuk ia zëvendëson nismën dhe kontributi i tij vlerësohet si pjesë e lojës së përbashkët.

1.5. Parimet bazë për planifikimin dhe udhëheqjen e aktiviteteve gjithëpërfshirëse të futbollit

Cilësia e një aktiviteti gjithëpërfshirës të futbollit varet në masë të madhe nga mënyra si përgatitet, organizohet dhe udhëhiqet. Përgatitja e mirë nuk nënkupton parashikimin paraprak të çdo reagimi të fëmijës, por krijimin e kushteve në të cilat aktiviteti mund të përshtatet sipas nevojave të pjesëmarrësve, pa cenuar qëllimin, sigurinë dhe dinamikën e grupit.

Qasja „Touch the Goal“ bazohet në disa parime të ndërlidhura që mund të zbatohen në mjedise të ndryshme shkollore dhe sportive.

1. Qëllim i qartë dhe strukturë e kuptueshme

Çdo aktivitet duhet të ketë një qëllim të njohur dhe një rrjedhë që pjesëmarrësit mund ta kuptojnë. Para fillimit, mësimdhënësi ose trajneri duhet të dijë se cila aftësi sportive zhvillohet, çfarë bashkëpunimi pritet dhe në çfarë mënyrash mund të marrin pjesë fëmijët.

Udhëzimet duhet të jenë të shkurtra, konkrete dhe, kur nevojitet, të shoqërohen me demonstrim ose mbështetje vizuale. Fillimi i qartë, rendi i detyrave dhe përfundimi i parashikueshëm kontribuojnë në orientim më të mirë dhe siguri më të madhe.

2. Qasja dhe fleksibiliteti

Aktiviteti duhet të mundësojë disa mënyra realizimi, pa përcaktuar paraprakisht një mënyrë të vetme të pranueshme pjesëmarrjeje.

Hapësira, pajisjet, rregullat, kohëzgjatja dhe mënyra e komunikimit mund të ndryshohen sipas situatës konkrete. Përshtatja duhet të jetë pjesë përbërëse e planifikimit, jo vetëm reagim ndaj një vështirësie që tashmë është shfaqur.

3. Roli aktiv i çdo fëmije

Çdo fëmijë duhet të ketë një rol të njohur dhe të realizueshëm në aktivitetin e përbashkët. Rolet mund të ndryshojnë, por duhet të lidhen me detyrën e përbashkët dhe të mundësojnë kontribut personal.

Gjatë ndarjes së roleve, është e rëndësishme të merren parasysh interesat e fëmijës, mundësitë e tij aktuale dhe mundësitë për zgjerimin gradual të pjesëmarrjes.

4. Komunikimi dhe bashkëpunimi me bashkëmoshatarët

Aktivitetet e futbollit duhet të krijojnë mundësi për komunikim të drejtpërdrejtë ndërmjet fëmijëve. Ai mund të realizohet përmes të folurit, gjesteve, lëvizjeve, simboleve vizuale ose mënyrave të tjera të qasshme të të shprehurit.

Mbështetja nga bashkëmoshatarët duhet të nxisë reciprocitetin, bashkëpunimin dhe pavarësinë. Detyra e të rriturve është t'i lehtësojnë këto marrëdhënie, pa e marrë përsipër pa nevojë komunikimin ndërmjet bashkëlojtarëve.

5. Respektimi i ritmit individual dhe i zgjedhjes

Fëmijët mund të reagojnë ndryshe ndaj të njëjtit aktivitet dhe mund të kenë nevojë për kohë të ndryshme për ta kuptuar, përgatitur dhe kryer detyrën.

Planifikimi duhet të mundësojë ritëm të përshtatshëm, zgjedhje të arsyeshme dhe mundësi për pushim. Mbështetja ofrohet sipas nevojës, duke respektuar dinjitetin dhe nismën e fëmijës.

6. Siguria dhe ndjenja e të qenit i sigurt

Siguria përfshin një hapësirë të organizuar siç duhet, pajisje në gjendje të mirë, rregulla të qarta dhe monitorim të kujdesshëm të aktiviteteve. Po aq e rëndësishme është që fëmijët të ndihen të sigurt gjatë komunikimit me të rriturit dhe bashkëmoshatarët.

Mësimdhënësi ose trajneri duhet t'i identifikojë situatat që mund të shkaktojnë mbingarkesë, parehati ose tërheqje dhe të ofrojë në kohë përshtatjen e duhur.

7. Vëzhgimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm

Suksesi i aktivitetit nuk duhet të vlerësohet vetëm sipas rezultatit sportiv të arritur. Është e rëndësishme të monitorohen pjesëmarrja, nisma, komunikimi, bashkëpunimi dhe shkalla e mbështetjes së nevojshme.

Vëzhgimet i ndihmojnë mësimdhënësit dhe trajnerët të dallojnë cilat zgjidhje funksionojnë, çfarë duhet ndryshuar dhe si mund të përshtatet më mirë aktiviteti i ardhshëm.

Kapitulli 2

PËRGATITJA E NJË MJEDISI MBËSHTETËS PËR FUTBOLL

Hyrje

Përgatitja e një aktiviteti gjithëpërfshirës të futbollit fillon përpara daljes në fushë. Për mësimdhënësin ose trajnerin nuk mjafton të dijë numrin e pjesëmarrësve dhe moshën e tyre. Duhet të kuptojë si komunikojnë fëmijët, çfarë i motivon, si përshtaten në grup dhe cilat kushte i ndihmojnë të marrin pjesë në aktivitetin sportiv.

Në „Touch the Goal“, informacionet për fëmijën shndërrohen në vendime për organizimin e stërvitjes. Plani përshtatet me grupin dhe përmirësohet gjatë punës.

2.1. Njohja e pjesëmarrësve dhe e nevojave të tyre për mbështetje

Nga informacionet për fëmijën te vendimet në fushë

Për planifikimin përzgjidhen informacione mbi kuptimin e detyrës, shprehjen e dëshirës për pjesëmarrje, vështirësitë e mundshme dhe mbështetjen e përshtatshme.

Mblidhen vetëm të dhënat personale të nevojshme për pjesëmarrje të sigurt dhe cilësore.

Vëmendje e veçantë duhet t'u kushohet këtyre fushave:

Interesat dhe motivimi. A i pëlqejnë fëmijës aktivitetet me top? A parapëlqen gjuajtjen, pasimin, lëvizjen përgjatë një rruge të shënuar apo lojën me partner? Çfarë e ndihmon ta nisë aktivitetin dhe ta ruajë interesin?

Komunikimi dhe të kuptuarit. A e ndjek fëmija më lehtë një udhëzim gojor, demonstrim, fotografi ose simbol? Si e shpreh zgjedhjen, pajtimin, nevojën për ndihmë ose pushim?

Lëvizja dhe orientimi. Si lëviz fëmija nëpër hapësirë? A mund ta kontrollojë topin në mënyrë të pavarur? A i nevojitet një shenjë shtesë hapësinore, distancë e ndryshuar ose pajisje e përshtatur?

Pjesëmarrja me bashkëmoshatarët. A e nis fëmija më lehtë aktivitetin vetë, në çift apo në grup të vogël? Si reagon ndaj pasimit të topit, pritjes së radhës dhe ndërrimit të partnerit?

Veçoritë shqisore dhe ndjenja e sigurisë. Si reagon ndaj bilbilit, muzikës së lartë, zhurmës, prekjes ose një grupi më të madh fëmijësh? Çfarë e ndihmon kur i nevojitet pushim ose ulje e ngarkesës?

Këto fusha ndihmojnë në përzgjedhjen e kushteve të pjesëmarrjes; ato nuk janë parakushte që fëmija duhet t'i plotësojë.

Bashkëpunimi me fëmijën, familjen dhe ekipin profesional

Ndërlidhen informacionet e marra nga fëmija, familja dhe profesionistët.

Fëmija, në përputhje me mënyrën e vet të komunikimit, duhet të ketë mundësi t'i shprehë interesat dhe zgjedhjet e tij. Prindërit mund të tregojnë çfarë e ndihmon në një mjedis të ri, cilat aktivitete parapëlqen dhe cilat situata mund të shkaktojnë parehati. Mësimdhënësit, edukatorët special dhe rehabilitatorët dhe profesionistët e tjerë mund të propozojnë mënyra të përshtatshme komunikimi, organizimi dhe mbështetjeje.

Megjithatë, informacionet e marra paraprakisht nuk duhen konsideruar si vlerësim përfundimtar. Fëmija mund të shfaqë aftësi ose interesa të tjera në mjedisin sportiv krahasuar me klasën. Prandaj vëzhgimi i drejtpërdrejtë gjatë aktivitetit është i domosdoshëm për të verifikuar dhe plotësuar njohuritë fillestare

Përfshirja e parë si mundësi për njohje

Takimi i parë me aktivitetin e futbollit nuk është e nevojshme të fillojë me ndeshje ose ushtrim të ndërlikuar në grup. Mund të jetë më e dobishme të organizohet një aktivitet i shkurtër, i kuptueshëm dhe fleksibil që i mundëson fëmijës të njohë hapësirën, pajisjet dhe mënyrën e punës.

Për shembull, pjesëmarrësve mund t'u ofrohen tri mundësi të thjeshta: lëvizje e lirë me top, pasim në çift ose gjuajtje drejt një porte të shënuar. Mësimdhënësi vëzhgon se cili aktivitet e tërheq fëmijën, si e kupton detyrën, nëse kërkon ndihmë dhe si reagon ndaj pranisë së të tjerëve.

Qëllimi është një përvojë e parë pozitive dhe sigurimi i orientimit për planifikim, pa testuar aftësitë sportive.

Mjet praktik: Nga vëzhgimi te përshtatja

Modeli i mëposhtëm i punës tregon se si një vëzhgim mund të lidhet me një përshtatje konkrete.

Tabela 3. Nga vëzhgimi te përshtatja konkrete

Vëzhgimi	Fëmija tregon interes për topin, por nuk përfshihet në lojën në grup.
Mundësia për pjesëmarrje	Aktiviteti në çift mund të jetë një fillim më i qasshëm.
Përshtatja	Organizojmë një ushtrim të shkurtër pasimesh me një bashkëlojtar.
Rivlerësimi	Vëzhgojmë si merr pjesë fëmija dhe nëse është gati për zgjerimin e aktivitetit.

Profil i shkurtër për pjesëmarrje

Për planifikimin, është e dobishme që mësimdhënësi ose trajneri, në bashkëpunim me ekipin profesional, të përgatisë një profil të shkurtër pune që përmban vetëm informacionet e domosdoshme për aktivitetin sportiv.

Formular i propozuar: „Mënyra ime e pjesëmarrjes“
MËNYRA IME E PJESËMARRJES
Profil i shkurtër pune për planifikimin e mbështetjes

Tabela 4. Profili i punës „Mënyra ime e pjesëmarrjes“

Çfarë më intereson?	Aktivitetet dhe rolet e preferuara
Si komunikoj?	Të folurit, gjesti, fotografia ose simboli
Çfarë mund të bëj vetë?	Aftësitë dhe mundësitë e mia
Çfarë më ndihmon?	Përshtatjet dhe mbështetja e dobishme
Kur më duhet një pushim?	Shenjat dhe mënyra e dakorduar e pushimit
Çfarë dua të provoj?	Hapi im i radhës

Formulari mund të plotësohet gradualisht dhe të ndryshohet gjatë aktiviteteve. Ai nuk synon vlerësim diagnostik, renditje të fëmijëve apo krijim të dokumentacionit shtesë voluminoz. Vlera e tij qëndron në mundësinë që u jep drejtuesve të aktivitetit të identifikojnë shpejt mënyrat e dobishme të mbështetjes.

Te informacionet kanë qasje personat të cilëve u nevojiten për punën e tyre, duke respektuar privatësinë e fëmijës.

Lidhja me mjetet e „Touch the Goal“

Informacionet mbi mënyrën e komunikimit, zgjedhjen dhe nevojën për pushim ndihmojnë në përzgjedhjen e mbështetjes gjatë stërvitjes. Kartelat e komunikimit në futboll mund ta lehtësojnë të kuptuarit dhe të shprehurit, ndërsa kutia mobile gjithëpërfshirëse POP-UP mundëson punë vizuale dhe praktike me përmbajtje futbolli. Sipas nevojës, këndi i përshtatur ofron një vend për punë më të qetë ose pushim. Përgatitja dhe përdorimi i tyre konkret trajtohen në kapitullin 3.

Mbështetja zgjidhet dhe vlerësohet gjatë aktivitetit konkret; një mjet nuk është njësoj i përshtatshëm për të gjithë.

2.2. Identifikimi i pikave të forta, interesave dhe mundësive të pjesëmarrësve

Pas njohjes fillestare, interesat dhe aftësitë e vëzhguara lidhen me një hap të ardhshëm të realizueshëm në stërvitje.

Zgjidhet një aktivitet i njohur, një aftësi për t’u zhvilluar më tej dhe një mënyrë për të vlerësuar ndryshimin.

Nga interesi te detyra konkrete e futbollit

Në një detyrë të njohur futet një element i vogël i ri, duke ruajtur interesin për lojën.

Për shembull, nëse fëmijës i pëlqen të gjuajë drejt portës dhe e drejton topin vetë nga një distancë e shkurtër, hapi i ardhshëm mund të jetë gjuajtja pas një pasimi nga bashkëlojtari. Në këtë mënyrë ruhet aktiviteti i njohur dhe shtohet një element i ri që kërkon më shumë vëmendje, koordinim dhe bashkërendim të lëvizjeve.

Ndërlikueshmëria e detyrës rritet gradualisht, sipas mundësive dhe reagimeve të fëmijës. Nëse elementi i ri rezulton tepër i vështirë, aktiviteti mund të thjeshtohet sërish ose të kryhet me një formë tjetër mbështetjeje.

Model praktik:
„Ajo që më pëlqen – ajo që mund të bëj – ajo që do të provoj“

Modeli lidh interesin, aftësinë ekzistuese dhe aktivitetin e ardhshëm.

1. AJO QË MË PËLQEN

Fëmija shfaq interes për gjuajtjen drejt portës.

↓

2. AJO QË MUND TË BËJ

E drejton në mënyrë të pavarur topin drejt një cakut të shënuar nga një distancë e shkurtër.

↓

3***. AJO QË DO TË PROVOJ***

Gjuajtja pas pasimit nga një bashkëlojtar, me distancë të përshtatur dhe mbështetjen e duhur.

Skema ndihmon në përzgjedhjen e detyrës dhe nuk shërben për renditje.

Identifikimi i mundësive që nuk duken menjëherë

Gjatë aktiviteteve të futbollit, më lehtë vërehen lëvizja, kontrolli i topit dhe saktësia e gjuajtjes. Megjithatë, për planifikimin janë të rëndësishme edhe aftësi të tjera që nuk lidhen drejtpërdrejt me performancën sportive.

Për shembull, aftësia për të ndjekur një shenjë vizuale mund të përdoret gjatë organizimit të ushtrimit të udhëheqjes së topit përgjatë një rruge të shënuar. Ndjekja me sukses e një demonstrimi të shkurtër mund të jetë bazë për futjen e një lëvizjeje të re, ndërsa njohja e një sinjali të dakorduar mund të ndihmojë në organizimin e aktiviteteve me fillim dhe përfundim të përcaktuar qartë.

Monitorimi i përparimit individual

Ndiqen realizimi i detyrës dhe ndryshimet me kalimin e kohës.

Tregues janë pavarësia më e madhe, kontrolli më i mirë i topit, lëvizja më e saktë, kuptimi i një elementi të ri ose përdorimi i aftësisë në një situatë tjetër.

Udhëzim praktik

Shënoni një detyrë të ardhshme të realizueshme dhe një kusht që do ta ndihmojë fëmijën ta provojë. Pas stërvitjes vendosni nëse do ta ruani, ndryshoni ose zhvilloni më tej.

2.3. Identifikimi dhe mënjanimi i pengesave për pjesëmarrje

Njohja e interesave, aftësive dhe nevojave të pjesëmarrësve përbën bazën për planifikimin e aktiviteteve të përshtatshme të futbollit. Megjithatë, mundësitë për pjesëmarrje nuk varen vetëm nga aftësitë individuale të fëmijës, por edhe nga kushtet ku zhvillohet aktiviteti. Organizimi i stërvitjes, rregullat e lojës, komunikimi, hapësira, pajisjet dhe mbështetja në dispozicion mund ta lehtësojnë ose vështirësojnë përfshirjen.

Një fëmijë që zotëron një aftësi mund të hasë vështirësi për shkak të ritmit shumë të shpejtë, udhëzimit të paqartë, hapësirës së kufizuar ose nevojës për të ndjekur disa bashkëlojtarë.

Prandaj, krahas mundësive të fëmijës, shqyrtohet se çfarë mund të ndryshohet në aktivitet për ta lehtësuar pjesëmarrjen.

Identifikimi i pengesave në situatën konkrete

E njëjta detyrë futbolli mund të jetë e qasshme për një fëmijë dhe e ndërlikuar për një tjetër. Gjithashtu, pjesëmarrja e të njëjtit fëmijë mund të ndryshojë sipas numrit të pjesëmarrësve, mënyrës së organizimit, kohëzgjatjes dhe kushteve të mjedisit sportiv.

Për shembull, një nxënës që e pason me sukses topin në çift mund të ketë vështirësi kur duhet ta zbatojë të njëjtën aftësi në një lojë me më shumë pjesëmarrës. Në këtë situatë nuk duhet të nxirret menjëherë përfundimi se nxënësi nuk e ka përvetësuar aftësinë. Duhet të shqyrtohet nëse vështirësia buron nga shpejtësia e lojës, ndjekja e disa lëvizjeve njëkohësisht, zgjedhja e bashkëlojtarit ose koha e kufizuar për reagim.

Nga situata e vëzhguar përzgjidhet një ndryshim konkret.

Pengesat që mund ta vështirësojnë pjesëmarrjen

Pengesat që lidhen me organizimin e aktivitetit

Ndryshimet e paparalajmëruara, pritja e gjatë e radhës dhe udhëzimet e shumta njëkohësisht e vështirësojnë pjesëmarrjen. Ndihmojnë renditja e qartë, grupet më të vogla dhe fillimi e përfundimi i shënuar.

Pengesat që lidhen me komunikimin

Udhëzimet tepër të gjata ose të pakuptueshme zëvendësohen me udhëzime të shkurtra, demonstrim dhe mbështetje të përshtatshme vizuale.

Pengesat që lidhen me hapësirën dhe pajisjet

Fusha e pashënuar, sipërfaqja jo e rrafshët ose që rrëshqet, distanca dhe pajisjet e papërshtatshme mund ta vështirësojnë detyrën. Kontrollohen siguria e lëvizjes dhe përshtatshmëria e organizimit hapësinor.

Pengesat që lidhen me ritmin dhe rregullat e lojës

Kur shpejtësia, koha e shkurtër për reagim ose rregullat e ndërlikuara e kufizojnë pjesëmarrjen, përshtaten ritmi, rregullat ose koha e realizimit.

Pengesat që lidhen me kushtet shqisore

Tingujt e fortë, thirrjet e njëkohshme, lëvizjet intensive dhe stimujt e tjerë mund ta vështirësojnë ndjekjen e aktivitetit. Mund të ndihmojë zvogëlimi i tyre, një organizim hapësinor më i qartë ose një pushim i shkurtër.

Vëzhgimi synon përmirësimin e mjedisit, pa etiketuar pjesëmarrësit.

Nga pengesa e identifikuar te ndryshimi konkret

Shembujt lidhin vështirësinë e vërejtur, shkakun e mundshëm dhe ndryshimin në aktivitet.

Tabela 5. Lidhja e pengesave me ndryshimet e mundshme

Situata e vërejtur	Pengesa e mundshme	Ndryshimi i përshtatshëm
Fëmija nuk e fillon detyrën pas udhëzimit gojor.	Udhëzimi nuk është mjaftueshëm i kuptueshëm.	Demonstrim i shkurtër dhe sinjal i qartë për fillim.
Fëmija humbet kontrollin e topit kur lëviz mes disa pjesëmarrësve.	Hapësirë e kufizuar ose ritëm tepër i shpejtë.	Rrugë më e gjerë dhe numër më i vogël pjesëmarrësish.
Fëmija rrallë prek topin gjatë lojës.	Organizimi nuk ofron mundësi të mjaftueshme për pjesëmarrje aktive.	Lojë në grup më të vogël, me më shumë mundësi për pasimin dhe pranimin e topit.
Fëmija e ndërpret aktivitetin kur ka tinguj të fortë dhe të njëkohshëm.	Ngarkesë tepër e madhe nga zhurma.	Zvogëlimi i thirrjeve të njëkohshme dhe mundësia për pushim të shkurtër.
Fëmija e ka të vështirë të arrijë cakun e shënuar.	Distancë ose vendosje e papërshtatshme e cakut.	Përshtatja e distancës dhe e pozicionit të cakut.

Ndryshimi zgjidhet sipas situatës, jo automatikisht; efekti i tij kontrollohet gjatë lojës.

Ruajtja e qëllimit gjatë përshtatjes së aktivitetit

Përshtatja ruan qëllimin sportiv ose arsimor të detyrës.

Nëse qëllimi është zhvillimi i saktësisë së pasimit, distanca mes pjesëmarrësve mund të zvogëlohet, por detyra duhet ende të kërkojë drejtimin e topit te partneri. Nëse qëllimi është orientimi hapësinor, rruga mund të ketë më pak shenja, por fëmija duhet përsëri të lëvizë sipas një rendi të caktuar.

Prandaj, gjatë planifikimit është e rëndësishme të dallohen:

- **Qëllimi i aktivitetit – aftësia ose përvoja që synohet të zhvillohet.**
- **Mënyra e realizimit – kushtet, rregullat, pajisjet dhe mbështetja përmes të cilave arrihet ky qëllim.**

Qëllimi mund të mbetet i njëjtë, ndërsa kushtet të ndryshojnë. Nëse edhe vetë qëllimi nuk është i përshtatshëm për momentin, caktohet një hap më i realizueshëm.

Kontrollimi i efektit të ndryshimeve të bëra

Pas përshtatjes kontrollohet nëse pjesëmarrja është përmirësuar.

Për shembull, nëse distanca e pasimit është zvogëluar, vëzhgohet nëse fëmija e drejton më lehtë topin. Nëse grupi është ndarë në ekipe më të vogla, ndiqet nëse pjesëmarrësi bie më shpesh në kontakt me topin. Nëse udhëzimi është plotësuar me demonstrim, kontrollohet nëse detyra është bërë më e kuptueshme.

Nëse nuk ka përmirësim, situata shqyrtohet sërish dhe zgjidhet një ndryshim tjetër.

Ky cikël është pjesë e planifikimit dhe udhëheqjes së aktiviteteve.

Udhëzim praktik

Identifikoni çfarë në hapësirë, organizim, komunikim, pajisje ose ritëm e vështirëson detyrën. Bëni ndryshimin e përshtatshëm dhe kontrolloni efektin e tij.

2.4. Planifikimi i një aktiviteti gjithëpërfshirës të futbollit

Planifikimi i një aktiviteti gjithëpërfshirës të futbollit është procesi ku njohuritë për pjesëmarrësit kthehen në një plan konkret pune. Pasi të identifikohen interesat, mundësitë dhe pengesat e tyre për pjesëmarrje, duhet të përcaktohen qëllimi i aktivitetit, mënyra e organizimit dhe mbështetja që do të mundësojë realizimin e suksesshëm.

Në qasjen e propozuar, planifikimi i lidh detyrat e futbollit me mundësitë për pjesëmarrje të përbashkët. Kjo nënkupton përzgjedhjen e kujdesshme të aktiviteteve, ndarjen e qartë të roleve dhe përgatitjen e duhur të mësimdhënësve, trajnerëve dhe personave të tjerë të përfshirë në realizim.

Pesë hapa për përgatitjen e aktivitetit

1. Përcaktimi i qëllimit

Përcaktohet aftësia e futbollit ose zbatimi i saj në lojë: udhëheqja e topit, pasimi, pranimi ose gjuajtja drejt portës.

Qëllimi i qartë dhe i realizueshëm udhëzon përzgjedhjen e detyrave.

2. Planifikimi i pjesëmarrjes

Për çdo detyrë parashikohet se si do të përfshihen pjesëmarrësit në realizimin e saj. Është veçanërisht e rëndësishme të shqyrtohet nëse organizimi ofron mundësi të mjaftueshme për kontakt me topin, marrje roli dhe pjesëmarrje në lojën e përbashkët.

Gjatë punës në çifte ose grupe të vogla planifikohet mënyra e nxitjes së bashkëpunimit.

3. Organizimi i detyrave

Përcaktohen renditja, kohëzgjatja e përafërt, grupet dhe vendosja e pajisjeve.

Detyrat kalojnë gradualisht nga njohja e aftësisë te zbatimi i saj në lojë.

4. Përgatitja e mbështetjes

Përgatiten përshtatjet e nevojshme, mënyrat e komunikimit dhe format e mbështetjes.

Sipas detyrës, mund të zgjidhen kartelat e komunikimit në futboll, pasaporta për mbështetjen nga bashkëmoshatarët ose kutia mobile gjithëpërfshirëse POP-UP. Sipas nevojës sigurohet edhe këndi i përshtatur për punë ose pushim.

Kur në realizim marrin pjesë disa të rritur, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre dakordohen paraprakisht.

5. Realizimi dhe përshtatja

Gjatë stërvitjes monitorohet pjesëmarrja dhe, sipas nevojës, ndryshohen organizimi, kohëzgjatja ose mënyra e realizimit.

Pas stërvitjes përcaktohet se çfarë do të zbatohet ose ndryshohet herën tjetër.

Skema e planifikimit të një aktiviteti gjithëpërfshirës të futbollit

QËLLIMI
Cilën aftësi futbolli ose detyrë loje po zhvillojmë?

↓

PJESËMARRJA
Si do të sigurojmë rol aktiv për çdo pjesëmarrës?

↓

ORGANIZIMI
Si do t'i ndajmë detyrat, grupet dhe kohën?

↓

MBËSHTETJA
Cilët persona, përshtatje dhe mjete të projektit nevojiten?

↓

REALIZIMI
Çfarë do të ruajmë ose ndryshojmë sipas rrjedhës së aktivitetit?

Bashkërendimi i ekipit para stërvitjes

Kur aktiviteti realizohet nga një mësimdhënës, trajner dhe profesionistë të tjerë, është e dobishme që para fillimit të bashkërendohen shkurtimisht për rrjedhën e stërvitjes. Të gjithë duhet ta njohin qëllimin kryesor, renditjen e detyrave dhe mënyrat e dakorduara të mbështetjes.

Dakordohen edhe kalimet: riorganizimi i pjesëmarrësve, përgatitja e pajisjeve dhe prezantimi i detyrës së ardhshme.

Kështu mbështetja ofrohet në kohë dhe udhëheqja bëhet e qartë dhe e parashikueshme.

Udhëzim praktik

Plani u përgjigjet tri pyetjeve: çfarë do të mësohet, si do të marrin pjesë fëmijët dhe çfarë nevojitet për realizim. Pesë hapat i lidhin këto vendime.

2.5. Hapësira e futbollit që mundëson lëvizje të sigurt dhe pjesëmarrje aktive

Mënyra si organizohet hapësira e futbollit ndikon në lëvizje, orientim dhe pjesëmarrje në lojë. Vendosja e portave, shenjave, pajisjeve dhe vendeve të grumbullimit mund ta lehtësojë realizimin e detyrave, por edhe të krijojë pengesa të panevojshme nëse nuk përputhet me aktivitetin dhe mundësitë e pjesëmarrësve.

Në „Touch the Goal", përgatitja e hapësirës është pjesë përbërëse e krijimit të mjedisit sportiv gjithëpërfshirës. Qëllimi është që pjesëmarrësit ta kenë më të lehtë të dallojnë ku zhvillohet loja, si lëvizin në fushë dhe ku mund të marrin mbështetje kur u nevojitet.

Për këtë nuk nevojitet patjetër një objekt sportiv i pajisur posaçërisht. Një sallë shkolle ose fushë sportive e përshtatshme mund të organizohet për aktivitete të ndryshme futbolli nëse sigurohen kushtet bazë për siguri, qasje dhe lëvizje pa pengesa.

Hapësira që e bën detyrën të kuptueshme

Para stërvitjes kontrollohet nëse organizimi i hapësirës e bën të qartë detyrën.

Për shembull, në një ushtrim të udhëheqjes së topit, pjesëmarrësit duhet ta dallojnë lehtë pozicionin fillestar, rrugën e lëvizjes dhe vendin ku përfundon detyra. Nëse vendosen disa ushtrime njëkohësisht, ato duhet të jenë mjaftueshëm larg njëri-tjetrit dhe të ndara vizualisht.

Përdoren aq shenja sa nevojiten për lëvizje të qartë, pa e mbushur fushën në mënyrë të panevojshme.

Organizimi i qartë e zvogëlon nevojën për përsëritje të udhëzimeve gojore dhe e nxit pavarësinë.

Katër zona funksionale në hapësirën sportive

Është e dobishme të dallohen katër zona funksionale:

1. Vendi për grumbullim dhe përgatitje

Vend për grumbullim, njohje me detyrën dhe udhëzime të shkurtra, me pamje të mirë mbi hapësirën e aktivitetit.

2. Hapësira për lojën e futbollit

Pjesa e fushës me hapësirë të mjaftueshme për lëvizje, pasim, pranim dhe ndryshim drejtimi, sipas detyrës dhe numrit të pjesëmarrësve.

3. Vendi për pajisjet

Zona për topat dhe mjetet që nuk përdoren, me qasje të lehtë dhe pa penguar lëvizjen.

4. Hapësira për mbështetje shtesë dhe pushim të shkurtër

Këndi i përshtatur për shpjegime shtesë, punë më të qetë ose pushim të shkurtër. Aty mund të përdoret edhe kutia mobile gjithëpërfshirëse POP-UP. Këndi është hapësirë mbështetëse, ndërsa kutia është mjet i bartshëm.

Zonat nuk është e domosdoshme të jenë të ndara fizikisht. Organizimi përshtatet sipas kushteve, duke mundësuar kalim të thjeshtë dhe të sigurt ndërmjet tyre.

Siguria fillon nga organizimi i hapësirës

Para aktivitetit kontrollohen gjendja e sipërfaqes, qëndrueshmëria e portave, vendosja e mjeteve dhe pengesat e mundshme në hapësirë. Vëmendje e veçantë u kushtohet vendeve ku pjesëmarrësit përshpejtojnë, ndalojnë ose ndryshojnë drejtimin e lëvizjes.

Rrugët e grupeve ndahen qartë për të shmangur përplasjet. Topat dhe mjetet që nuk përdoren, largohen nga hapësira aktive.

Duhet të sigurohet edhe qasje për pjesëmarrësit që përdorin mjete ndihmëse për lëvizje. Rrugët duhet të jenë pa pengesa, ndërsa organizimi duhet të mundësojë hyrje dhe lëvizje të sigurt brenda aktivitetit të planifikuar.

Siguria kontrollohet edhe kur ndryshohen detyrat ose vendosja e pajisjeve.

Hapësira ndryshon sipas aktivitetit

Organizimi i hapësirës ndryshohet sipas detyrës së futbollit.

Për ushtrimet e saktësisë mund të nevojitet një drejtim i shënuar qartë drejt cakut. Për udhëheqjen e topit sigurohet një rrugë e lirë lëvizjeje. Gjatë lojës në grupe të vogla është veçanërisht e rëndësishme të parashikohet hapësirë e mjaftueshme që bashkëlojtarët të lëvizin dhe të reagojnë ndaj topit.

Ndryshimet paralajmërohen qartë dhe pajisjet zhvendosen pa krijuar pengesa.

Kështu, e njëjta hapësirë përdoret për aktivitete të ndryshme përmes ndryshimeve të thjeshta organizative.

Kontroll i shkurtër para fillimit të stërvitjes

Para fillimit të aktivitetit, mësimdhënësi ose trajneri kontrollon:

- A janë sipërfaqja, portat dhe mjetet e sigurta për përdorim?
- A janë rrugët e lëvizjes të lira dhe të përshtatshme për pjesëmarrësit?
- A janë shënuar qartë pozicionet fillestare dhe drejtimet e lëvizjes?
- A ka hapësirë të mjaftueshme ndërmjet grupeve që punojnë njëkohësisht?
- A janë vendosur pajisjet që nuk përdoren jashtë pjesës aktive të fushës?
- A kanë të gjithë pjesëmarrësit qasje të sigurt në vendet e parashikuara për aktivitet dhe mbështetje?

Ky kontroll ndihmon të përcaktohet në kohë çfarë duhet përgatitur ose ndryshuar.

Udhëzim praktik

Gjatë përgatitjes së hapësirës së futbollit, mendoni për lëvizjen nga këndvështrimi i pjesëmarrësit: ku duhet të fillojë, në cilën rrugë do të lëvizë, ku përfundon detyra dhe si mund të ketë qasje në mbështetje. Hapësira që jep përgjigje të qarta për këto pyetje mundëson pjesëmarrje më të sigurt dhe më të pavarur.

2.6. Rrugë të ndryshme drejt të njëjtit qëllim në futboll

Në lojën e futbollit, pjesëmarrësit mund të zhvillojnë të njëjtën aftësi edhe nëse e kryejnë detyrën në mënyra të ndryshme. Për dikë mund të jetë i përshtatshëm një top më i lehtë, për një tjetër më shumë kohë për reagim, ndërsa një i tretë mund të përfshihet më lehtë me një rregull të ndryshuar ose mbështetje nga bashkëlojtari.

Detyra e përbashkët ruhet, ndërsa kushtet e pjesëmarrjes përshtaten.

Pajisje që e mbështesin aftësinë e futbollit

Zgjedhja e topit dhe mjeteve të tjera duhet të bazohet në detyrën konkrete.

Gjatë mësimit të pasimit mund të përdoret një top më i madh ose më i butë që kontrollohet më lehtë. Një top me ngjyrë që dallon nga sipërfaqja mund të ndihmojë ndjekjen vizuale, ndërsa një cak i shënuar qartë mund të lehtësojë drejtimin e gjuajtjes.

Një ndryshim në pajisje ndonjëherë mund t'i shërbejë gjithë grupit.

Pajisjet zgjidhen sipas aftësisë që po zhvillohet.

Rregulla që krijojnë më shumë mundësi për lojë

Rregullat e përshtatura mund të sigurojnë më shumë prekje të topit dhe bashkëpunim më të madh.

Për shembull, në një lojë pasimesh mund të dakordohet që topi të kalojë te disa bashkëlojtarë përpara gjuajtjes drejt portës. Gjatë ushtrimit fillestar mund të lejohet që topi të ndalet para pasimit të radhës.

Me përvetësimin e detyrës, gradualisht futen situata loje më të ndërlikuara.

Rregullat lënë hapësirë për nismë, zgjedhje dhe bashkëpunim.

Kohë për të kuptuar dhe realizuar

Gjatë mësimit të një detyre të re lihet kohë për vëzhgim, vlerësim dhe reagim.

Përpjekjet e para mund të jenë pa kufizim kohor. Më pas shtohen lëvizja, pasimi më i shpejtë ose një zgjedhje e re.

Për shembull, gjatë pranimit dhe pasimit të topit, pjesëmarrësi mund ta ndalë fillimisht topin, të zgjedhë bashkëlojtarin dhe pastaj ta pasojë. Në fazën tjetër nxitet lidhja e pranimit dhe pasimit në një lëvizje të vetme.

Koha shtesë e mbështet të nxënit, duke ruajtur një nivel të përshtatshëm sfide.

Role që ndryshojnë me përparimin

Rolet zgjidhen sipas detyrës dhe mundësive aktuale të pjesëmarrësve.

Gjatë punës në çift, një pjesëmarrës mund të pasojë nga vendi, ndërsa tjetri lëviz për ta pranuar topin. Më pas rolet ndërrohen. Në grup të vogël, pjesëmarrësi mund të përfshihet fillimisht në pasime dhe më pas të marrë rol në përfundimin e aksionit.

Ndërrimi i roleve e zgjeron pjesëmarrjen dhe parandalon ndarjen e përhershme në detyra më të lehta dhe më të vështira.

Mbështetja nga bashkëmoshatarët ka rëndësi të veçantë kur bashkëlojtari e ndihmon pjesëmarrësin të dallojë mundësinë për pasim, i lë kohë të reagojë ose e inkurajon të marrë një rol të ri. Mbështetja duhet ta forcojë pavarësinë, jo ta zëvendësojë pjesëmarrjen e tij.

Model praktik:
Një lojë, disa mundësi
Aktiviteti:
„Rruga drejt portës“

Qëllimi: Pjesëmarrësit të bashkëpunojnë përmes pasimit, pranimit dhe drejtimit të topit drejt portës.

Loja organizohet në grupe të vogla. Detyra është që përmes pasimeve të përbashkëta të krijohet mundësi për gjuajtje drejt portës.

Sipas nevojave të grupit, mësimdhënësi ose trajneri mund të zbatojë disa ndryshime.

Tabela 6. Përshtatja e lojës „Rruga drejt portës“

Elementi	Ndryshimi i mundshëm në lojë
Topi	Top më i butë ose më i dukshëm
Distanca	Distanca më të shkurtra ndërmjet bashkëlojtarëve
Rregulli	Lejohet ndalimi i topit para pasimit
Koha	Më shumë kohë për të zgjedhur veprimin e radhës
Rolet	Ndërrimi i roleve gjatë pasimit dhe gjuajtjes përfundimtare
Mbështetja nga bashkëmoshatarët	Bashkëlojtari vendoset në një pozicion të arritshëm dhe tregon qartë se është gati ta pranojë topin

Në fazën fillestare, grupi mund të luajë pa presion nga kundërshtari. Më pas futet gradualisht një kundërshtar, lëvizje shtesë ose ndryshim më i shpejtë i pozicioneve.

Loja zhvillohet më tej sipas gatishmërisë së pjesëmarrësve, duke ruajtur bashkëpunimin.

Si ta kuptojmë se përshtatja po e arrin qëllimin?

Ndiqen realizimi më aktiv i detyrës, bashkëpunimi dhe pavarësia më e madhe.

Nëse detyra është tepër e lehtë, shtohet një sfidë; nëse është tepër e vështirë, rishikohen kushtet.

Ndryshimi i një elementi të rëndësishëm në një çast të caktuar e lehtëson vlerësimin e efektit të tij.

Udhëzim praktik

Para se të zëvendësoni një detyrë futbolli me një tjetër, shqyrtoni nëse ndryshimi i pajisjes, rregullit, kohës ose rolit mund të krijojë mundësi më të mira për pjesëmarrje. Përshtatja është më e dobishme kur i mundëson pjesëmarrësit të përparojë gradualisht në lojën e përbashkët.

2.7. Gatishmëria për pjesëmarrje: komunikimi, parashikueshmëria dhe mbështetja individuale

Menjëherë para detyrës, pjesëmarrësi përgatitet të kuptojë renditjen, të dallojë fillimin dhe të dijë si të kërkojë mbështetje.

Para fillimit: çfarë do të bëjmë sot?

Paraqiten pjesët kryesore të stërvitjes.

Një renditje e thjeshtë është: nxehja, ushtrimi me top, loja e përbashkët dhe përfundimi.

Orari shërben për orientim dhe mund të përshtatet sipas grupit.

Udhëzim që çon në veprim

Udhëzimet janë të shkurtra, konkrete dhe të lidhura drejtpërdrejt me veprimin.

Për shembull, në vend që pranimi, lëvizja dhe pasimi të shpjegohen njëkohësisht, detyra mund të prezantohet me radhë: „Pranoje topin“, „Shikoje bashkëlojtarin“, „Pasoje“.

Sipas nevojës detyra demonstrohet, pastaj mundësohet të provohet.

Kalimet ndërmjet aktiviteteve

Kalimi në detyrë, vend ose grup të ri mund të kërkojë përgatitje të shkurtër.

Është e dobishme të paralajmërohet shkurtimisht kalimi: „Edhe dy pasime, pastaj kalojmë te loja drejt portës“.

Në një detyrë të re tregohet fillimisht vendi, pastaj jepet udhëzimi.

Kalimet e paralajmëruara e zvogëlojnë pritjen pa detyrë të qartë.

Mbështetje e qasshme gjatë fillimit

Para fillimit të detyrës, pjesëmarrësit i tregohet kujt mund t'i drejtohet për ndihmë dhe si mund ta kërkojë – me fjalë, gjest ose shenjë të dakorduar.

Kontroll i shkurtër i gatishmërisë

Para aktivitetit kryesor shtrohen tri pyetje:

A e di pjesëmarrësi çfarë vjen më pas?
A i është prezantuar detyra në një mënyrë që mund ta kuptojë?

A e di si të fillojë?
A e dallon pozicionin fillestar, rolin ose veprimin e parë?

A e di ku mund të marrë mbështetje?
A e ka të qartë kujt mund t'i drejtohet dhe si të kërkojë ndihmë?

Kontrollohet kuptimi i detyrës, pa vlerësim formal të fëmijës.

2.8. Gati për lojë: kontroll praktik para, gjatë dhe pas stërvitjes

Plani në pjesën 2.4 përcakton aktivitetin; kontrolli i mëposhtëm tregon se si funksionon ai para, gjatë dhe pas stërvitjes.

„Gati për lojë“ është një kontroll i shkurtër pune për organizimin dhe pjesëmarrjen. Mund të përdoret me fleksibilitet, sipas aktivitetit dhe nevojave të grupit.

Para stërvitjes: a kemi krijuar kushte për pjesëmarrje?

Para ardhjes së pjesëmarrësve kontrollohen kushtet e renditura në tabelë.

Tabela 7. Kontrolli i kushteve para stërvitjes

Pyetje kontrolli	Po	Nevojitet ndryshim
A është i qartë qëllimi futbollistik i stërvitjes?	□	□
A mundësojnë detyrat mënyra të ndryshme pjesëmarrjeje?	□	□
A janë hapësira dhe pajisjet të sigurta dhe të qasshme?	□	□
A është parashikuar mbështetja e nevojshme për pjesëmarrësit?	□	□
A është e qartë si do të prezantohen detyrat dhe kalimet ndërmjet tyre?	□	□
A janë dakorduar rolet e të rriturve që e realizojnë stërvitjen?	□	□

Kontrolli shërben për përgatitje në kohë dhe nuk krijon detyrim shtesë administrativ.

Gjatë lojës: çfarë na tregon pjesëmarrja?

Gjatë lojës ndiqet se si funksionon detyra e planifikuar me grupin konkret.

Vëzhgohen veprimet me topin, roli i secilit fëmijë dhe pjesëmarrja në detyrën e përbashkët.

Tre tregues ndihmojnë për vlerësim të shpejtë:

Përfshirja – A ka pjesëmarrësi mundësi reale të jetë pjesë e aktivitetit, apo pjesën më të madhe të kohës e kalon duke pritur?

Pavarësia – A mund ta nisë ose vazhdojë detyrën me mbështetjen që i nevojitet, pa e kryer dikush vazhdimisht në vend të tij?

Bashkëpunimi – A krijon aktiviteti mundësi për pasime, veprime të përbashkëta dhe kontakt me bashkëlojtarët?

Ndryshimi mund të bëhet edhe pa e ndërprerë të gjithë grupin, nëse e lejojnë siguria dhe organizimi.

Pas stërvitjes: çfarë mësuam për aktivitetin e ardhshëm?

Pas stërvitjes veçohen më së shumti tri vërejtje konkrete:

Shënohen mbështetja e dobishme, vështirësia dhe ndryshimi i ardhshëm.

Çfarë funksionoi mirë?

Cila detyrë, mënyrë organizimi ose formë mbështetjeje mundësoi pjesëmarrje aktive?

Çfarë paraqiti vështirësi?

Në cilën pjesë të stërvitjes nevojitej ndryshim shtesë?

Çfarë do të bëjmë ndryshe herën tjetër?

Cilin ndryshim konkret do ta zbatojmë në stërvitjen e ardhshme?

Mjafton një vendim konkret për stërvitjen e ardhshme, i shënuar si rikujtues i shkurtër pune.

Kështu planifikimi, zbatimi dhe përshtatja lidhen në një cikël pune. Mjetet që e mbështesin trajtohen në kapitullin 3.

Kapitulli 3

Mjetet inovative të „Touch the Goal“

Hyrje

Hartimi i qasjeve, metodave dhe mjeteve të ndryshme që nxisin përfshirjen aktive, mirëkuptimin e ndërsjellë dhe krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë është pjesë veçanërisht e rëndësishme e praktikës gjithëpërfshirëse.

Duke u mbështetur në këto vëzhgime, ekipi i SHFQR „Idnina“ – Shkup, në kuadër të „Touch the Goal – Futboll për çdo fëmijë“, konceptoi dhe përgatiti tri mjete inovative për përdorim në aktivitetet gjithëpërfshirëse të futbollit. Gjatë përgatitjes së disa kartelave të komunikimit u përdorën piktograme ekzistuese nga ARASAAC, me emërtime në gjuhën maqedonase. Kontributi origjinal i ekipit lidhet me konceptimin, organizimin, përgatitjen dhe mënyrën e zbatimit praktik të mjeteve. Gjatë stërvitjeve, mjetet u përdorën për të mbështetur pjesëmarrjen aktive, komunikimin dhe bashkëpunimin me bashkëmoshatarët.

Këto mjete promovojnë një qasje ku dallimet njihen si vlerë, jo si pengesë për përvojën e përbashkët. Ato janë menduar me kujdes për të njohur aftësitë e fëmijëve, për t'i nxitur fëmijët të mësojnë nga njëri-tjetri, të zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë dhe të ndërtojnë marrëdhënie pozitive me bashkëmoshatarët.

Në këtë kapitull paraqiten qasjet dhe mjetet inovative të lidhura me realizimin e projektit, qëllimi i tyre, mënyra e përdorimit dhe mundësitë e përshtatjes në kontekste të ndryshme arsimore dhe sportive. Theks i veçantë i vihet vlerës së tyre praktike dhe potencialit për të shërbyer si frymëzim për mësimdhënësit, asistentët arsimor, bashkëpunëtorët profesional, trajnerët dhe organizatat që punojnë për përmirësimin e gjithëpërfshirjes. Ato nuk e zëvendësojnë planifikimin profesional, vlerësimin individual ose masat për mbrojtjen e fëmijëve dhe mund të përdoren:

• veçmas; • në kombinime të ndryshme; • para, gjatë dhe pas aktivitetit;	• me të gjithë grupin ose me pjesëmarrës të caktuar; • në një aktivitet të vetëm ose program afatgjatë; • në formë të shtypur ose digjitale të përshtatur siç duhet.

Qëllimi nuk është vetëm prezantimi i mjeteve konkrete, por ofrimi i një përvoje që mund të zbatohet, zhvillohet dhe përshtatet, me një mesazh të thjeshtë: Çdo fëmijë ka vendin e vet në lojë.

Në vijim prezantohen veçmas tri mjetet inovative dhe këndi i përshtatur si hapësirë për punë dhe pushim. Këndi nuk është i njëjtë me kutinë mobile: në të mund të përdoren mjete të ndryshme sipas nevojave të fëmijës..

Sistem i ndërlidhur mjetesh për pjesëmarrje aktive

Mjetet u zhvilluan mbi bazën e një kornize metodologjike të përbashkët, ku secili kontribuon në arritjen e qëllimit më të gjerë të projektit. Kjo qasje e vendos pjesëmarrësin në qendër. Në vend që fëmija të përshtatet me një aktivitet të pandryshueshëm, mjetet ndihmojnë që aktiviteti të bëhet më i kuptueshëm, më fleksibil dhe më i qasshëm.




Figura 2. Ndërlidhja e mjeteve për pjesëmarrje aktive

Skema lidh kuptimin e aktivitetit, bashkëpunimin, mbështetjen gjatë pushimit dhe pjesëmarrjen e rëndësishme.

Kjo kornizë metodologjike nxiti pyetje të ndryshme praktike që shërbyen si bazë për dizajnimin e mjeteve.

3.1. Kartelat e komunikimit në futboll (Football Talk Cards)

Football Talk Cards janë mjet për komunikim, të nxënë dhe motivim të lojtarëve. Këto kartela vendosen në një tabelë të bardhë magnetike dhe përdoren për:

- mbështetjen e bisedës dhe reflektimit (i ndihmojnë fëmijët të flasin për atë që ndodhi në fushë);
- përmirësimin e aftësive sociale (bisedojnë për punën në ekip, fer plej, komunikim);
- motivimin dhe vetëvlerësimin;
- mësimin e termave dhe rregullave të futbollit (portier, penallti, faull, pozicion jashtë loje);
- njohjen e pozicioneve dhe roleve në ekip.

Kartelat e komunikimit në futboll janë një mjet i krijuar për t'i ndihmuar pjesëmarrësit t'i kuptojnë më lehtë aktivitetet, të bëjnë zgjedhje, të kërkojnë mbështetje dhe ta shprehin përvojën e tyre.

Figurat e thjeshta dhe të njohura, mesazhi kryesor në pjesën e poshtme të kartelës, shkronjat e qarta, të shkurtra e lehtë të lexueshme, kontrasti i fortë mes tekstit dhe sfondit, formati mjaftueshëm i madh, vendosja e qëndrueshme e figurës dhe fjalës, si dhe materiali që mund të pastrohet e të përdoret shumë herë, e bëjnë këtë mjet shumë funksional.



Figura 3. Kartelat e komunikimit në futboll në tabelën magnetike
Kompleti mundëson përzgjedhjen dhe paraqitjen vizuale të nocioneve, veprimeve dhe nevojave që lidhen me futbollin.

Ky mjet është në dispozicion në disa gjuhë: maqedonisht, shqip dhe turqisht.

Kartelat mund të përdoren nga të gjithë pjesëmarrësit, por janë veçanërisht të dobishme për fëmijët që:

• i kuptojnë më lehtë udhëzimet vizuale sesa ato të gjata gojore; • përdorin pak ose aspak të folur; • kanë nevojë për kohë shtesë për përpunimin e informacionit; • komunikojnë me simbole, fotografi, gjeste ose mjete të tjera;	• marrin pjesë në një mjedis ku nuk e njohin mjaftueshëm gjuhën; • kanë vështirësi të shprehin ndjenjat, zgjedhjet ose nevojën për ndihmë; • ndihen të pasigurt në një aktivitet të ri ose dinamik; • kanë nevojë për renditje të qartë dhe parashikueshmëri.

Përmes këtyre kartelave, pjesëmarrësi merr rol aktiv. Ai nuk është vetëm person që merr udhëzime, por një individ që mund të kuptojë çfarë vjen më pas, të njohë detyrën, të zgjedhë aktivitetin, rolin ose pajisjen, të kërkojë ndihmë a pushim, të shprehë gatishmëri ose refuzim, të japë reagim të thjeshtë dhe të komunikojë me bashkëmoshatarët e të rriturit.

3.1.1. Përgatitja për përdorimin e kartelave të komunikimit në futboll (Football Talk Cards)

Para aktivitetit, personi përgjegjës (mësimdhënës, trajner ose bashkëpunëtor profesional) duhet:

• të përcaktojë cilat kartela do të nevojiten realisht; • të zgjedhë një numër të vogël dhe funksional kartelash; • t'ua prezantojë simbolet pjesëmarrësve; • të tregojë si zgjidhet dhe përdoret një kartelë;	• t'i vendosë në një vend të dukshëm dhe të qasshëm; • të kontrollojë nëse çdo pjesëmarrës mund t'i shohë, t'i arrijë ose t'i tregojë; • të dakordojë si do të reagohet kur dikush përdor një kartelë.

Nuk është gjithmonë e nevojshme të përdoret i gjithë kompleti. Shumë kartela mund ta vështirësojnë zgjedhjen. Në fillim mund të ofrohen dy deri në katër mesazhet më të rëndësishme, ndërsa numri të rritet gradualisht.




Figura 4. Kartela „Pushim“

Simboli i mundëson pjesëmarrësit të kërkojë ndërprerje për pushim ose mbështetje shtesë.

Kartelat nuk duhet të ndahen në „kartela për fëmijët me aftësi të kufizuara“ dhe „kartela për të tjerët“.

Kur janë të qasshme për të gjithë grupin, ato bëhen pjesë e natyrshme e komunikimit dhe e zvogëlojnë rrezikun e veçimit.

Për shembull, kartela „pushim“ mund të jetë e qasshme për të gjithë, jo vetëm për një fëmijë të përcaktuar paraprakisht. Kështu nevoja për pushim pranohet si pjesë normale e vetërregullimit.

Për përdorimin me sukses të këtij mjeti duhet të ndiqen disa hapa të njëpasnjëshëm:

Hapi 1 – Prezantoje (trego kartelën, lexo mesazhin dhe shpjego kur mund të përdoret).

Hapi 2 – Lidheni me veprimin (trego kartelën ULU NË RRETH dhe menjëherë trego vendin e parashikuar për atë aktivitet).

Hapi 3 – Ushtro pa presion (pjesëmarrësit le të zgjedhin kartelën në një situatë provë, pa garë dhe kufizim kohor).




Figura 5. Shembuj nga kartelat e komunikimit
Paraqiten kartela që zgjidhen dhe lidhen me veprime konkrete gjatë aktivitetit.

Hapi 4 – Përdore në aktivitetin real (kartelat le të jenë të qasshme gjatë lojës dhe të rriturit e bashkëmoshatarët t'i respektojnë vazhdimisht mesazhet e tyre).

Hapi 5 – Kontrollo dobinë e kartelës (ndiq motivimin dhe sjelljen e nxënësve; çdo mesazh nga nxënësi kërkon përgjigje nga i rrituri).

3.1.2. Shembuj të prezantimit të kartelave dhe lidhjes së tyre me veprimin




Figura 6. Kartela „Ulu në rreth". Mesazh vizual për grumbullimin në rreth.



Figura 7. Ulja në rreth gjatë aktivitetit. Paraqitje e organizimit në grup me pjesëmarrësit dhe drejtuesit.




Figura 8. Kartela „Ekipi". Simbol i punës së përbashkët dhe përkatësisë në ekip.



Figura 9. Fotografi e grupit të pjesëmarrësve. Shembull i lidhjes së nocionit „ekip" me një grup konkret.




Figura 10. Kartela „Paso". Mesazh vizual për pasimin e topit.



Figura 11. Ushtrim me top dhe kon. Shembull i lidhjes së kartelës me punën praktike në fushë.

3.1.3. Shembull praktik i përdorimit të kartelave të komunikimit në futboll (Football Talk Cards)

Qëllimi: Pjesëmarrësi të bëjë zgjedhje dhe të përfshihet në mënyrë aktive në ushtrimet e nxehjes.

Kartelat e përgatitura:




Figura 12. Kartelat për shembullin praktik
Paraqiten dhjetë mesazhet që mbështesin zgjedhjen, lëvizjen, pushimin dhe rrjedhën e aktivitetit.

Para fillimit të aktivitetit, kartelat vendosen në një vend të dukshëm dhe të qasshëm në tabelën magnetike; kartelat e tjera nuk vendosen në tabelë. Çdo pjesëmarrësi i jepet mundësia t'i shikojë kartelat, të njihet me kuptimin e tyre dhe pastaj t'i vendosë në vendin e shënuar në pjesën e poshtme të tabelës.



Figura 13. Kompleti i përgatitur i kartelave të komunikimit në futboll
Nga kompleti i paraqitur zgjidhen mesazhet që nevojiten për aktivitetin konkret.

Trajneri i shpjegon simbolet përmes udhëzimeve të shkurtra dhe demonstrimit të lëvizjeve. Më pas zgjidhet cilat ushtrime do të realizohen së pari. Kartelat e ushtrimeve që do të kryhen të parat vendosen në pjesën e sipërme të tabelës.




Figura 14. Tabela për renditjen vizuale të aktiviteteve
Kartelat vendosen në fushat e shënuara që pjesëmarrësi të mund të ndjekë rrjedhën e dakorduar.

Zgjedhja mund të bëhet me tregim, marrje të kartelës, shprehje verbale ose përmes komunikimit ndihmës. Renditja vizuale në tabelë nuk duhet të jetë vetëm një seri udhëzimesh të caktuara paraprakisht. Nxënësi duhet të ketë mundësi të marrë pjesë në krijimin e saj, të bëjë zgjedhje dhe të kërkojë ndryshim kur nevojitet. Numri i kartelave mund të zvogëlohet ose rritet sipas nevojave individuale.

Në këtë rast aktiviteti zhvillohet në disa hapa.

Tabela 8. Hapat për përdorimin e kartelave gjatë aktivitetit

Hapi	Udhëzimi dhe veprimi
1. Fillimi	Një nxënës zgjedh kartelën „fillimi“ dhe shënon nisjen e nxehjes.
2. Organizimi	Me kartelën „ulu në rreth“, grupi organizohet në rreth.
3. Lëvizja	Pjesëmarrësi zgjedh „përpara“ ose „prapa“ dhe grupi e ndjek lëvizjen.
4. Aktiviteti fizik	Pjesëmarrësi zgjedh „kërcim“ dhe të gjithë e kryejnë lëvizjen përkatëse ose variantin e përshtatur të saj.
5. Bashkëpunimi me bashkëmoshatarët	Me kartelën „paso“, nxënësit ia pasojnë topin njëri-tjetrit.
6. Ndryshimi	Me kartelën „ndërrimi“ ndryshohen rolet ose drejtuesi i aktivitetit.
7. Pushimi	Me kartelën „ujë“ bëhet një pushim i shkurtër për hidratim.
8. Përfundimi	Një nxënës zgjedh kartelën „bilbili“ ose „fundi“ dhe shënon përfundimin e nxehjes.

Theks i veçantë vihet te roli aktiv i pjesëmarrësve në proces:

- të zgjedhin vetë ose me mbështetje aktivitetin e radhës;
- t'i japin udhëzime grupit të bashkëmoshatarëve përmes kartelave;
- të kenë mundësi të udhëheqin nxehjen;
- të marrin pjesë në lëvizje sipas mundësive të veta;
- të bashkëpunojnë me nxënësit e tjerë dhe t'i nxisin të ndjekin zgjedhjen.

Për të mundësuar pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve, aktivitetet mund të përshtaten:

- të ofrohen dy ose më shumë mundësi për zgjedhje;
- lëvizjet të realizohen në këmbë, ulur ose me mjete ndihmëse;
- të mundësohet kohë shtesë për të kuptuar dhe zgjedhur;
- të sigurohet mbështetje shtesë nga asistenti, e orientuar drejt pavarësisë dhe jo vendimmarrjes në vend të nxënësit.

Pas përfundimit të aktivitetit, pjesëmarrësit:

- njohin dhe zgjedhin aktivitetin sipas interesave dhe mundësive të veta;
- shprehin zgjedhjen përmes të folurit, gjestit, simbolit ose kartelës;
- marrin pjesë aktivisht në ushtrimet e nxehjes;
- zhvillojnë ndjenjën e pavarësisë dhe kontrollit mbi pjesëmarrjen e vet;
- zhvillojnë komunikimin, bashkëpunimin dhe mbështetjen me bashkëmoshatarët.

Pas përfundimit të çdo hapi, kartela mund të hiqet ose të shënohet. Kështu pjesëmarrësi merr një pasqyrë vizuale të rrjedhës dhe përfundimit të detyrës.

Përvoja e mësimdhënësve nga përdorimi praktik i këtij mjeti tregoi se, për efikasitet më të madh, duhen shmangur:

- përdorimi i shumë kartelave njëkohësisht;
- supozimi se simboli kuptohet automatikisht;
- ndryshimi i kuptimit të të njëjtit simbol;
- përdorimi i kartelës pa veprim ose përgjigje përkatëse;
- detyrimi i pjesëmarrësit të komunikojë vetëm përmes kartelave;
- heqja e mjetit ekzistues të komunikimit të nxënësit;
- mbajtja e kartelave nga i rrituri, ndërsa fëmijët të mos kenë qasje;
- paraqitja e përdorimit të tyre si diçka e pazakontë;
- shpërfillja e kartelës „pushim“ ose „nuk dua“;
- përdorimi i materialeve si test ose si mjet për vlerësimin e fëmijës.

Suksesi nuk matet me numrin e kartelave të përdorura. Duhet të ndiqet nëse pjesëmarrësi:

- i kupton më lehtë detyrat;
- mbetet më rrallë i pasigurt ose pasiv;
- bën më shumë zgjedhje të pavarura;
- kërkon më shpesh ndihmë në një mënyrë të kuptueshme;
- shfaq siguri më të madhe;
- komunikon me bashkëmoshatarët;
- përfshihet ose rikthehet më lehtë në aktivitet;
- mund të tregojë çfarë i përshtatet dhe çfarë jo.

Mesazhi kyç: Kartelat e komunikimit në futboll nuk flasin në vend të pjesëmarrësit. Ato i sigurojnë një mënyrë shtesë për të kuptuar, zgjedhur, shprehur veten dhe ndikuar në pjesëmarrjen e vet.

3.1.4. Mësimet e nxjerra nga përdorimi i mjetit

Për përdorim më të lehtë, nevojitet zgjerimi i nocioneve të përfshira në kartela dhe organizimi i tyre në gjashtë grupe funksionale:

- Kartela për fillimin, rrjedhën dhe përfundimin (prit, radha ime, radha jote, edhe një herë...). Këto kartela e ndihmojnë pjesëmarrësin të ndjekë rrjedhën e aktivitetit.
- Kartela për veprimet e futbollit (vrapo, ec, luaj me bashkëmoshatarin, luaj në grup...). Këto paraqesin detyrat dhe lëvizjet themelore.

- Kartela për zgjedhje (top i madh ose i vogël, më ngadalë ose më shpejt, më afër ose më larg...).
- Kartela për nevoja dhe mbështetje (nuk e kuptoj, nuk dua, më trego, më ndihmo...). Këto mesazhe janë veçanërisht të rëndësishme për sigurinë dhe vetëpërfaqësimin. Ato duhet të jenë vazhdimisht të qasshme, jo vetëm kur i rrituri vlerëson se fëmijës i duhen.
- Kartela për ndjenjat dhe gjendjen trupore (jam i/e lumtur, jam i/e lodhur, më dhemb, jam i/e zemëruar...). Kartela nuk është mjet diagnostik. Ajo hap mundësi komunikimi, pas së cilës i rrituri duhet të kontrollojë me kujdes se çfarë mbështetje nevojitet.
- Kartela për bashkëpunim dhe reagim (hajde së bashku, radha jote, përsëri...). Përmes tyre, komunikimi nuk kufizohet vetëm te udhëzimet, por përfshin marrëdhëniet, inkurajimin dhe reflektimin.

Komunikimi vizual, mbështetja nga bashkëmoshatarët dhe mundësia për pushim mund t›u shërbejnë të gjithë pjesëmarrësve.

Kur mjetet përfshihen natyrshëm në organizimin e të gjithë grupit:

• zvogëlohet veçimi; • shmanget etiketimi; • rritet parashikueshmëria;	• përmirësohet komunikimi; • zhvillohet kultura e mbështetjes së ndërsjellë; • çdo pjesëmarrës merr mundësi të zgjedhë çfarë e ndihmon.

3.2. Kutia mobile gjithëpërfshirëse POP-UP

(Football Pop-Up Inclusion Corner)

Kutia mobile gjithëpërfshirëse POP-UP është një mjet që bartet për punë individuale dhe të përbashkët. Përmes një tabele vizuale të futbollit dhe zhetonëve, pjesëmarrësit mund të eksplorojnë pozicionet, rregullat dhe aksionet e futbollit, të planifikojnë dhe të bashkëpunojnë. Mjeti mund të përdoret në vende të ndryshme, përfshirë këndin e përshtatur, sipas qëllimit të aktivitetit dhe nevojave të fëmijës.



Figura 15. Përdorimi i kutisë mobile gjithëpërfshirëse POP-UP
Tabela vizuale e futbollit dhe zhetonët përdoren për të planifikuar pozicionet, aksionet dhe bashkëpunimin ekipor.

Ky mjet është një aktivitet ndërveprues ku nxënësit, përmes tabelës vizuale të futbollit, kanë mundësi të planifikojnë, organizojnë dhe paraqesin strategjinë e tyre të futbollit. Duke përdorur zhetonë me ngjyra të ndryshme dhe numra, nxënësit i vendosin lojtarët në fushë dhe vendosin për pozicionet dhe rolet e tyre në ekip.

Përmes këtij aktiviteti, futbolli paraqitet jo vetëm si lojë fizike, por edhe si hapësirë për të menduar, planifikuar, komunikuar dhe marrë vendime së bashku.

Nxënësit ndahen në ekipe dhe secili ekip merr detyrën të krijojë formacionin e vet dhe të planifikojë një aksion futbolli. Ata duhet të vendosin cili lojtar do ta nisë aksionin, kujt do t›ia pasojë topin, si do të lëvizin lojtarët e tjerë dhe si do të përpiqen të arrijnë te porta kundërshtare. Duke lëvizur zhetonët nëpër fushë, nxënësit i paraqesin vizualisht idetë, shqyrtojnë zgjidhjet e mundshme dhe së bashku e zhvillojnë strategjinë. Pas planifikimit, çdo ekip mund të prezantojë taktikën dhe të demonstrojë aksionin e menduar.

Vlera e veçantë e këtij aktiviteti qëndron te mundësia që çdo nxënës të marrë pjesë në mënyrën që u përgjigjet aftësive, interesave dhe mundësive të tij të komunikimit, në një mjedis të përshtatur. Pjesëmarrja nuk kushtëzohet nga aftësia për të vrapuar, gjuajtur ose kryer lëvizje të caktuara fizike; secili mund të kontribuojë duke zgjedhur dhe vendosur zhetonë, propozuar zgjidhje, treguar pozicione ose prezantuar ide. Sipas nevojës mund të përdoren udhëzime vizuale, simbole, udhëzime të shkurtra dhe mbështetje nga një bashkënxënës ose i rritur.

Në këtë mënyrë, aktiviteti krijon mundësi për pjesëmarrje të barabartë, dëgjim të ndërsjellë dhe respektim të ideve të ndryshme. Nxënësit mësojnë se loja e suksesshme ekipore nuk varet vetëm nga aftësitë individuale, por edhe nga bashkëpunimi, koordinimi dhe kontributi i çdo anëtari të ekipit.

Kjo lojë, mbi të gjitha, sjell përfitime për zhvillimin e pjesëmarrësve. Përmes saj nxiten të menduarit logjik dhe strategjik, orientimi hapësinor, planifikimi dhe zgjidhja e problemeve. Njëkohësisht, nxënësit zhvillojnë aftësitë komunikuese dhe sociale, mësojnë të negociojnë, të ndajnë idetë e tyre, të pranojnë propozime të ndryshme dhe të marrin vendime së bashku.

Nga zbatimi praktik i kësaj loje u arrit në përfundimin se çdo nxënës mund të jetë pjesë e ekipit të futbollit – dikush përmes lëvizjes në fushë, dikush përmes hartimit të strategjisë dhe dikush përmes mbështetjes e bashkëpunimit. Është e rëndësishme që secili të ketë mundësi të kontribuojë, të dëgjohet dhe të ndihet anëtar i rëndësishëm i ekipit.

Kutia mobile mund të vendoset, zhvendoset dhe paketohet shpejt. Mund të përdoret në dhomën e burimeve, në klasë ose në një hapësirë tjetër të përshtatshme, individualisht ose në grup.

3.3. Këndi i përshtatur për punë dhe pushim

Këndi i përshtatur është një vend i organizuar ku fëmija mund të punojë në kushte më të qeta, të komunikojë ose të bëjë një pushim të shkurtër. Aty mund të përdoret edhe kutia mobile, por qëllimi i këndit nuk kufizohet te një mjet i vetëm. Ai është pjesë e mjedisit të përbashkët, i qasshëm sipas nevojave të pjesëmarrësit, me mundësi për t'u rikthyer në aktivitet.

Këndi i përshtatur mund të kontribuojë në:

- zvogëlimin e mbingarkesës shqisore;
- pushimin e shkurtër fizik dhe emocional;
- shprehjen e ndjenjave dhe nevojave;
- përdorimin e strategjive të vetërregullimit;
- qasjen në mbështetje vizuale dhe komunikuese;
- kthimin e parashikueshëm dhe të sigurt në aktivitet;
- pavarësinë më të madhe gjatë kërkimit të ndihmës;
- parandalimin e tërheqjes së plotë ose largimit nga aktiviteti;
- pjesëmarrjen në mjedise sportive pa hapësirë të përhershme të përshtatur.

Këndi i përshtatur mund t›i shërbejë një pjesëmarrësi që:

- është i lodhur;
- ndihet i mbingarkuar;
- e ka të vështirë të përballojë zhurmën, dritën ose lëvizjen;
- ka nevojë për pushim të shkurtër;
- dëshiron të organizohet;
- ka nevojë për mbështetje vizuale;
- dëshiron të shprehë në një vend më të qetë çfarë i nevojitet;
- duhet të përgatitet gradualisht për t'u kthyer në lojë;
- ka nevojë për mbështetje individuale për të përvetësuar nocionet dhe rregullat e futbollit.

Për rregullimin e këndit të përshtatur, në varësi të kushteve dhe nevojave, mund të sigurohen:

- një shtresë e lehtë ose jastëk;
- një karrige e vogël e palosshme;
- kufje për zvogëlimin e zhurmës;
- kapelë me strehë për mbrojtje nga drita;
- kohëmatës vizual;
- kartelë me ushtrim të thjeshtë frymëmarrjeje;
- figurë me një sekuencë të shkurtër për qetësim;
- objekt për përqëndrim të qetë.

Këndi i përshtatur mund të mundësojë edhe punën me kutinë mobile dhe pushime të shkurtra. Hapësira organizohet në mënyrë të rehatshme, duke ruajtur mbikëqyrjen dhe mundësinë e zgjedhjes. Mund të përmbajë objekte të zgjedhura me kujdes, si:

- top kundër stresit;
- top i butë ose me teksturë;
- shirit elastik për duart;
- objekt i thjeshtë prekës;
- tub vizual ose objekt për ndjekje të qetë;
- kartela me sugjerime për shtrirje ose lëvizje;
- objekt i lehtë për shtrëngim ose shtypje ritmike.

Objektet duhet të jenë të sigurta, të qëndrueshme, të lehta për t›u pastruar dhe të përshtatshme për moshën. Jo çdo objekt shqisor i përshtatet çdo pjesëmarrësi. Zgjedhja duhet të bazohet në vëzhgim, nevojat e njohura dhe këshillën profesionale kur nevojitet.

Këndi duhet të jetë:

- afër aktivitetit, por jashtë zonës kryesore të lëvizjes;
- i mbrojtur nga goditjet e topit dhe pajisjeve të tjera;
- i dukshëm për të rriturit përgjegjës;
- i qasshëm për pjesëmarrësit me mënyra të ndryshme lëvizjeje;
- në një vend me zhurmë dhe mbingarkesë vizuale të zvogëluar;
- larg objekteve të rrezikshme, shkallëve dhe daljeve të pasiguruara;
- i shënuar mjaftueshëm qartë;
- i vendosur në mënyrë që respekton privatësinë, pa krijuar izolim.

Këndi nuk duhet të vendoset si një hapësirë ku fëmija ekspozohet publikisht dhe vëzhgohet nga i gjithë grupi.

3.3.1. Udhëzime për përdorimin e këndit të përshtatur

Këndi i përshtatur dhe materialet e tij u prezantohen paraprakisht pjesëmarrësve, që ata të dinë për çfarë mund t›i përdorin.

Grupit mund t›i thuhet:

„Ky është një vend për pushim të shkurtër, komunikim dhe përgatitje për t›u kthyer në lojë. Çdokush mund ta përdorë kur i nevojitet.“

Çdo objekt dhe kartelë duhet të shpjegohen shkurtimisht dhe të tregohet si përdoren në mënyrë të sigurt.

Pjesëmarrësit duhet të dinë:

- si të kërkojnë pushim;
- nëse duhet ta njoftojnë një të rritur;
- sa persona mund të jenë njëkohësisht në kënd;
- si përdoren materialet;
- si të tregojnë se janë gati të kthehen.

Të gjithë pjesëmarrësit mund t›i provojnë shkurtimisht hapat, pa pritur të shfaqet mbingarkesa. Kështu këndi bëhet i njohur dhe i parashikueshëm. Pas aktivitetit duhet të përcaktohet cilat objekte ishin të dobishme, çfarë mungonte dhe çfarë duhet hequr ose zëvendësuar. Pjesëmarrësi mund ta kërkojë vetë përdorimin e këndit ose i rrituri mund t›ia ofrojë pa e imponuar.

Një ofertë e përshtatshme është:

„Po vërej se zhurma po të pengon. Dëshiron të bësh një pushim në kënd apo të qëndrosh këtu me një detyrë më të qetë?“

Nuk është e përshtatshme të thuhet:

„Shko në kënd derisa të qetësohesh.“

Formulimi i parë ofron zgjedhje dhe mbështetje. I dyti mund të tingëllojë si ndëshkim dhe largim nga grupi.

Nuk ka kohëzgjatje të njëjtë për të gjithë. Për një pjesëmarrës mund të mjaftojnë dy ose tri minuta, ndërsa një tjetri mund t›i duhet më shumë kohë.

Kohëmatësi vizual mund të ofrojë parashikueshmëri, por nuk duhet të përdoret për ta ndërprerë me detyrim pushimin. Në vend të një urdhri të prerë:

„Koha mbaroi, duhet të kthehesh“,

mund të ofrohet:

„Koha e kohëmatësit mbaroi. A je gati të kthehesh, dëshiron edhe pak kohë apo të zgjedhim një rol më të lehtë?“

Kur pjesëmarrësi ka shpesh nevojë për pushime të gjata, ekipi duhet të rishqyrtojë vetë aktivitetin dhe mjedisin, jo vetëm ta zgjasë kohën në kënd. Kthimi mund të bëhet gradualisht:

- pjesëmarrësi tregon ose thotë se është gati;
- zgjedh si dëshiron të kthehet;
- merr një detyrë të shkurtër dhe të njohur;
- sipas nevojës përfshihet me një bashkëmoshatar të zgjedhur;
- fillon me intensitet të zvogëluar;
- monitorohen sërish mirëqenia dhe pjesëmarrja e tij.

Mënyrat e mundshme të kthimit janë:

- vëzhgimi nga anash;
- pasimi me një partner;
- ndihma për vendosjen e pajisjeve;
- zgjedhja e një roli me intensitet më të ulët;
- një përpjekje e shkurtër provuese;
- përfshirja graduale në lojën ekipore.

Qëllimi është që pjesëmarrësi të lidhet sërish me aktivitetin, jo të kompensojë diçka që „ka humbur“ gjatë pushimit. Mjetet që krijojnë presion të fortë, kufizim të lëvizjes ose stimulim tjetër të fortë shqisor nuk duhet të përdoren pa vlerësim të përshtatshëm individual dhe udhëzim profesional.

Siguria dhe higjiena janë të rëndësishme si gjatë përdorimit të kutisë mobile, ashtu edhe në këndin e përshtatur. Para dhe pas përdorimit kontrollohet:

- nëse të gjitha objektet janë në gjendje të mirë dhe nëse mungon ndonjë pjesë;
- nëse ka pjesë të vogla ose të mprehta;
- nëse materialet janë të përshtatshme për moshën;
- nëse objektet pastrohen lehtë;
- nëse kufjet dhe objektet për prekje dezinfektohen rregullisht;
- nëse ekziston rrezik alergjish;
- nëse pajisjet elektronike, nëse ka, janë të sigurta;
- nëse janë shmangur objektet e rënda ose të paqëndrueshme;
- nëse këndi nuk e pengon daljen ose rrugën e evakuimit;
- nëse është siguruar mbikëqyrja e duhur.

Para aktivitetit duhet të caktohet një person që do të:

- vendosë këndin;
- kontrollojë sigurinë;
- përgatisë kartelat dhe materialet;
- monitorojë përdorimin;
- sigurojë pastrimin dhe paketimin e duhur;
- shënojë çfarë ishte e dobishme;
- propozojë ndryshime për aktivitetin e ardhshëm.

Megjithatë, këndi nuk duhet të bëhet përgjegjësi vetëm e një personi të caktuar. I gjithë ekipi duhet ta kuptojë qëllimin dhe mënyrën e përdorimit të tij.

Materiale për rregullimin e këndit të përshtatur

Tabela 9. Materiale për rregullimin e këndit të përshtatur

Kategoria	Materialet bazë
Shenjimi	Shenjë për këndin dhe rregulla vizuale
Komunikimi	Kartela për ndihmë, pushim, ndjenja dhe kthim
Rehatia	Shtresë ose karrige e palosshme
Zvogëlimi i stimujve	Kufje dhe mbrojtje vizuale, kur nevojitet
Vetërregullimi	Disa objekte të sigurta prekëse
Parashikueshmëria	Renditje vizuale dhe kohëmatës
Kthimi	Kartela për zgjedhjen e rolit ose detyrës
Higjiena	Mjete dhe materiale pastrimi
Siguria	Informacione bazë kontakti dhe qasje në ndihmën e parë

Materialet zgjidhen sipas mjedisit konkret dhe nevojave të fëmijës. Disa mjete të përzgjedhura me kujdes dhe me qëllim të qartë mund të jenë më të dobishme sesa shumë objekte pa funksion të përcaktuar.

Çfarë duhet shmangur?

Këndi nuk duhet:

- të përdoret si ndëshkim;
- të quhet vend për fëmijët „e padëgjueshëm“;
- të shërbejë për veçim afatgjatë;
- të jetë i fshehur nga mbikëqyrja;
- të përdoret për mbajtje me detyrim;
- të bëhet zëvendësim për përshtatjen e aktivitetit;
- të përmbajë objekte të pasigurta ose të zgjedhura rastësisht;
- të përdoret pa shpjegim;
- të kufizohet vetëm për një fëmijë;
- të përdoret për të shmangur reagimin profesional ose mbrojtës kur ai nevojitet.

Monitorimi i efektit

Këndi e arrin qëllimin kur pjesëmarrësi:

- e dallon vetë ose me pak mbështetje se i nevojitet pushim;
- mund të zgjedhë një strategji që e ndihmon;
- ndihet i sigurt ta shprehë nevojën e vet;
- e zvogëlon mbingarkesën;
- kthehet më lehtë në aktivitet;
- zhvillon gradualisht strategjitë e veta të vetërregullimit;
- nuk etiketohet ose veçohet nga grupi;
- ruan ndjenjën e përkatësisë në ekip.

Nëse i njëjti pjesëmarrës tërhiqet vazhdimisht në kënd, duhet të kontrollohet se çfarë në aktivitetin kryesor krijon pengesë. Zgjidhja nuk është që fëmija të kalojë më shumë kohë jashtë lojës, por që mjedisi dhe detyra të përmirësohen.

Këndi i përshtatur nuk është pika përfundimtare e pjesëmarrjes. Ai është një kalim i sigurt që i mundëson pjesëmarrësit të pushojë, të rifitojë qëndrueshmërinë dhe të lidhet sërish me ekipin.

3.4. Pasaporta për mbështetje nga bashkëmoshatarët

(Peer Power Passport)

Mjet edukativ dhe motivues (shpesh në formë „pasaporte“ ose fletoreje të vogël), që përdoret për të monitoruar dhe nxitur të nxënit dhe bashkëpunimin ndërmjet bashkëmoshatarëve.

- Përshtatet/personalizohet lehtë me piktograme vizuale për nxënësit me nevoja specifike (autizëm, vështirësi intelektuale, çrregullimi i mungesës së vëmendjes dhe hiperaktivitetit – ADHD).
- Ndihmon në monitorimin e zhvillimit të nxënësve.
- Fëmijët mësojnë si të luajnë, si të komunikojnë dhe si ta mbështesin njëri-tjetrin.
- Këto momente shënohen dhe ndiqen. Në pasaportë ka edhe pjesë ku regjistrohen aftësitë e reja, suksesi në lojën ekipore, karrigia, prania në stërvitje dhe disa qëllime personale.
- Promovohen vlerat gjithëpërfshirëse. Theksohen aspekte si miqësia, respekti, empatia dhe puna në ekip. Nxitet pjesëmarrja dhe angazhimi i të gjithë lojtarëve, pavarësisht aftësive të tyre.
- Rritet motivimi përmes etapave/hapave të dukshëm (në pasaportë ndiqet përparimi dhe jepen mirënjohje për arritjet), sepse çdo nënshkrim ose vulë është dëshmi se nxënësi ka pasur sukses në diçka.
- Mund të shërbejë si mjet komunikimi me trajnerët, mësimdhënësit, grupet dhe nxënësit.
- Zakonisht përmban një faqe hyrëse me emrin, fotografinë dhe ekipin, qëllime për pjesëmarrjen dhe sjelljen, aftësi motorike dhe sociale, ngjitëse motivuese, pyetje reflektuese si „Si e ndihmova sot një shok?“, një pjesë për komentet e trajnerit/mësimdhënësit dhe një pjesë për reagimet nga bashkëmoshatarët.

Pasaporta për mbështetjen nga bashkëmoshatarët është mjet praktik përmes të cilit fëmijët mësojnë të jenë bashkëlojtarë që përfshijnë, dëgjojnë, inkurajojnë dhe bashkëpunojnë. Ajo i shndërron vlerat e gjithëpërfshirjes në veprime konkrete që mund të dallohen dhe zbatohen gjatë aktivitetit sportiv.

Pasaporta nuk krijon ndarje mes „ndihmuesve“ dhe „fëmijëve që kanë nevojë për ndihmë“. Çdo pjesëmarrës mund të ofrojë, të pranojë ose të kërkojë mbështetje në momente të ndryshme. Prandaj, baza e këtij mjeti është reciprociteti:

Pasaporta synon të nxisë:

- përfshirjen aktive të të gjithë pjesëmarrësve;
- komunikimin mes bashkëmoshatarëve;
- ndihmën e ndërsjellë dhe bashkëpunimin;
- respektimin e ritmit dhe mënyrës së ndryshme të pjesëmarrjes;
- njohjen e kontributit të çdo anëtari;
- oofrimin e përgjegjshëm dhe jo imponues të ndihmës;
- pavarësinë dhe vetëpërfaqësimin;
- udhëheqjen pozitive;
- parandalimin e përjashtimit dhe talljes;
- ndjenjën e përkatësisë në ekip.

Mjeti e zhvendos vëmendjen nga pyetja „Kush është lojtari më i mirë?“ te pyetja:

„Si kontribuova që të gjithë të ishim pjesë e lojës?“

Pasaporta u dedikohet të gjithë fëmijëve të grupit. Mund të përdoret:

- në klasë;
- në stërvitje;
- në klub sportiv;
- në punëtori gjithëpërfshirëse;
- në kamp ose program afatshkurtër;
- në grup të përzier me mosha dhe aftësi të ndryshme;
- gjatë një aktiviteti të vetëm ose një cikli disajavor.

Përmbajtja dhe mënyra e përdorimit duhet të përshtaten sipas moshës, mundësive të komunikimit dhe kohëzgjatjes së programit.

Pasaporta mund të jetë një librezë e vogël personale, kartelë e palosshme ose formë digjitale e përshtatur. Rekomandohet të përmbajë disa pjesë të qarta.

Profili i ekipit

Në këtë pjesë pjesëmarrësi mund të shkruajë ose zgjedhë:

- emrin ose simbolin;
- çfarë i pëlqen më shumë të bëjë në futboll;
- në çfarë ndihet i sigurt;
- çfarë dëshiron të mësojë;
- si parapëlqen të marrë mbështetje;
- si mund të tregojë se ka nevojë për ndihmë;
- çfarë e bën bashkëlojtar të mirë;
- cila është sfida e tij personale në ekip.

Pjesëmarrësi nuk është i detyruar të japë informacione personale të ndjeshme. Pasaporta duhet të përmbajë vetëm të dhënat e nevojshme për aktivitetin që fëmija dëshiron t›i ndajë.

Misionet e ekipit

„Misionet e ekipit“ janë veprime konkrete që pjesëmarrësi mund t’i zbatojë gjatë aktivitetit.

Misioni: Më fto në lojë

- ftova një bashkëlojtar të përfshihej;
- i shpjegova ku mund të qëndronte;
- i ofrova një rol të rëndësishëm;
- kontrollova nëse dëshironte të merrte pjesë.

Misioni: Pyet para se të ndihmosh

- pyeta nëse nevojitej ndihmë;
- prita përgjigjen;
- e pranova zgjedhjen;
- nuk e kreva detyrën në vend të bashkëlojtarit.

Misioni: Jep kohë

- nuk e ndërpreva bashkëlojtarin;
- lashë kohë për përgjigje;

- nuk e nxitova dikë që merr pjesë me ritëm tjetër;
- e prita ekipin para se të vazhdonim.

Misioni: Komuniko qartë
- përdora një mesazh të shkurtër dhe të kuptueshëm;
- tregova me veprim në vend që vetëm të shpjegoja;
- përdora shenjën ose kartelën e dakorduar;
- kontrollova nëse mesazhi ishte kuptuar.

Misioni: Ndaje topin
- ua pasova topin bashkëlojtarëve të ndryshëm;
- u kujdesa që të gjithë të kishin mundësi ta preknin topin;
- nuk e mora përsipër gjithë lojën;
- e njoha kontributin e të tjerëve.

Misioni: Inkurajo
- lavdërova përpjekjen, jo vetëm rezultatin;
- përdora fjalë me respekt;
- nuk u talla me gabimin;
- e ndihmova ekipin të provonte përsëri.

Misioni: Respekto zgjedhjen
- e pranova kur dikush kërkoi pushim;
- nuk imponova ndihmë;
- pranova një mënyrë tjetër realizimi;
- respektova hapësirën personale.

Misioni: Reago ndaj përjashtimit
- vura re kur dikush mbeti mënjanë;
- e përfshiva në marrëveshjen e ekipit;
- kërkova ndihmë nga një i rritur kur ishte e nevojshme;
- nuk mora pjesë në fyerje ose tallje.

Kontributi im sot

Pas aktivitetit, pjesëmarrësi mund të zgjedhë ose të shkruajë:

• sot ndihmova duke...;	• sot mësova nga të tjerët...;
• sot kërkova ndihmë kur...;	• sot u ndjeva pjesë e ekipit kur...;
• sot pranova ndihmë nga...;	• herën tjetër do të provoj të....
• sot përfshiva një bashkëlojtar duke...;	

Për fëmijët më të vegjël ose pjesëmarrësit që nuk përdorin tekst të shkruar, mund të përdoren simbole, figura, ngjitëse, vizatime ose zgjedhje mes dy mesazheve të ofruara.

Zëri i bashkëlojtarit

Një bashkëlojtar mund të japë reagim të shkurtër, pozitiv dhe konkret:

- „Më ndihmove kur...“
- „Më përfshive duke...“
- „Bashkëpunuam mirë kur...“
- „Prej teje mësova...“
- „Herën tjetër mundemi së bashku të...“

Reagimi duhet të lidhet me sjelljen e vërejtur, jo me vlerësimin e personalitetit.

Në vend të:

„Ti je ndihmësi më i mirë“,

më mirë është:

„Më ndihmove kur ma tregove detyrën dhe prite që të provoja vetë.“

Si prezantohet pasaporta?



Figura 16. Paraqitja vizuale e prezantimit të pasaportës për mbështetjen nga bashkëmoshatarët
Diagrami paraqet renditjen e hapave; udhëzimet e hollësishme jepen në tekstin poshtë tij.

Hapi 1 – Shpjego qëllimin

Grupit duhet t›i shpjegohet se pasaporta nuk është garë dhe nuk shërben për të zgjedhur pjesëmarrësin më të mirë. Ajo na ndihmon të dallojmë çfarë e bën ekipin të qasshëm dhe mbështetës për të gjithë.

Hapi 2 – Zgjidh një mision ekipor

Në fillim mjafton që i gjithë grupi të punojë në një mision, për shembull:
„Sot do të kujdesemi që çdo anëtar i ekipit të marrë një pasim.“

Hapi 3 – Trego sjelljen e pritur

Përmes një demonstrimi të shkurtër duhet të tregohet:

- si ftohet bashkëlojtari;
- si ofrohet ndihma;

- si pritet përgjigjja;
- si jepet inkurajimi;
- si respektohet refuzimi.

Hapi 4 – Zbato misionin në lojë

Gjatë aktivitetit, të rriturit i vëzhgojnë veprimet pa e ndërprerë vazhdimisht lojën. Sipas nevojës përdorin një rikujtues të shkurtër ose shenjë vizuale.

Hapi 5 – Bëj një reflektim të shkurtër

Pas aktivitetit ndahen disa minuta që pjesëmarrësit të vërejnë:

- çfarë bënë;
- si ndikoi kjo te të tjerët;
- çfarë mbështetjeje morën;
- çfarë do të bënin herën tjetër.

Hapi 6 – Bart aftësinë në një situatë tjetër

I njëjti mision mund të zbatohet në aktivitetin e ardhshëm, në orën mësimore, në klub ose gjatë një detyre të përditshme në grup. Kështu mbështetja nga bashkëmoshatarët bëhet shprehi, jo veprim i njëhershëm.

Misioni i përfunduar mund të shënohet me:

- vulë;
- ngjitëse;
- simbol;
- ngjyrë;
- shënim të shkurtër;
- nënshkrimin e bashkëlojtarit;
- shenjë personale të pjesëmarrësit.

Shenja nuk duhet të jepet vetëm nga i rrituri. Pjesëmarrësi mund të reflektojë vetë dhe bashkëlojtarët të konfirmojnë një shembull konkret bashkëpunimi.

Nuk nevojitet që të gjithë të mbledhin numër të njëjtë shenjash. Pasaporta nuk duhet të krijojë një sistem të ri krahasimi.

Tri këndvështrime të reflektimit

Që mbështetja nga bashkëmoshatarët të mos kuptohet vetëm si „dhënie ndihme“, pasaporta duhet t›i përfshijë të tria këndvështrimet.

Tabela 10. Tri këndvështrime të mbështetjes nga bashkëmoshatarët

Ofrua mbështetje	Kërkova ose pranova mbështetje	Kontribuova për ekipin
Tregova një detyrë	Tregova çfarë më nevojitet	Dhashë një ide
Ftova një bashkëlojtar	Pranova ndihmë	Kreva një rol në ekip
Prita përgjigjen	Kërkova pushim	Inkurajova një bashkëlojtar
Komunikova qartë	Bëra një zgjedhje	Ndihmova të arrinim qëllimin

Të tria aspektet janë njësoj të vlefshme. Të kërkosh ndihmë është aftësi, jo dobësi.

Personi që udhëheq aktivitetin duhet:

- të zgjedhë një mision të përshtatshëm për grupin;
- të ofrojë shembuj të qartë;
- të ndërrojë partnerët dhe rolet;
- të parandalojë që një fëmijë të mbetet vazhdimisht në rolin e ndihmësit;
- të vëzhgojë marrëdhëniet dhe çekuilibrin e mundshëm të pushtetit;
- të reagojë ndaj talljes, përjashtimit ose ndihmës së imponuar;
- të njohë kontributin e çdo pjesëmarrësi;
- ta lidhë reflektimin me sjellje konkrete;
- të sigurojë që pasaporta të mos bëhet një detyrim që krijon presion.

I rrituri nuk duhet të shënojë një vlerësim pozitiv vetëm për „sjellje të mirë“ në përgjithësi. Duhet të emërtojë çfarë ka bërë saktësisht pjesëmarrësi dhe si ka kontribuar kjo për ekipin.

Aktivitet praktik: „Tri pasime – tri mënyra mbështetjeje“

Qëllimi: Ekipi ta kryejë detyrën me pjesëmarrjen aktive të të gjithë anëtarëve.

Rrjedha:

1. Pjesëmarrësit ndahen në grupe të vogla.
2. Çdo ekip duhet të bëjë një seri pasimesh ku secili prek topin.
3. Para fillimit, çdo pjesëmarrës zgjedh një mision nga Pasaporta:
   - do të ftoj një bashkëlojtar;
   - do të pres;
   - do të pyes para se të ndihmoj;
   - do të inkurajoj;
   - do të kërkoj mbështetje kur më nevojitet.
4. Pas detyrës, secili ndan një shembull konkret.
5. Bashkëlojtari mund të shtojë çfarë e ndihmoi..

Suksesi nuk matet me shpejtësinë, por me faktin nëse morën pjesë të gjithë dhe nëse u zbatua misioni i zgjedhur.

Pasaporta nuk duhet:

- të përdoret për renditje;
- të krijojë garë se kush mbledh më shumë shenja;
- të përdoret si evidencë disiplinore;
- të përmbajë të dhëna personale të ndjeshme;
- ta shënojë një fëmijë si marrës të përhershëm të ndihmës;
- t'i kthejë bashkëmoshatarët në zëvendësues të mbështetjes profesionale;
- të shpërblejë keqardhjen ose sjelljen paternaliste;
- të plotësohet pa bisedë dhe reflektim;
- të jetë e detyrueshme nëse i shkakton parehati një pjesëmarrësi;
- të kufizohet te mbledhja e vulave pa zbatim në aktivitetin real.

Pasaporta është e dobishme kur vërehet se:

- më shumë fëmijë komunikojnë me njëri-tjetrin;
- pjesëmarrësit pyesin më shpesh para se të ndihmojnë;
- ndihma është më pak imponuese;
- partnerët dhe rolet ndërrohen natyrshëm;
- fëmijët e kërkojnë më lehtë mbështetjen;
- çdo pjesëmarrës ka mundësi të kontribuojë;
- zvogëlohen përjashtimi dhe tallja;
- pjesëmarrësit mund të shpjegojnë çfarë do të thotë të jesh bashkëlojtar i mirë;
- ekipi vlerëson procesin e përbashkët, jo vetëm rezultatin.

Pasaporta për mbështetjen nga bashkëmoshatarët nuk shpërblen „ndihmësin“. Ajo zhvillon një ekip ku ofrimi, kërkimi dhe pranimi i mbështetjes janë mënyra njësoj të vlefshme pjesëmarrjeje.

3.5. Programi për zbatimin praktik të futbollit të përshtatur

Mjet metodologjik i strukturuar për planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve gjithëpërfshirëse të futbollit

Programi ofron qasje sistematike për përfshirjen graduale të nxënësve në aktivitete të përshtatura futbolli, duke filluar nga zhvillimi i aftësive bazë motorike, përmes përvetësimit të aftësive të futbollit dhe bashkëpunimit ekipor, deri te pjesëmarrja në ndeshje gjithëpërfshirëse.

Në kuadër të „Touch the Goal“ u realizuan 20 stërvitje. Cikli u përshtat me fillimin e mëvonshëm të aktiviteteve, kalendarin shkollor dhe periudhën e verës. Për përdorim të mëtejshëm, përmbajtjet në vijim paraqiten në katër njësi metodike të ndërlidhura:

Njësia 1 – Përshtatja dhe aftësitë bazë motorike: njohja me hapësirën, mjetet dhe punën në grup.

Njësia 2 – Aftësitë themelore të futbollit: përvetësimi dhe zhvillimi i lëvizjeve bazë të futbollit.

Njësia 3 – Bashkëpunimi dhe loja ekipore: nxitja e komunikimit, bashkëpunimit dhe përgjegjësisë ekipore.

Njësia 4 – Zbatimi dhe ndeshjet gjithëpërfshirëse: zbatimi i aftësive të fituara përmes lojës dhe ndeshjeve.

Çdo njësi ka një qëllim të veçantë zhvillimor dhe përmbajtje që mbështeten në përvojat dhe aftësitë e fituara më parë. Ato ofrojnë orientim për planifikimin e aktiviteteve, me mundësi përsëritjeje dhe kombinimi sipas përparimit dhe nevojave të pjesëmarrësve. Njësive nuk u caktohet paraprakisht një numër fiks stërvitjesh.

Ideja themelore është që futbolli të përdoret si mjet për zhvillim fizik, social dhe personal, duke e vënë theksin jo vetëm te rezultati sportiv, por edhe te pjesëmarrja, bashkëpunimi, përparimi dhe kontributi i çdo nxënësi.

3.5.1. Qëllimet e programit

Qëllimi i përgjithshëm është krijimi i kushteve për pjesëmarrje aktive, të barabartë dhe të rëndësishëm të nxënësve me dhe pa aftësi të kufizuara në aktivitetet e përbashkëta të futbollit.

Qëllimet specifike:

- zhvillimi i aftësive bazë motorike, koordinimit dhe kontrollit të lëvizjeve;
- përvetësimi i aftësive bazë të futbollit, si udhëheqja, pasimi, ndalimi dhe gjuajtja e topit;
- nxitja e komunikimit, bashkëpunimit dhe mbështetjes së ndërsjellë;
- zhvillimi i ndjenjës së përkatësisë dhe përgjegjësisë ndaj ekipit;
- nxitja e vetëbesimit, nismës dhe pavarësisë;
- zhvillimi i qëndrimeve pozitive ndaj diversitetit, gjithëpërfshirjes dhe fer plej;
- krijimi i mundësive që çdo nxënës të marrë pjesë sipas aftësive, nevojave dhe interesave të veta.

3.5.2. Struktura dhe realizimi i programit me 20 stërvitje

NJËSIA 1: PËRSHTATJA DHE AFTËSITË BAZË MOTORIKE

Qëllimi: Njohja graduale e nxënësve me punën në grup, hapësirën, mjetet dhe aktivitetet bazë motorike.

Në njësinë fillestare, theksi vihet te krijimi i një atmosfere pozitive dhe mbështetëse, ku nxënësit ndihen të sigurt dhe të pranuar. Përmes aktiviteteve të thjeshta, ata njihen me hapësirën e lojës, topin dhe mjetet e tjera, si dhe me bashkëlojtarët e tyre.

Përmbajtjet dhe aktivitetet e propozuara:

- Lojëra për njohje përmes prezantimit të emrit dhe pasimit të topit.
- Ecje, vrapim dhe kërcim me dhe pa top.
- Udhëheqja e topit në hapësirë të lirë, pa presion garues.
- Hedhja, rrotullimi, pasimi dhe ndalimi i topit.
- Lojëra me kone, rrathë dhe mjete me ngjyra të ndryshme.
- Aktivitete në çifte që nxisin mbështetjen nga bashkëmoshatarët dhe bashkëpunimin ndërmjet nxënësve.

Udhëzime metodike:

Aktivitetet duhet të organizohen me udhëzime të shkurtra e të qarta, demonstrim vizual dhe kohë të mjaftueshme për njohjen me çdo detyrë. Duhet të mundësohen pushime më të shpeshta dhe përsëritje të aktiviteteve kur nevojitet. Është e rëndësishme të shmanget krahasimi i nxënësve sipas shpejtësisë ose suksesit në kryerjen e detyrave.

Përparimi i pritur: Nxënësit përshtaten gradualisht me punën në grup, njihen me mjetet bazë dhe inkurajohen të marrin pjesë në aktivitetet e përbashkëta.

NJËSIA 2: AFTËSITË THEMELORE TË FUTBOLLITИ

Qëllimi: Zhvillimi i koordinimit dhe përvetësimi i lëvizjeve dhe teknikave bazë të futbollit.

Në këtë njësi, nxënësit orientohen drejt njohjes dhe ushtrimit të aftësive themelore të futbollit. Aktivitetet mbështeten në përvojat motorike nga njësia paraprake dhe gradualisht përfshijnë kontroll më të madh të topit dhe lëvizje të drejtuar.

Përmbajtjet dhe aktivitetet e propozuara:

- Udhëheqja e topit me këmbën e djathtë dhe të majtë.
- Ndalimi i topit me këmbë.
- Pasimi i topit nga vendi dhe në lëvizje.
- Gjuajtja drejt cakut– portës ose një zone të shënuar paraprakisht.
- Detyra të thjeshta poligoni me kone dhe mjete të tjera.
- Mini-lojëra dy kundër dy dhe tre kundër tre.

Udhëzime metodike dhe përshtatje:

Aktivitetet realizohen në hapësirë më të vogël, me mundësi për më shumë prekje të topit dhe pa presion kohor. Distanca mes nxënësve dhe caqeve mund të përshtatet, ndërsa demonstrimi dhe përsëritja mund të përdoren si mbështetje shtesë. Është e rëndësishme që nxënësit të kenë mundësi të mjaftueshme për ta ushtruar secilën aftësi.

Përparimi i pritur: Nxënësit fitojnë siguri më të madhe në kontakt me topin, përmirësojnë koordinimin dhe gradualisht zbatojnë lëvizjet bazë të futbollit.

NJËSIA 3: BASHKËPUNIMI DHE LOJA EKIPORE

Qëllimi: Zhvillimi i bashkëpunimit, komunikimit dhe përgjegjësisë ekipore përmes aktiviteteve të përbashkëta të futbollit.

Njësia e tretë e zgjeron ushtrimin individual të aftësive të futbollit drejt aktiviteteve ku suksesi varet nga bashkëpunimi ndërmjet anëtarëve të ekipit. Nxënësit mësojnë ta ndajnë topin, t'i njohin pozicionet e bashkëlojtarëve dhe të marrin vendime të thjeshta të përbashkëta.

Përmbajtjet dhe aktivitetet e propozuara:

- Pasimi i topit në grupe të vogla.
- Udhëheqja e topit me ndryshim të drejtimit.
- Lojëra me pasim të detyrueshëm ndërmjet bashkëlojtarëve.
- Lojëra motorike ekipore me qëllim të përbashkët.
- Mini-ndeshje me rregulla të përshtatura.
- Lojëra ku të gjithë nxënësit duhet të kenë mundësi ta prekin topin.

Udhëzime metodike

Mësimdhënësi ose trajneri nxit bashkëpunimin përmes lavdërimit, inkurajimit dhe reagimit pozitiv. Duhet të krijohen situata ku nxënësit mbështeten te njëri-tjetri, respektojnë aftësitë e ndryshme dhe njohin rëndësinë e çdo anëtari të ekipit.

Përparimi i pritur: Nxënësit zhvillojnë gatishmëri më të madhe për lojë ekipore, komunikim të ndërsjellë, pasim dhe zgjidhje të përbashkët të situatave të thjeshta të lojës.

NJËSIA 4: ZBATIMI DHE NDESHJET GJITHËPËRFSHIRËSE

Qëllimi: Zbatimi i njohurive dhe aftësive të fituara përmes lojës së futbollit, forcimi i vetëbesimit dhe nxitja e pjesëmarrjes aktive.

Në njësinë përmbyllëse, nxënësit i zbatojnë aftësitë motorike dhe të futbollit në situata loje më të ndërlikuara. Theksi vihet te loja e përbashkët, mbështetja e ndërsjellë, respektimi i rregullave dhe krijimi i një përvoje pozitive garuese.

Përmbajtjet dhe aktivitetet e propozuara:

- Mini-ndeshje katër kundër katër dhe pesë kundër pesë.
- Lojëra pa theksuar rezultatin ose me pikëzim simbolik.
- Aktivitete të kombinuara që lidhin detyrat e futbollit dhe ato motorike.
- Sfida ekipore ku nxënësit arrijnë së bashku një qëllim të caktuar.
- Turne përmbyllës gjithëpërfshirës.
- Shoqërim i përbashkët dhe bisedë për përvojat nga programi..

Udhëzime metodike:

Aktivitetet garuese duhet të organizohen me rregulla të përshtatura dhe me përshtatje të duhur të hapësirës, kohëzgjatjes dhe mënyrës së pjesëmarrjes. Duhet të sigurohet mundësia që çdo nxënës të jetë anëtar aktiv i ekipit, pavarësisht nivelit të aftësive të futbollit. Vëmendja duhet të përqëndrohet te përpjekja, përparimi, loja e ndershme dhe bashkëpunimi ekipor, jo vetëm te rezultati i arritur.

Përparimi i pritur: Nxënësit fitojnë më shumë vetëbesim, i zbatojnë aftësitë e mësuara në lojë dhe zhvillojnë përvoja pozitive nga pjesëmarrja e përbashkët.

3.5.3. Aktiviteti përmbyllës – qetësimi pas stërvitjes

Në fund të çdo stërvitjeje parashikohet një aktivitet i shkurtër për uljen graduale të ushtrimit fizik dhe reflektimin mbi përjetimet e nxënësve.

Përmbajtja përfshin:

- Ecje të lehtë.
- Ushtrime të thjeshta frymëmarrjeje.
- Ushtrime shtrirjeje, të përshtatura sipas mundësive të nxënësve.
- Reflektim të shkurtër se si janë ndier nxënësit gjatë aktivitetit..

Biseda përmbyllëse mund të realizohet përmes shprehjes verbale, zgjedhjes së një figure ose simboli, tregimit me dorë apo një mënyre tjetër të përshtatshme komunikimi..

3.5.4. Përshtatja dhe mbështetja individuale

Parim themelor i programit është fleksibiliteti në organizimin dhe realizimin e aktiviteteve. Përshtatjet nuk duhet ta përjashtojnë aktivitetin e nxënësit, por të mundësojnë qasje më të lehtë dhe pjesëmarrje aktive.

Sipas nevojave individuale, mund të zbatohen:

Për nxënësit me autizëm:

- Shenjimi vizual i vijave dhe zonave të fushës.
- Udhëzime të shkurtra, të qarta dhe të parashikueshme.
- Paraqitja vizuale e renditjes së aktiviteteve.
- Pozicion ose rol i qëndrueshëm në lojë, kur kjo i përshtatet nxënësit.

Për nxënësit me sindromën Down:

- Përshtatja e ritmit të aktiviteteve.
- Pushime dhe ndërrime më të shpeshta.
- Mbështetje nga bashkëlojtari.
- Demonstrim dhe përsëritje të detyrave.

Për nxënësit me vështirësi motorike:

- Mundësimi i më shumë prekjeve të topit.
- Zvogëlimi i distancës për pasim ose gjuajtje.
- Pasim me ndihmë dhe mënyra të tjera të përshtatura pjesëmarrjeje.
- Përshtatja e hapësirës dhe mjeteve.

Të gjitha përshtatjet duhet të zgjidhen individualisht, sipas aftësive funksionale, nevojave dhe interesave të nxënësit.

6. Organizimi, siguria dhe rregullat e lojës gjithëpërfshirëse

Për realizimin e programit është e rëndësishme të sigurohen kushte të përshtatshme për pjesëmarrje të sigurt dhe të organizuar.

Udhëzimet bazë organizative janë:

Përbërja e ekipit: pesë lojtarë në fushë dhe një portier.

Maksimumi dhjetë nxënës në procesverbal.

Fushë me përmasa të rekomanduara 20–40 metra gjatësi dhe 12–20 metra gjerësi.

Përdorimi i portave të hendbollit ose portave të vogla të futbollit.

Përdorimi i topit më të lehtë, numër 3 ose 4.

Përdorimi i shenjuesve dhe koneve për orientim vizual.

Kohëzgjatja e ndeshjes: dy pjesë nga 15 minuta, me pushim prej pesë minutash; sipas nevojës, dy pjesë nga 10 minuta.

Në lojën e përshtatur parashikohen ndërrime pa kufi, rikthim në lojë pa sanksion nga gjyqtari dhe mbështetje verbale nga mësimdhënësi. Nuk lejohen ndërhyrjet rrëshqitëse, kontakti agresiv dhe gjuajtjet e larta pranë portierit. Rregulli i pozicionit jashtë loje nuk zbatohet.

Sanksionohen shtyrja, goditja, tërheqja dhe marrja e qëllimshme e topit nga një nxënës me aftësi të kufizuara. Masat e parashikuara janë goditje e lirë indirekte, paralajmërim verbal ose përjashtim edukativ prej dy minutash.

Siguria ka përparësi gjatë të gjitha aktiviteteve. Nxehja është e detyrueshme, nuk përdoren këpucë futbolli me kapëse metalike dhe gjatë ekzekutimit të një goditjeje të lirë sigurohet distancë prej tre metrash. Në rast mbingarkese shqisore, aktiviteti ndërpritet dhe ofrohet mbështetje e përshtatshme.

7. Roli i mësimdhënësit, trajnerit dhe ekipit mbështetës

Mësimdhënësi ose trajneri ka rol kyç në planifikimin, organizimin dhe udhëheqjen e aktiviteteve. Detyra e tij nuk është vetëm t'i shpjegojë rregullat dhe teknikat e futbollit, por edhe të krijojë mjedis ku të gjithë nxënësit kanë mundësi të marrin pjesë aktivisht.

Gjatë programit, ai:

i shpjegon dhe demonstron aktivitetet;

i përshtat detyrat sipas nevojave të nxënësve;

monitoron sigurinë dhe dinamikën e grupit;

nxit mbështetjen nga bashkëmoshatarët dhe bashkëpunimin e ndërsjellë;

jep reagime pozitive;

i inkurajon nxënësit të marrin nisma dhe vendime;

vlerëson përpjekjen dhe përparimin, jo vetëm rezultatin.

Asistentët arsimor dhe anëtarët e tjerë të ekipit mbështetës mund të kontribuojnë në përshtatjen e udhëzimeve, komunikimit dhe mënyrës së pjesëmarrjes, duke siguruar që mbështetja ta nxisë pavarësinë e nxënësit.

8. Monitorimi i përparimit dhe efektet e pritshme

Përparimi i nxënësve mund të monitorohet përmes vëzhgimit sistematik të pjesëmarrjes, angazhimit dhe zbatimit të aftësive të fituara gjatë programit.

Vëmendje e veçantë u kushtohet:

- pjesëmarrjes në aktivitete individuale dhe grupore;
- zhvillimit të aftësive bazë motorike dhe të futbollit;
- aftësisë për të ndjekur udhëzimet dhe rregullat;
- komunikimit dhe ndërveprimit me bashkëlojtarët;
- gatishmërisë për bashkëpunim dhe mbështetje nga bashkëmoshatarët;
- pavarësisë, nismës dhe vetëbesimit;
- respektimit të rregullave dhe parimeve të lojës së ndershme.

Efektet e pritshme të programit janë:

- përmirësimi i aftësive motorike dhe aftësive bazë të futbollit;
- rritja e ndërveprimit social mes nxënësve;
- vetëkontroll dhe përqëndrim më i mirë;
- zhvillimi i qëndrimeve pozitive ndaj gjithëpërfshirjes dhe diversitetit;
- forcimi i ndjenjës së përkatësisë në ekip dhe mbështetjes nga bashkëmoshatarët;
- rritja e vetëbesimit dhe motivimit për pjesëmarrje në aktivitete sportive.

9. Parimet kyçe për zbatim të suksesshëm

Gjatë zbatimit të programit duhen respektuar parimet e mëposhtme:

• Çdo nxënës merr pjesë – aktivitetet përshtaten në mënyrë që secili të ketë një rol të rëndësishëm.

• Individualizimi – mënyra e punës përshtatet sipas aftësive, nevojave dhe interesave të nxënësit.

• Mbështetja nga bashkëmoshatarët – nxiten bashkëpunimi dhe ndihma e ndërsjellë.

• Gradualiteti – aktivitetet mbështeten te njëri-tjetri dhe mundësojnë përparim të vazhdueshëm.

• Loja e ndershme dhe respekti – vlerësohen përpjekja, bashkëpunimi dhe respektimi i diversitetit.

• Fleksibiliteti – rregullat, hapësira, kohëzgjatja dhe mjetet mund të përshtaten.

• Pjesëmarrja para rezultatit – treguesi më i rëndësishëm i suksesit është pjesëmarrja aktive dhe të rëndësishme e çdo nxënësi.

Mesazhi përmbyllës

Futbolli i përshtatur nuk është vetëm një formë e ndryshuar e lojës tradicionale të futbollit, por mundësi për krijimin e një hapësire të përbashkët ku dallimet pranohen, aftësitë njihen dhe

çdo nxënës ka mundësi të jetë pjesë e ekipit. Suksesi i programit nuk matet vetëm me golat e shënuar apo rezultatet sportive, por me numrin e mundësive për pjesëmarrje, lidhjet e krijuara mes nxënësve dhe ndjenjën se secili ka vendin e vet në lojë.

3.6. Përzgjedhja e mjetit të përshtatshëm sipas mbështetjes së nevojshme

Zgjedhja e mjetit duhet të nisë nga situata konkrete e pjesëmarrjes, jo nga diagnoza e fëmijës ose dëshira për të përdorur patjetër një material të caktuar.

E njëjta sjellje mund të ketë shkaqe të ndryshme. Pjesëmarrësi që qëndron mënjanë ndoshta:

- nuk e ka kuptuar detyrën;
- nuk e di si të përfshihet;
- nuk ka marrë rol të rëndësishëm;
- nuk ndihet i pranuar nga grupi;
- është i mbingarkuar nga zhurma;
- ka nevojë për pushim;
- nuk di si të kërkojë ndihmë;
- nuk dëshiron të marrë pjesë në mënyrën e ofruar.

Prandaj, para zgjedhjes së mjetit duhet shtruar pyetja:

Çfarë i nevojitet pjesëmarrësit për t'u përfshirë më lehtë dhe më në mënyrë të pavarur në aktivitet?

Zgjedhja mund të bëhet në katër hapa:

1. **Vëzhgo çfarë po ndodh.**
2. **Identifiko pengesën e mundshme.**
3. **Zgjidh mbështetjen më të përshtatshme.**
4. **Kontrollo nëse mbështetja e ka përmirësuar pjesëmarrjen**.

Nëse nuk ka ndryshim pozitiv, nuk duhet të nxirret menjëherë përfundimi se pjesëmarrësi „nuk bashkëpunon“. Duhet të rishqyrtohen pengesa, mjeti i zgjedhur dhe mënyra e përdorimit të tij.

Doracak për zgjedhjen e mjetit

Tabela 11. Zgjedhja e mjetit sipas nevojës së vërejtur

Çfarë vërehet?	Nevoja e mundshme	Mbështetja e mundshme	Hapi i parë i mundshëm
Pjesëmarrësi nuk e nis detyrën	Nuk e kupton udhëzimin	Kartelat e komunikimit në futboll	Trego një kartelë dhe demonstro veprimin
Shpesh shikon çfarë bëjnë të tjerët para se të reagojë	I nevojitet model vizual	Kartelat e futbollit	Përdor një sekuencë prej dy ose tre hapash
Nuk mund të zgjedhë mes shumë mundësive	I nevojitet zgjedhje e kufizuar dhe e qartë	Kartelat e futbollit	Ofron dy mundësi të paraqitura vizualisht
Nuk tregon kur ka nevojë për ndihmë	I nevojitet mënyrë e qasshme për t'u shprehur	Kartelat e futbollit	Fut kartelat „ndihmë“ dhe „më trego“
Mbetet jashtë ndërveprimit ekipor	I nevojitet lidhje me bashkëmoshatarët	Pasaporta për mbështetjen nga bashkëmoshatarët	Dakordo një partner dhe një mision konkret ekipor
Nuk merr pasime nga të tjerët	Ekipi duhet të përfshijë më mirë	Pasaporta për mbështetjen nga bashkëmoshatarët	Fut misionin „Secili kontribuon“

Çfarë vërehet?	Nevoja e mundshme	Mbështetja e mundshme	Hapi i parë i mundshëm
Një bashkëmoshatar vendos vazhdimisht në vend të tij	Nevojitet reciprocitet dhe respektim i zgjedhjes	Pasaporta për mbështetjen nga bashkëmoshatarët	Futni „Pyet para se të ndihmosh“
Pjesëmarrësi shqetësohet nga zhurma	Nevojitet zvogëlimi i stimujve	Këndi i përshtatur	Ofroni një vend më të qetë dhe kufje, nëse i përshtaten
Shfaq lodhje ose humbje të vëmendjes	Nevojitet një pushim i shkurtër	Këndi i përshtatur	Mundësoni pushim dhe ujë
E ka të vështirë të kthehet pas pushimit	Nevojitet kalim gradual	Këndi i përshtatur dhe kartelat	Ofroni zgjedhjen e një detyre më të lehtë ose një partneri
Nuk kupton, tërhiqet dhe nuk di të kërkojë ndihmë	Nevojiten disa lloje mbështetjeje	Kombinim i mjeteve dhe këndit të përshtatur	Mesazh vizual, partner bashkëmoshatar dhe pushim i qasshëm
E ka të vështirë të lidhë pozicionet dhe lëvizjet në fushë	Nevojitet paraqitje vizuale dhe praktike	Kutia mobile gjithëpërfshirëse POP-UP	Trego një aksion me tabelën dhe zhetonët, pastaj ofro mundësi për ta provuar

Tabela jep një orientim fillestar, jo zgjidhje automatike. Reagimi i pjesëmarrësit tregon nëse zgjedhja ishte e përshtatshme.

Para se të futet një mjet, duhet të jetë e qartë çfarë pritet të mundësojë ai.

Tabela 12. Qëllimi i mbështetjes dhe mundësitë e zbatimit

Qëllimi i mbështetjes	Mundësitë e zbatimit
Nëse qëllimi është që pjesëmarrësi të kuptojë	Mund të përdoren: • kartelë me një veprim; • renditje vizuale; • sekuencë hapash; • demonstrim; • shenja në hapësirë.
Nëse qëllimi është që pjesëmarrësi të bëjë zgjedhje	Mund të ofrohen kartela për: • aktivitet; • rol; • partner; • pajisje; • ritëm; • pushim; • mënyrën e kthimit.
Nëse qëllimi është lidhje më e mirë me bashkëmoshatarët	Mund të përdoren: • një mision konkret nga Pasaporta; • punë në çift; • ndërrimi i partnerëve dhe roleve; • një detyrë që kërkon kontribut nga të gjithë; • reagim i shkurtër i ndërsjellë.
Nëse qëllimi është vetërregullimi	Mund të sigurohen: • kartela „pushim“; • qasje në këndin e përshtatur; • kohëmatës vizual; • zgjedhje e strategjisë së qetësimit; • kthim gradual.

Nëse qëllimi është siguria

Mjetet mund ta mbështesin sigurinë, por nuk e zëvendësojnë reagimin e nevojshëm profesional ose urgjent. Kartela „nuk ndihem i sigurt“ hap komunikimin, por i rrituri duhet menjëherë ta kontrollojë situatën dhe të veprojë sipas procedurave të mbrojtjes.

Për të njëjtën nevojë mund të ketë zgjidhje të ndryshme.

Për shembull, nëse pjesëmarrësi nuk përfshihet në lojën në grup, mund të ndihmojë:

- kartela që i shpjegon rolin;
- partneri bashkëmoshatar;
- grupi më i vogël;
- topi më i madh ose më i butë;
- distanca më e shkurtër;
- kohë shtesë;
- një përpjekje provuese;
- mundësia për të vëzhguar fillimisht;
- pushim i shkurtër;
- zgjedhja e një roli tjetër.

Mjeti nuk duhet të zgjidhet i shkëputur nga përshtatjet e tjera të aktivitetit.

I njëjti mjet mund të ketë funksione të ndryshme.

Për shembull, kartela „partneri“ mund:

- ta ndihmojë pjesëmarrësin të zgjedhë me kë do të punojë;
- t'ia kujtojë bashkëmoshatarit se detyra kryhet së bashku;
- të tregojë një mënyrë kthimi pas pushimit;
- të jetë pjesë e renditjes vizuale;
- të nxisë komunikimin e drejtpërdrejtë ndërmjet bashkëlojtarëve.

Prandaj, është e rëndësishme të shpjegohet paraprakisht kuptimi i kartelës në aktivitetin konkret.

Kur kombinohen mjetet?

Kombinimi është i dobishëm kur një pengesë ndikon në disa aspekte të pjesëmarrjes.

Shembulli 1: Aktivitet i ri dhe i panjohur

Pjesëmarrësi nuk e kupton detyrën dhe ndihet i pasigurt.

Kombinim i mundshëm:

- kartela me renditjen;
- demonstrim nga një bashkëmoshatar i zgjedhur;
- mundësi për pushim të shkurtër;
- kthim me të njëjtin partner.

Shembulli 2: Përjashtim nga loja ekipore

Pjesëmarrësi e kupton detyrën, por rrallë e merr topin.

Kombinim i mundshëm:

- mision ekipor nga Pasaporta;
- rregull vizual „të gjithë marrin pjesë“;
- rol i caktuar i rëndësishëm;
- reflektim pas aktivitetit.

Shembulli 3: Mbingarkesë shqisore

Pjesëmarrësi i mbulon veshët, ndalon së ndjekuri udhëzimet dhe tërhiqet.

Kombinim i mundshëm:

- kartela „pushim“;
- këndi i përshtatur;
- zgjedhja e një mjeti që e ndihmon;

- kartela për mënyrën e kthimit;
- partner bashkëmoshatar gjatë rikthimit.

Sa mjete janë të mjaftueshme?

Më shumë mjete nuk nënkuptojnë automatikisht mbështetje më të mirë. Numri tepër i madh i kartelave, rregullave, objekteve dhe rikujtuesve mund të krijojë hutim shtesë.

Duhet:

- të fillohet me zgjidhjen më të thjeshtë;
- të ofrohet numër i kufizuar zgjedhjesh;
- të futet një veprim i ri në një kohë;
- të vëzhgohet efekti;
- të shtohet mbështetje e re vetëm kur nevojitet;
- të hiqet ajo që nuk ka vlerë funksionale.

Kjo qasje mund të quhet mbështetje minimale efektive: e mjaftueshme për pjesëmarrje, por jo më e madhe se sa nevojitet.

Si të kontrollojmë nëse mjeti ndihmon?

Pas futjes së tij duhet të ndiqet nëse pjesëmarrësi:

- e kupton më shpejt detyrën;
- bën më shumë zgjedhje të pavarura;
- komunikon më lehtë;
- lidhet më shpesh me bashkëmoshatarët;
- varet më pak nga ndihma e drejtpërdrejtë e të rriturit;
- mund të kërkojë pushim para mbingarkesës;
- kthehet më lehtë në aktivitet;
- shfaq siguri dhe kënaqësi më të madhe;
- ka rol të rëndësishëm në ekip.

Më i rëndësishëm është edhe reagimi i vetë pjesëmarrësit:

- „A të ndihmoi kjo?“
- „Çfarë do të doje të ishte ndryshe?“
- „Cila kartelë të ishte më e dobishme?“
- „Cila mënyrë mbështetjeje të përshtatej?“
- „Çfarë nuk të nevojitej?“

Përgjigjja mund të jepet me fjalë, gjest, simbol, zgjedhje ose veprim të vëzhguar.

Kur duhet ndryshuar mjeti?

Mjeti ose mënyra e përdorimit të tij duhet të rishqyrtohet nëse:

- pjesëmarrësi nuk e kupton;
- e shmang ose refuzon;
- krijon mbingarkesë shtesë;
- nuk është fizikisht ose në aspektin e komunikimit i qasshëm;
- e veçon fëmijën;
- вbashkëmoshatarët e përdorin për tallje;
- i rrituri e kontrollon në vend të pjesëmarrësit;
- e zvogëlon pavarësinë;
- nuk kontribuon në pjesëmarrje më aktive;
- përdoret mekanikisht, pa qëllim të qartë.

Ndryshimi mund të nënkuptojë thjeshtim, format tjetër, simbol të ri, më pak materiale, vend tjetër ose zgjedhjen e një lloji krejt tjetër mbështetjeje.

Vendim i shpejtë gjatë aktivitetit

Kur nuk ka kohë për analizë më të gjatë, drejtuesi i aktivitetit mund t›i shtrojë tri pyetjet e mëposhtme:

1. **A e kupton pjesëmarrësi çfarë duhet të bëjë?**
   Nëse jo – përdor mbështetje vizuale ose komunikuese.
2. **A ka rol të rëndësishëm dhe lidhje me bashkëmoshatarët?**
   Nëse jo – fut partneritet me bashkëmoshatarët ose mision ekipor.
3. **A është i qetësuar dhe i gatshëm për pjesëmarrje?**
   Nëse jo – zvogëlo stimujt, ofro pushim ose qasje në kënd.

Më pas kontrollohet nëse ndryshimi i bërë solli pjesëmarrje më të mirë.

Formular i shkurtër për përzgjedhje dhe monitorim

Tabela 13. Formular për përzgjedhjen dhe monitorimin e mbështetjes

Pyetja	Shënimi
Çfarë vërejtëm?	
Cila është pengesa e mundshme?	
Çfarë mbështetjeje nevojitet?	
Cilin mjet do të përdorim?	
Si do ta përshtatim?	
Çfarë presim të ndryshojë?	
Çfarë ndryshoi pas zbatimit?	
Çfarë do të ruajmë ose përmirësojmë?	
Çfarë tha ose tregoi pjesëmarrësi?	

Mesazhi kyç: Nuk e zgjedhim mjetin sipas etiketës ose diagnozës, por sipas pengesës konkrete dhe mbështetjes së nevojshme. Mjeti i duhur është ai që, në atë çast, i mundëson pjesëmarrësit të kuptojë, të komunikojë, të lidhet me të tjerët, të vetërregullohet dhe të marrë pjesë aktivisht.

Mjetet e „Touch the Goal“ u krijuan për t›iu përgjigjur tri nevojave thelbësore në praktikën sportive gjithëpërfshirëse:

- nevojës që pjesëmarrësi **të kuptojë dhe të kuptohet;**
- nevojës të lidhet dhe **të bashkëpunojë me bashkëmoshatarët;**
- nevojës t**ë rregullohet dhe përsëri të kyçet**

Kartelat e komunikimit në futboll, Pasaporta për mbështetjen nga bashkëmoshatarët, Loja për këndin gjithëpërfshirës dhe Programi i futbollit gjithëpërfshirës nuk janë zgjidhje të veçuara, por një sistem fleksibil që mund të përshtatet për pjesëmarrës, mjedise dhe aktivitete të ndryshme.

Përdorimi i tyre është i suksesshëm kur çon në:

• pavarësi më të madhe;	• siguri më të madhe;
• komunikim më të qartë;	• më pak veçim;
• më shumë zgjedhje;	• pjesëmarrje aktive;
• lidhje më të mirë me bashkëmoshatarët;	• ndjenjë më të fortë përkatësie.

Pesë rregulla për zbatim cilësor

1. Fillo nga nevoja, jo nga mjeti

Fillimisht identifiko çfarë e lehtëson ose vështirëson pjesëmarrjen. Pastaj zgjidh mjetin ose përshtatjen e duhur.

2. Përfshije pjesëmarrësin në zgjedhje

Pyete çfarë e ndihmon, çfarë dëshiron të përdorë dhe çfarë do të ndryshonte. Nëse nuk komunikon me të folur, mundësoji të përgjigjet me gjest, simbol, zgjedhje ose mënyrë tjetër komunikimi.

3. Përdore mjetin në mënyrë të natyrshme

Mjeti duhet të jetë pjesë e aktivitetit dhe jo një shenjë publike që veçon një fëmijë. Kur është e mundur, bëje të qasshëm për gjithë grupin.

4. Ndiq efektin

Nuk mjafton vetëm prania e mjetit. Kontrollo nëse ai vërtet përmirëson pjesëmarrjen, komunikimin, pavarësinë dhe mirëqenien**.**

5. Përshtate, thjeshtoje ose ndryshoje

Nëse mjeti nuk ndihmon, ndrysho formatin, numrin e elementeve, mënyrën e përdorimit ose zgjidh një zgjidhje tjetër. Mjeti i shërben pjesëmarrësit dhe jo pjesëmarrësi mjetit.

Përdorimi i mjeteve gjatë aktiviteteve tregoi mundësinë që ato të përdoren në tri nivele:

1. Mbështetje universale – për gjithë grupin

Futën materiale dhe rregulla të dobishme për të gjithë pjesëmarrësit:

- orar vizual;
- kartela për udhëzimet bazë;
- shenja të dakorduara;
- rregulla ekipore për mbështetjen;
- vend të qasshëm për pushim të shkurtër.

2. Mbështetje e synuar – kur disa pjesëmarrës kanë nevojë për ndihmë shtesëш

Zgjidhen mjete ose përshtatje konkrete, si:

- numër më i vogël i kartelave për komunikim;
- bashkëmoshatar partner i njohur;
- kohëmatës vizual;
- sinjal i dakorduar paraprakisht për ndihmë;
- strategji konkrete për kthimin në aktivitet.

Kapitulli 4

ZBATIMI PRAKTIK I AKTIVITETEVE GJITHËPËRFSHIRËSE TË FUTBOLLIT

Hyrje

Çdo aktivitet në doracak duhet të shihet si bazë për planifikim dhe jo si procedurë e pandryshueshme. Personi që drejton aktivitetin zgjedh, përshtat dhe kombinon elemente sipas grupit konkret.

4.1. Realizimi i aktiviteteve praktike

Përpara përdorimit duhen dhënë përgjigje për tri pyetje themelore:

Çfarë dëshirojmë që pjesëmarrësit të mësojnë ose të përjetojnë?

Çfarë mund t'ua lehtësojë ose vështirësojë pjesëmarrjen?

Si do të sigurojmë që secili të ketë rol të rëndësishëm?

Për ta lehtësuar zbatimin, çdo aktivitet praktik paraqitet sipas së njëjtës strukturë.

Kjo strukturë mundëson që i njëjti aktivitet të zhvillohet në mjedise të ndryshme pa e humbur qëllimin e tij gjithëpërfshirës.

Çdo aktivitet duhet të ketë të paktën dy qëllime të ndërlidhura: një qëllim kryesor sportiv dhe një qëllim gjithëpërfshirës. Të dyja arrihen njëkohësisht.

Për shembull:

Aktiviteti duhet të zgjidhet sipas:

mundësive zhvillimore; përvojës së mëparshme; interesave; mënyrës së komunikimit; nivelit të mbështetjes së nevojshme; gatishmërisë fizike dhe emocionale.

E njëjta lojë mund të përdoret me grupmosha të ndryshme nëse përshtaten rregullat, gjuha, ritmi dhe ndërlikueshmëria.

Aktiviteti nuk duhet të duket fëmijëror vetëm sepse është thjeshtuar. Materialet, komunikimi dhe tema duhet të respektojnë dinjitetin dhe moshën e pjesëmarrësve.

Kohëzgjatja e propozuar nuk duhet ndjekur në mënyrë të ngurtë. Aktiviteti mund të shkurtohet ose të zgjatet sipas:

interesit dhe angazhimit; lodhjes; nevojës për përsëritje; kohës së nevojshme për të kuptuar; numrit të pjesëmarrësve; kushteve të motit dhe hapësirës; nevojës për pushim ose ndryshim.

Është më mirë që aktiviteti të përfundojë ndërsa pjesëmarrësit janë ende të motivuar, sesa të vazhdojë vetëm sepse kështu ishte planifikuar.

Nëse pajisjet e propozuara nuk janë në dispozicion, duhet zgjedhur një zëvendësim i sigurt me të njëjtin funksion.

Për shembull:

Zëvendësimi duhet të jetë i qëndrueshëm, i dukshëm, higjienik dhe i sigurt.

Për të shmangur ndarjen në aktivitet „kryesor“ dhe „të veçantë“, rekomandohet të përgatiten paraprakisht të paktën tri mënyra realizimi.

Varianti bazë

Përfaqëson detyrën fillestare që u ofrohet shumicës së pjesëmarrësve.

Me më shumë mbështetje

Mund të përfshijë:

distancë më të shkurtër; top më të madh ose më të butë; më pak hapa; renditje vizuale; ritëm më të ngadaltë; mbështetje nga partneri; kohë shtesë; pozicion fillestar të qëndrueshëm.

Me sfidë shtesë

Mund të përfshijë:

distancë më të madhe; ndryshim drejtimi; lëvizje përpara pasimit; rregull shtesë; zgjedhje ndërmjet disa zgjidhjeve; drejtim të një grupi të vogël; kombinim të dy aftësive.

Pjesëmarrësit mund të kalojnë nga një variant në tjetrin pa u etiketuar si „të lehtë“ apo „të vështirë“. Mund të përdoren emërtime, ngjyra ose simbole neutrale. Kur është e mundur, pjesëmarrësi duhet të mund të zgjedhë:

pajisjen; distancën; partnerin; rolin; ritmin; mënyrën e realizimit; llojin e mbështetjes; kohën e pushimit; mënyrën e rikthimit në aktivitet.

Zgjedhja rrit ndjenjën e kontrollit dhe motivimin, por nuk duhet të përfshijë tepër mundësi. Për disa pjesëmarrës, dy alternativa të qarta janë më efikase sesa një numër i madh opsionesh. Veçanërisht e rëndësishme është mënyra e dhënies së udhëzimeve. Udhëzimi duhet të jetë:

i shkurtër; konkret; i formuluar pozitivisht; i ndarë në hapa; i mbështetur me demonstrim; i paraqitur vizualisht kur nevojitet; i verifikuar përmes një prove.

Për shembull, në vend të:

„Të gjithë duhet të vendoseni siç duhet dhe ta drejtoni topin nëpër hapësirë pa u përplasur“,

mund të thuhet:

„Zgjidh një top. Qëndro te shenja. Drejtoje topin deri te koni blu. Ndalo.“

Pasi të përvetësohet hapi i parë, mund të shtohet hapi tjetër.

Para fillimit të çdo aktiviteti të ri duhet mundësuar një provë e shkurtër.

Gjatë provës:

nuk nxitohet; gabimet nuk vihen në dukje publikisht; rregullat mund të demonstrohen sërish; kontrollohet përshtatshmëria e pajisjeve; pjesëmarrësit mund të bëjnë pyetje ose të kërkojnë ndryshim; bëhen përshtatjet e para.

Prova është vlerësim i aktivitetit dhe jo testim i pjesëmarrësit. Përshtatja nevojitet kur vërehet se pjesëmarrësi:

nuk e kupton detyrën; pret gjatë; nuk ka mundësi ta prekë topin; nuk mund ta përdorë pajisjen e propozuar; varet vazhdimisht nga një i rritur; mbetet jashtë komunikimit; mbingarkohet nga zhurma ose lëvizja; shfaq dhimbje, lodhje, frikë ose shqetësim të konsiderueshëm; nuk ka rol të rëndësishëm; e përfundon detyrën pa asnjë sfidë.

Përshtatja mund të nënkuptojë si rritjen, ashtu edhe zvogëlimin e sfidës.

Aktiviteti duhet të ndërpritet menjëherë nëse:

ekziston rrezik i drejtpërdrejtë për lëndim; hapësira ose pajisjet janë bërë të pasigurta; një pjesëmarrës shfaq dhimbje të forta ose vështirësi shëndetësore; ka ndodhur dhunë, shqetësim serioz ose kërcënim; mbikëqyrja nuk është më e mjaftueshme; moti ose kushtet e tjera të jashtme paraqesin rrezik.

Ndërprerja nuk është dështim. Është vendim i përgjegjshëm për mbrojtjen e pjesëmarrësve.

Gjatë aktivitetit duhet të vërehet:

çfarë e nxit pjesëmarrjen; ku shfaqet pengesa; çfarë zgjedhjeje bën pjesëmarrësi; si komunikon; si lidhet me bashkëmoshatarët; çfarë mbështetjeje pranon; kur është më i pavarur; çfarë i sjell kënaqësi; nëse përshtatja e zgjedhur ndihmon.

Në vend të:

„Nuk është i interesuar“,

mund të shënohet:

„Nuk u përfshi kur udhëzimi u dha vetëm me gojë. Pas demonstrimit dhe zgjedhjes së partnerit, e filloi detyrën.“

Ky shënim mundëson planifikim më të saktë herën tjetër.

Pas aktivitetit duhet siguruar një mënyrë e shkurtër dhe e qasshme që pjesëmarrësit të ndajnë përvojën e tyre.

Mund të përdoren:

pyetje; fotografi ose simbole; kartela emocionesh; zgjedhje mes dy alternativave; shenja me gishtin e madh; vizatim; fjali e shkurtër; bisedë individuale.

Pyetjet mund të jenë:

Çfarë të pëlqeu?

Çfarë të ndihmoi?

Çfarë ishte e vështirë?

A pate mundësi të zgjedhësh?

A u ndjeve pjesë e ekipit?

Çfarë do të ndryshoje herën tjetër?

Kontroll praktik përpara fillimit

Para çdo aktiviteti duhet kontrolluar:

A është i qartë qëllimi?

A ka secili mundësi për pjesëmarrje të rëndësishme?

A janë përgatitur mënyra të ndryshme realizimi?

A mund të demonstrohet dhe të mbështetet vizualisht udhëzimi?

A janë pajisjet dhe hapësira të sigurta dhe të qasshme?

A kanë pjesëmarrësit mundësi të bëjnë zgjedhje?

A ekziston mundësia për pushim?

A janë dakorduar rolet e të rriturve?

A e dimë çfarë do të vëzhgojmë?

A është parashikuar marrja e mendimit të pjesëmarrësve?

Mesazhi kryesor: Aktiviteti praktik është cilësor kur ka një qëllim të qartë, disa rrugë për pjesëmarrje dhe mundësi të ndryshojë sipas asaj që tregojnë pjesëmarrësit. Nuk vlerësohet sa saktë është ndjekur plani, por sa mirë plani u shërben fëmijëve.

4.2. Modeli për planifikim dhe përshtatje

Për aktivitetet praktike të doracakut përdoret një model i përbashkët që ndihmon ekipin të planifikojë dhe të përshtatë aktivitetin në mënyrë sistematike.

Modeli përfshin gjashtë elemente të ndërlidhura:

Në qendër të modelit është pjesëmarrësi me:

- pikat e tij të forta;
- interesat;
- zgjedhjet;
- mënyrat e komunikimit;
- nevojat për mbështetje;
- të drejtën për pjesëmarrje të sigurt dhe të rëndësishme.

Modeli nuk kërkon që të ndryshohen gjithmonë të gjitha elementet. Ndonjëherë mjafton një ndryshim i vogël për të hapur mundësi krejtësisht të re pjesëmarrjeje.

Qëllimi

Hapi i parë është të përcaktohet qartë çfarë duam të arrijmë.

Qëllimi mund të jetë:

- sportiv – pasim, drejtim i topit, gjuajtje;
- motorik – ekuilibër, koordinim, orientim;
- komunikues – kërkim ndihme, bërje zgjedhjeje
- shoqëror – bashkëpunim, pritje e radhës, ndarje e roleve;
- emocional – vetëbesim, vetërregullim, ndjenjë sigurie;
- gjithëpërfshirës – pjesëmarrje aktive dhe përkatësi.

Qëllimi duhet të jetë mjaftueshëm i qartë për të dalluar përparimin, por edhe mjaftueshëm fleksibil për mënyra të ndryshme arritjeje.

Për shembull, nëse qëllimi është që pjesëmarrësi të kontribuojë në një aksion ekipor, nuk është e nevojshme që secili të përdorë të njëjtën teknikë. Njëri mund të pasojë, tjetri të zgjedhë drejtimin, i treti të sinjalizojë fillimin dhe i katërti të gjuajë.

Pyetje për planifikim

Cila është thelbi i aktivitetit?

Çfarë duam që pjesëmarrësit të mësojnë ose të përjetojnë?

Cili rezultat është i rëndësishëm për pjesëmarrjen?

A mund të arrihet qëllimi në disa mënyra?

Si e kuptojnë vetë pjesëmarrësit qëllimin?

Hapësira

Hapësira ndikon drejtpërdrejt në lëvizje, orientim, komunikim dhe ndjenjën e sigurisë.

Mund të përshtaten:

• madhësia e fushës; • largësia ndërmjet pjesëmarrësve; • gjerësia e shtegut; • madhësia e cakut; • numri dhe pozicioni i zonave; • dukshmëria e kufijve;	• madhësia e fushës; • largësia ndërmjet pjesëmarrësve; • gjerësia e shtegut; • madhësia e cakut; • numri dhe pozicioni i zonave; • dukshmëria e kufijve;

Hapësira mund të zvogëlohet kur:

pjesëmarrësi e ka të vështirë orientimin;

detyra kërkon tepër lëvizje;

largësia e vështirëson pasimin;

sipërfaqja e madhe krijon pasiguri;

grupi është i vogël.

Hapësira mund të zgjerohet kur:

ka rrezik përplasjesh;

pjesëmarrësit kanë nevojë për më shumë kohë reagimi;

afërsia shkakton shqetësim shqisor;

detyra kërkon lëvizje të lirë;

pjesëmarrësi përdor mjet ndihmës për lëvizje.

Pyetje për planifikim

A mund të hyjnë dhe të lëvizin të gjithë në mënyrë të sigurt?

A janë të dukshëm qartë kufijtë?

A është e përshtatshme largësia?

A ekspozohet dikush ndaj zhurmës ose afërsisë së tepruar?

A ka vend të qasshëm për pushim?

Detyra

Detyra përcakton çfarë duhet të bëjnë pjesëmarrësit. Ajo mund të përshtatet pa e humbur qëllimin kryesor.

Mund të ndryshohen:

• numri i hapave; • renditja; • shpejtësia; • kohëzgjatja; • numri i përsëritjeve; • mënyra e fillimit;	• mënyra e përfundimit; • niveli i ndërlikueshmërisë; • lloji i lëvizjes; • realizimi individual ose në grup; • roli i pjesëmarrësit.

Shembull

Detyra bazë:

Drejtoje topin mes pesë koneve dhe gjuaj drejt portës.

Përshtatje të mundshme:

- topi drejtohet ndërmjet tri koneve;
- konet vendosen më larg njëri-tjetrit;
- pjesëmarrësi mund të ecë në vend që të vrapojë;
- topi mund të shtyhet ose të pasohet me partnerin;
- pjesëmarrësi fillon nga pozicion më i afërt;
- detyra paraqitet përmes renditjes vizuale;
- pjesëmarrësi mund të zgjedhë drejtimin;
- detyra përfundon me pasim në vend të gjuajtjes..

Qëllimi mbetet orientimi dhe kontrolli i topit, por ndryshon rruga për ta arritur.

Pyetje për planifikim

A është e kuptueshme detyra?

A ka tepër hapa?

A mundëson sukses dhe sfidë të duhur?

A mund të ketë secili rol të rëndësishëm?

A mund të realizohet në një mënyrë tjetër?

A ka pjesëmarrësi mundësi të zgjedhë?

Rregullat

Rregullat e organizojnë lojën, por ndonjëherë krijojnë pa dashje pengesa. Prandaj duhen rishikuar në përputhje me qëllimin e aktivitetit.

Mund të përshtaten:

- numri i prekjeve të lejuara;
- koha e reagimit;
- mënyra e fitimit të pikëve;
- numri i pasimeve;
- rregulli i lëvizjes;
- mënyra e ndërrimit të roleve;
- kontakti ndërmjet lojtarëve;
- kohëzgjatja e raundit;
- numri i përpjekjeve;
- mënyra e fillimit dhe ndalimit.

Shembull

Në vend të rregullit:
„Fiton ekipi që shënon më shumë gola“,
mund të zbatohet:
„Ekipi merr një pikë për golin e shënuar dhe një pikë shtesë kur të gjithë anëtarët kanë kontribuar në aksion.“
Rregulli i përshtatur nuk duhet ta ekspozojë fëmijën ose të krijojë përshtypjen se i gjithë ekipi „duhet të presë për shkak të tij“. Ai duhet të vlejë për të gjithë dhe ta përmirësojë lojën ekipore.

Pyetje për planifikim

A është i kuptueshëm rregulli?

A e përjashton automatikisht dikë?

A shkakton pritje të gjata?

A vlerëson vetëm më të shpejtin apo më të aftin?

A mund të nxisë bashkëpunimin?

A është i sigurt dhe i drejtë?

Pajisjet

Pajisjet mund ta lehtësojnë ose vështirësojnë ndjeshëm pjesëmarrjen.

Tabela 14. Mundësi për përshtatjen e pajisjeve

Mund të ndryshohen	Mund të ndryshohen
madhësia e topit;	informacioni kthyes zanor;
pesha;	lartësia ose gjerësia e cakut;
butësia;	madhësia e mjeteve sportive;
tekstura;	mënyra e mbajtjes;
ngjyra dhe kontrasti;	numri i objekteve në dispozicion.

Shembuj

- top më i madh për ndjekje dhe pritje më të lehtë;
- top më i butë për të zvogëluar frikën nga goditja;
- top me ngjyrë kontrastuese për dukshmëri më të mirë;
- top me sinjal zanor kur është i përshtatshëm;
- portë më e gjerë për suksesin fillestar;
- shenja vizuale më të mëdha;
- jelekë që vishen lehtë;
- sipërfaqe e qëndrueshme për detyra statike.

Pajisjet nuk duhen zgjedhur vetëm në bazë të aftësisë së kufizuar. Ato duhen provuar dhe duhet kontrolluar nëse vërtet i përshtaten pjesëmarrësit.

Pyetje për planifikim

A mund të përdoren pajisjet në mënyrë të sigurt?

A janë të dukshme, të qasshme dhe të përshtatshme?

A mund të zgjedhë pjesëmarrësi ndërmjet disa mundësive?

A e lehtëson pajisja veprimin apo krijon pengesë të re?

A nevojitet vlerësim individual ose profesional?

Mbështetja

Mbështetja përfshin gjithçka që e ndihmon pjesëmarrësin ta kuptojë, fillojë, realizojë dhe përfundojë aktivitetin.

Tabela 15. Llojet dhe format e mbështetjes

Ajo mund të jetë:	**Format e mundshme**
• verbale; • vizuale; • e komunikimit; • nga bashkëmoshatarët; • fizike, kur është e domosdoshme dhe e përshtatshme; • organizative; • shqisore; • emocionale; • teknologjike; • profesionale.	• udhëzim i shkurtër; • demonstrim; • orar vizual; • kartelat e komunikimit në futboll; • partner bashkëmoshatar; • kohë shtesë; • provë; • sinjal i dakorduar; • këndi i përshtatur; • zgjedhje e rolit; • udhëzim gradual; • ndihmë në përdorimin e pajisjeve.

Mbështetja duhet të jetë aq e madhe sa është e nevojshme, por aq e vogël sa është e mundur. Qëllimi i saj është rritja e pavarësisë, jo krijimi i varësisë nga një i rritur ose bashkëmoshatar.

Pyetje për planifikim

Çfarë mbështetjeje nevojitet vërtet?

A mund ta kërkojë vetë pjesëmarrësi?

A e pranon?

A është mbështetja e padukshme dhe pa imponim?

A e lidh atë me grupin?

Kur dhe si mund të zvogëlohet gradualisht?

Matricë praktike për përshtatje

Tabela 16. Matrica për planifikimin e përshtatjeve

Elementi	Organizimi fillestar	Pengesa e vërejtur	Ndryshimi i mundshëm
Qëllimi	Të gjithë të gjuajnë drejt portës	Vetëm një mënyrë suksesi	Lejo role të ndryshme kuptimplota
Hapësira	Fushë e madhe	Orientim i vështirë	Zvogëlo fushën dhe shëno zonat
Detyra	Pesë hapa radhazi	Udhëzimi është i ndërlikuar	Ndaje në dy pjesë të shkurtra
Rregullat	Lojë me ndryshime të shpejta	Nuk ka kohë për reagim	Shto kohë ose një sinjal
Pajisjet	Top standard	I vështirë për t'u ndjekur ose kontrolluar	Ofro top më të madh, më të butë ose me kontrast
Mbështetja	Vetëm udhëzim gojor	Nuk është mjaftueshëm i kuptueshëm	Shto demonstrim dhe kartelë vizuale

Shembull: një aktivitet, gjashtë ndryshime të mundshme

Aktiviteti fillestar:

Pjesëmarrësit e drejtojnë topin deri te koni, e anashkalojnë dhe kthehen.

Tabela 17. Gjashtë përshtatje të një aktiviteti futbolli

Elementi	Përshtatja e mundshme
Qëllimi	Në vend të shpejtësisë, përqëndrimi është te lëvizja e pavarur dhe kontrolli
Hapësira	Koni vendoset më afër ose shtegu zgjerohet
Detyra	Pjesëmarrësi mund të ecë, ta shtyjë topin ose të punojë me partnerin
Rregullat	Nuk ka kufizim kohor dhe lejohen disa përpjekje
Pajisjet	Përdoret top më i madh, më i butë ose me kontrast
Mbështetja	Shtohet demonstrim, shigjetë vizuale ose partner bashkëmoshatar

Nuk është e nevojshme që të gjitha ndryshimet të zbatohen njëkohësisht. Zgjidhet kombinimi që krijon ekuilibrin më të mirë ndërmjet qasjes dhe sfidës.

Kur duhet të rritet sfida?

Gjithëpërfshirja nuk do të thotë se detyra duhet të jetë gjithmonë më e lehtë. Nëse pjesëmarrësi e realizon pa përpjekje, humbet interesin ose është gati për hapin tjetër, mund të:

• rritet distanca;	• ofrohet rol udhëheqës;
• shtohet ndryshim drejtimi;	• kombinohen dy aftësi;
• futet lëvizje;	• shtohet zgjedhje ose zgjidhje problemi;
• zvogëlohet mbështetja e drejtpërdrejtë;	• rritet numri i bashkëlojtarëve.

Sfida duhet të jetë e arritshme dhe motivuese, jo burim dështimi të vazhdueshëm.

Zëri i pjesëmarrësit në model

Pas përshtatjes duhet pyetur ose kontrolluar:

A është më e qartë tani për ty?

A të përshtatet ky top?

A dëshiron më afër apo më larg?

A dëshiron partner?

A të duhet edhe pak kohë?

Çfarë do të doje të ndryshonim?

Asnjë zgjidhje profesionale nuk është e plotë nëse nuk merr parasysh përvojën e fëmijës.

4.3. Aktivitete për njohje dhe ndërtim të besimit

Përpara se pjesëmarrësit të bashkëpunojnë me sukses në një aktivitet futbolli, duhet të ndihen të sigurt, të njohin të tjerët dhe të dinë se mënyra e tyre e pjesëmarrjes do të respektohet.

Aktivitetet e njohjes nuk duhet të kërkojnë zbulim publik të të dhënave personale, kontakt fizik apo paraqitje përpara grupit. Secili duhet të ketë mundësi të zgjedhë si do të prezantohet: me fjalë, lëvizje, gjest, simbol, fotografi ose me mbështetjen e një partneri.

Aktiviteti 1: „Shenja ime, vendi im“

Qëllimi kryesor:

Njohja e pjesëmarrësve dhe orientimi në grup dhe hapësirë.

Qëllimi gjithëpërfshirës:

Secili pjesëmarrës të zgjedhë një shenjë ose lëvizje personale dhe të njihet si anëtar i ekipit

Mosha:

I përshtatshëm për të gjitha grupmoshat.

Numri i pjesëmarrësve:
Nga 4 deri në 16.

Kohëzgjatja:

Nga 10 deri në 15 minuta.

Pajisjet:

- top;
- rrathë ose shenja në dysheme;
- kartela me përshëndetje, emër, zgjedhje dhe „kalo radhën“;
- fotografi ose simbole, kur nevojiten.

Përgatitja

Shenjat vendosen në rreth ose gjysmërreth, me hapësirë të mjaftueshme ndërmjet tyre. Secili pjesëmarrës zgjedh një vend. Drejtuesi i aktivitetit demonstron disa mënyra të mundshme prezantimi.

Zhvillimi

1. Secili pjesëmarrës zgjedh një shenjë personale:
   - lëvizje me dorë;
   - prekje të topit;
   - gjest të thjeshtë;
   - tingull ose fjalë;
   - tregim të një simboli;
   - lëvizje të shkurtër sipas zgjedhjes së vet.
2. Pjesëmarrësi i parë e thotë ose e tregon emrin dhe shenjën e vet.
3. Grupi, nëse pjesëmarrësi pajtohet, e përsërit shenjën.
4. Topi i pasohet pjesëmarrësit tjetër.
5. Pasi të jenë prezantuar të gjithë, grupi përpiqet të lidhë emrin ose simbolin me shenjën personale.

Pjesëmarrësi mund të tregojë kartelën „kalo radhën“ dhe të marrë pjesë më vonë ose vetëm të vëzhgojë.

Përshtatjet

- Emri mund të prezantohet me fotografi ose simbol personal.
- Topi mund të rrokulliset, pasohet, shtyhet ose bartet.
- Pjesëmarrësi mund ta zgjedhë shenjën duke treguar njërën prej dy kartelave.
- Një bashkëmoshatar mund ta bëjë shenjën së bashku me pjesëmarrësin.
- Grupi mund të ndahet në rrathë më të vegjël.
- Mund të përdoret top më i butë ose me tingull.
- Nuk është e detyrueshme që lëvizja të bëhet para gjithë grupit.

Mbështetja për komunikim

Kartela të dobishme:

• unë;	• së bashku;
• emri im;	• përsërite;
• shenja ime;	• kalo radhën;
• radha jote;	• mbarova.

Siguria

- Shenjat nuk duhet të rrëshqasin.
- Ndërmjet pjesëmarrësve duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme.
- Kontakti fizik nuk përfshihet pa pëlqim.
- Fëmija nuk detyrohet ta thotë emrin ose të prezantohet para grupit.

Vëzhgimi

Ndiqet nëse pjesëmarrësi:

- ka bërë zgjedhje;
- ka gjetur një mënyrë për t'u prezantuar;
- e ka njohur radhën;
- ka treguar interes për të tjerët;
- është ndier i sigurt;
- ka kërkuar ose pranuar mbështetje

Reflektimi

- Cila mënyrë prezantimi të përshtatej?
- Cilën shenjë e mbajte mend?
- A dëshiron ta mbash apo ta ndryshosh shenjën tënde herën tjetër?
- Çfarë të ndihmoi të ndiheshe pjesë e grupit?

Fokusi gjithëpërfshirës: Secili pjesëmarrës ka të drejtë të zgjedhë vetë si do të prezantohet dhe njihet në grup.

4.4. Aktivitete për orientim dhe lëvizje

Orientimi në hapësirë është baza për pjesëmarrje të sigurt dhe të pavarur në futboll. Pjesëmarrësi duhet të mund të dallojë ku fillon dhe përfundon detyra, në cilin drejtim lëviz, ku ndodhen të tjerët dhe ku mund të kërkojë mbështetje ose pushim.

Aktivitetet e kësaj pjese zhvillojnë:

- vetëdijen për trupin;
- orientimin në hapësirë;
- ndryshimin e drejtimit;
- kontrollin e shpejtësisë;
- ekuilibrin dhe koordinimin;
- ndjekjen e shenjave vizuale, zanore ose me prekje;
- lëvizjen e sigurt pranë pjesëmarrësve të tjerë;
- zgjedhjen e pavarur të shtegut dhe ritmit.

Qëllimi nuk është që të gjithë të lëvizin në të njëjtën mënyrë ose me të njëjtën shpejtësi. Sukses është kur secili e dallon në mënyrë të sigurt drejtimin, kontrollon lëvizjen e vet dhe arrin te caku në mënyrën e përshtatshme.

Aktiviteti 1: „Gjeje ngjyrën tënde“

Qëllimi kryesor:
Orientimi në hapësirë dhe lëvizja drejt një caku të shënuar.

Qëllimi gjithëpërfshirës:
Secili pjesëmarrës të zgjedhë dhe të ndjekë një shenjë që mund ta dallojë lehtë.

Numri i pjesëmarrësve:
Nga 4 deri në 16.

Kohëzgjatja:
Nga 10 deri në 15 minuta.

Pajisjet

- kone, rrathë ose shenja dyshemeje me ngjyra të ndryshme;
- kartela me ngjyrat përkatëse;
- fotografi, numra ose shenja me prekje;
- topa sipas zgjedhjes.

Përgatitja

Në hapësirë vendosen disa zona të ndara qartë. Secila zonë shënohet me ngjyrë dhe me një shenjë tjetër – formë, numër, simbol ose objekt.

Ngjyrat nuk duhet të jenë mënyra e vetme e dallimit, sepse disa pjesëmarrës mund ta kenë të vështirë t›i dallojnë.

Zhvillimi

1. Secili pjesëmarrës zgjedh ose merr një kartelë me shenjë.
2. E gjen vendin përkatës në hapësirë.
3. Me sinjalin e dakorduar lëviz drejt një zone tjetër të zgjedhur.
4. Në raundin vijues mund ta bartë, shtyjë ose drejtojë topin.
5. Pjesëmarrësit zgjedhin gradualisht shtegun e tyre.
6. Në fund kthehen në zonën fillestare.

Përshtatjet

- Zonat mund të jenë më afër dhe më të mëdha.
- Shtegu mund të shënohet me vijë ose shigjeta.
- Pjesëmarrësi mund të lëvizë me një bashkëmoshatar.
- Në vend të ngjyrës mund të ndjekë tingullin, numrin, figurën ose shenjën me prekje.
- Topi mund të bartet, të rrokulliset ose të mos përdoret fare.
- Numri i zonave mund të zvogëlohet.
- Pjesëmarrësi mund të zgjedhë ndërmjet dy alternativave, në vend të shumë mundësive.
- Mundësohet lëvizja me mjet ndihmës në shteg pa pengesa.

Siguria

Shenjat duhet të jenë të qëndrueshme dhe të mos rrëshqasin.

- Shtigjet nuk duhet të kryqëzohen shumë afër.
- Shpejtësia rritet vetëm kur pjesëmarrësit orientohen në mënyrë të sigurt.
- Para çdo ndryshimi jepet sinjal i qartë.

Vëzhgimi

- A e njeh pjesëmarrësi shenjën e vet?
- A e gjen zonën në mënyrë të pavarur?
- A e kontrollon shpejtësinë?
- A i vëren pjesëmarrësit e tjerë?
- Cila lloj shenje e ndihmon më shumë?

Fokusi gjithëpërfshirës: Hapësira duhet t›i japë informacion pjesëmarrësit, në vend që ai të varet vazhdimisht nga udhëzimet e një të rrituri.

Udhëzim përmbyllës për aktivitetet e orientimit dhe lëvizjes

Në këto aktivitete duhet ndjekur nëse pjesëmarrësi:

- e dallon fillimin dhe fundin;
- mund të ndjekë drejtimin;
- e kontrollon shpejtësinë në mënyrë të sigurt;
- ka kohë të mjaftueshme për reagim;
- mund të zgjedhë shtegun dhe mënyrën e lëvizjes;
- orientohet me gjithnjë e më pak ndihmë të drejtpërdrejtë;
- i vëren pjesëmarrësit e tjerë;
- mund të kërkojë ndalje, ndihmë ose pushim;
- ndihet i sigurt të provojë një lëvizje të re.

Mesazhi kryesor: Orientimi nuk varet vetëm nga aftësia e pjesëmarrësit. Ai varet edhe nga sa qartë ia tregon hapësira ku ndodhet, ku po shkon dhe cilat zgjedhje ka në dispozicion.

4.5. Aktivitete për zhvillimin e aftësive themelore të futbollit

Aftësitë bazë të futbollit – kontrolli i topit, drejtimi, pasimi, pritja dhe gjuajtja – mund të zhvillohen në shumë mënyra. Nuk është e nevojshme që të gjithë pjesëmarrësit të përdorin të njëjtën teknikë, pajisje ose pozicion trupor.

Përparësi është që pjesëmarrësi:

- të kuptojë qëllimin e lëvizjes;
- të vendosë kontakt të sigurt me topin;
- të mund të zgjedhë pajisjen dhe distancën e përshtatshme;
- ntë përmirësojë gradualisht kontrollin;
- ta zbatojë aftësinë në bashkëpunim me të tjerët;
- të përjetojë sukses pa u krahasuar me të tjerët.

Aktiviteti 1: „Njihe topin“

Qëllimi kryesor:
Eksplorimi dhe zhvillimi i kontrollit bazë të topit.

Qëllimi gjithëpërfshirës:
Secili pjesëmarrës të zgjedhë topin dhe mënyrën e kontaktit që i përshtatet.

Numri i pjesëmarrësve:
Nga 4 deri në 16.

Kohëzgjatja:
Nga 10 deri në 15 minuta.

Pajisjet:

- topa me madhësi, peshë, ngjyrë dhe teksturë të ndryshme;
- topa të butë dhe me tingull, kur nevojiten;
- shenja në dysheme;
- kartela „zgjidh“, „shtyje“, „rrokullise“, „ndalo“ dhe „ndërro“.

Zhvillimi

1. Topat vendosen në vend të qasshëm.
2. Pjesëmarrësit zgjedhin një top.
3. **E eksplorojnë përmes një ose disa veprimeve:**

- дprekje;
- rrokullisje;
- shtyrje;
- ndalim;
- bartje nga njëra anë në tjetrën;
- kalim i topit mes shputave ose duarve

4. Me sinjalin e dakorduar mund ta mbajnë ose ta ndërrojnë topin.
5. Secili tregon një lëvizje që i përshtatet dhe grupi mund ta përsërisë.

Përshtatjet

- Pjesëmarrësi mund të ulet ose të përdorë pozicion të qëndrueshëm.
- Topi mund të vendoset mbi një sipërfaqe të palëvizshme.

- Mund të përdoren duart, shputa ose një mjet ndihmës i sigurt.
- Kufizohet numri i topave të ofruar nëse zgjedhja është tepër e gjerë.
- Një bashkëmoshatar mund ta kthejë topin.
- Për sfidë shtesë kombinohen dy veprime.

Siguria

- Topat duhet të jenë të pastër dhe në gjendje të mirë.
- Hapësira duhet të lejojë lëvizje të lirë.
- Topi nuk hidhet drejt pjesëmarrësit pa sinjal paraprak.
- Respektohet nëse një teksturë ose tingull shkakton shqetësim.

Reflektimi

- Cili top të përshtatej?
- Cila lëvizje ishte më e lehtë për ty?
- Çfarë dëshiron të provosh sërish?
- A dëshiron top tjetër herën tjetër?

Fokusi gjithëpërfshirës: Takimi i parë me topin duhet të nxisë kureshtje dhe siguri, jo presion për realizim teknikisht të përkryer.

Udhëzim përmbyllës për aftësitë bazë të futbollit

Përparimi duhet ndjekur në raport me pikënisjen individuale. Mund të vërehet nëse pjesëmarrësi:

- vendos kontakt më të sigurt me topin;
- e kontrollon më mirë drejtimin;
- zgjedh pajisjen në mënyrë të pavarur;
- e përshtat lëvizjen;
- e përdor aftësinë në detyrë me partner ose ekip;
- kërkon mbështetjen e përshtatshme;
- pranon informacion kthyes;
- shfaq këmbëngulje dhe kënaqësi;
- merr pjesë me më shumë pavarësi.

Mesazhi kryesor: Aftësia bazë në futboll nuk është një model i vetëm i përsosur që të gjithë duhet ta kopjojnë. Është aftësi funksionale që secili pjesëmarrës e zhvillon përmes pajisjeve të përshtatshme, detyrës së kuptueshme, zgjedhjes dhe mundësive të mjaftueshme për sukses.

4.6. Aktivitete për komunikim dhe bashkëpunim

Në futboll komunikimi nuk zhvillohet vetëm me të folur. Shikimi, lëvizja, pozicioni i trupit, gjesti, simboli, kartela dhe pasimi i topit gjithashtu përçojnë mesazh.

Aktivitetet e kësaj pjese i nxisin pjesëmarrësit:

- të dërgojnë dhe të njohin mesazhe;
- të bëjnë zgjedhje;
- të kërkojnë ndihmë;
- të presin përgjigje;
- të bien dakord për veprim të përbashkët;
- të ndërrojnë role;
- të zgjidhin një detyrë si ekip;
- të respektojnë mënyra të ndryshme komunikimi.

Komunikimi është i suksesshëm kur mesazhi kuptohet dhe pjesëmarrësi merr përgjigjen e përshtatshme, jo vetëm kur mesazhi shprehet me fjalë.

Aktiviteti 1: „Më trego pasimin“

Qëllimi kryesor:
Zhvillimi i komunikimit përpara pasimit dhe i gatishmërisë për pranimin e topit.

Qëllimi gjithëpërfshirës:
Secili pjesëmarrës të zgjedhë dhe të përdorë një sinjal të qasshëm për „jam gati“**.**

Numri i pjesëmarrësve:
Çifte ose grupe me nga tre.

Kohëzgjatja:
Nga 10 deri në 15 minuta.

Pajisjet:

- topa;
- shenja në dysheme;
- kartela „jam gati“, „prit“, „pasoje“ dhe „përsëri“.

Zhvillimi

1. Secili pjesëmarrës zgjedh një sinjal gatishmërie:
   - fjalë;
   - dorë të ngritur;
   - shikim;
   - prekje të shenjës;
   - gjest;
   - tregim të kartelës;
   - aktivizim të një mjeti komunikimi.
2. Partneri e mban topin derisa ta dallojë sinjalin.
3. Pas sinjalit e pason në mënyrën e dakorduar.
4. Marrësi e ndal topin dhe më pas ndërrojnë rolet.
5. Pas disa përpjekjeve partnerët kontrollojnë cili sinjal ishte më i qartë.

Përshtatjet

- Zvogëlohet distanca.
- Topi rrokulliset ose dorëzohet.
- Sinjali mund të jetë vizual, zanor ose me prekje.
- Pjesëmarrësi mund të zgjedhë ndërmjet dy kartelave të gatshme.
- Jepet kohë shtesë për përgjigje.
- Një bashkëmoshatar mund ta tregojë sinjalin së bashku me pjesëmarrësin.
- Për sfidë më të madhe, marrësi zgjedh edhe drejtimin e pasimit vijues.

Rregulli kryesor

Nuk ka pasim pa sinjal të qartë se partneri është gati.

Vëzhgimi

- A e ka zgjedhur pjesëmarrësi sinjalin?
- A e dallon dhe e respekton partneri?
- A lë kohë për përgjigje?
- A funksionon sinjali edhe kur detyra përsëritet?

Fokusi gjithëpërfshirës: Çdo mënyrë komunikimi ka vlerë të barabartë kur e përcjell mesazhin dhe respektohet nga të tjerët.

Udhëzim përmbyllës

Aktivitetet për komunikim dhe bashkëpunim janë të suksesshme kur:

- secili ka një mënyrë të kuptueshme për të dërguar mesazh;
- mesazhet marrin përgjigje;
- pjesëmarrësit pyesin përpara se të ndihmojnë;
- lihet kohë e mjaftueshme për zgjedhje dhe reagim;
- vendimet nuk merren gjithmonë nga të njëjtët anëtarë;
- rolet ndërrohen;
- suksesi i përbashkët varet nga kontribute të ndryshme;
- pjesëmarrësit dinë të propozojnë ndryshime kur loja nuk është e qasshme.

Mesazhi kryesor: Në një ekip gjithëpërfshirës, komunikimi nuk është vetëm të folurit dhe bashkëpunimi nuk është vetëm pasimi i topit. Ato nënkuptojnë dërgimin e mesazhit, pritjen e përgjigjes dhe përshtatjen e veprimit, në mënyrë që qëllimi i përbashkët të jetë i arritshëm për të gjithë.

4.7. Aktivitete për ndërtimin e ndjenjës së përkatësisë

Përkatësia nuk nënkupton vetëm që fëmija të jetë i regjistruar në grup ose fizikisht i pranishëm në fushë. Ajo ndërtohet kur pjesëmarrësi:

- njihet me emër dhe si person;
- ka rol të rëndësishëm;
- mund të ndikojë në vendimet e përbashkëta;
- kontributi i tij vërehet;
- bashkëmoshatarët e kërkojnë dhe e përfshijnë;
- mund të kërkojë dhe të ofrojë mbështetje;
- ndihet i sigurt të jetë vetvetja;
- e di se prania e tij ka rëndësi për ekipin.

Aktivitetet në vijim e zhvendosin vëmendjen nga aftësia individuale drejt përvojës së përbashkët dhe mënyrave të ndryshme të kontributit.

Aktiviteti 1: „Rrethi i ekipit“

Qëllimi kryesor:
Krijimi i identitetit të përbashkët dhe njohja e anëtarëve të ekipit.

Qëllimi gjithëpërfshirës:
Secili pjesëmarrës të kontribuojë me një shenjë, mesazh ose lëvizje në ritualin e përbashkët ekipor.

Numri i pjesëmarrësve:
Nga 5 deri në 20.

Kohëzgjatja:
Nga 10 deri në 15 minuta.

Pajisjet:

- top;
- kartela me përshëndetje, gjeste dhe mesazhe ekipore;
- shenja në dysheme;
- tabelë ose fletë e madhe.

Zhvillimi

1. Pjesëmarrësit vendosen në rreth ose gjysmërreth.
2. Secili zgjedh një kontribut::
    - përshëndetje të shkurtër;
    - gjest;
    - prekje të topit;
    - fjalë;
    - simbol;
    - ritëm ose lëvizje.
3. Grupi i lidh elementet e zgjedhura në një përshëndetje të përbashkët ekipore.
4. Përshëndetja përdoret në fillim ose në fund të aktiviteteve të ardhshme.
5. Pas një kohe, pjesëmarrësit mund ta ndryshojnë ose plotësojnë atë.

Përshtatjet

- Pjesëmarrësi mund të zgjedhë ndërmjet dy mundësive të ofruara.
- Gjesti mund të kryhet me partnerin.
- Në vend të lëvizjes, mund të zgjedhë ngjyrë, figurë ose tingull.
- Nuk ka kontakt fizik të detyrueshëm.
- Pjesëmarrësi mund të vëzhgojë fillimisht dhe të përfshihet më vonë.
- Përshëndetja paraqitet përmes renditjes vizuale.

E rëndësishme

Rituali i ekipit duhet të jetë i shkurtër, dinjitoz dhe vullnetar. Ai nuk duhet të përfshijë prekje të padëshiruara ose një mesazh që përjashton dikë që nuk mund ta realizojë në të njëjtën mënyrë.

Reflektimi

- Cilën pjesë të përshëndetjes e propozove ti?
- A u përfshi kontributi i secilit?
- Si ndihesh kur ekipi e përdor përshëndetjen tonë?

Fokusi gjithëpërfshirës: Identiteti i përbashkët është më i fortë kur secili anëtar mund të dallojë pjesë të kontributit të vet në të.

Udhëzim përmbyllës

Ndjenja e përkatësisë dallohet kur pjesëmarrësi:

- kthehet vullnetarisht në grup;
- komunikon me bashkëmoshatarë të ndryshëm;
- ka rol që e kupton dhe e vlerëson;
- bën zgjedhje;
- propozon ide;
- e njeh kontributin e vet;
- merr informacion kthyes konkret e pozitiv;
- e di se mund të kërkojë ndihmë ose pushim;
- nuk harrohet gjatë ndarjes së roleve dhe pasimeve;
- ndihet anëtar, jo mysafir i ekipit

Mesazhi kryesor: Përkatësia nuk arrihet duke thënë „Të gjithë jeni të mirëseardhur“, por përmes veprimeve të përditshme që i tregojnë secilit se është vënë re, dëgjuar, përfshirë dhe i rëndësishëm për ekipin.

4.8. Aktivitete ekipore dhe lojëra bashkëpunuese

Lojërat bashkëpunuese e orientojnë grupin drejt një qëllimi të përbashkët. Në to, suksesi nuk varet nga epërsia e një pjesëmarrësi ndaj të tjerëve, por nga aftësia e ekipit për të komunikuar, lidhur kontributet e ndryshme dhe përshtatur strategjinë, në mënyrë që të gjithë të marrin pjesë.

Kjo nuk do të thotë se këto aktivitete janë pa sfida. Sfida ekziston, por përqëndrohet te zgjidhja e një detyre të përbashkët, përmirësimi i përpjekjes së mëparshme ose arritja e një qëllimi ekipor.

Loja bashkëpunuese është cilësore kur:

- secili pjesëmarrës ka rol të rëndësishëm;
- askush nuk eliminohet;
- rezultati varet nga kontribute të ndryshme;
- anëtarët komunikojnë dhe marrin vendime së bashku;
- rregullat mund të përshtaten;
- ekipi ndjek përparimin e vet dhe jo vetëm rezultatin e të tjerëve.

Aktiviteti 1: „Mbajeni topin brenda ekipit“

Qëllimi kryesor:
Zhvillimi i pasimit, pritjes dhe pozicionimit ekipor.

Qëllimi gjithëpërfshirës:
Secili anëtar të ketë mundësi të kontribuojë në vazhdimësinë e aksionit të përbashkët.

Numri i pjesëmarrësve:
Ekipe me 4 deri në 7 veta.

Kohëzgjatja:
Nga 15 deri në 20 minuta.

Pajisjet:

- një ose disa topa;
- kone për shënimin e hapësirës;
- kartela „jam gati“, „pasoje“, „prit“ dhe „ndërro vendin“;
- numërues ose shirit vizual për përparimin.

Zhvillimi

1.Ekipi pozicionohet në hapësirën e shënuar.
2. Qëllimi është të realizojë një numër të dakorduar pasimesh të suksesshme.
3. Para çdo pasimi, marrësi jep sinjal se është gati.
4. Secili anëtar duhet të ketë mundësi të kontribuojë përpara se të fillojë raundi i ri.
5. Ekipi i numëron vetë pasimet ose shënon përparimin.
6. Nëse topi del nga hapësira, aktiviteti vazhdon nga hapi i fundit i arritur ose nis një provë e re – pa eliminim.
7. Pas provës ekipi zgjedh çfarë të ndryshojë për të bashkëpunuar më mirë.

Përshtatjet

- Numri i pasimeve të nevojshme zvogëlohet ose rritet.
- Topi mund të rrokulliset, dorëzohet ose të pasohet me shputë.
- Hapësira zgjerohet për të pasur më shumë kohë reagimi.

- Përdoren dy grupe më të vogla për të zvogëluar pritjen.
- Pjesëmarrësi mund të kontribuojë me sinjal, zgjedhjen e lojtarit vijues ose numërim.
- Përdoret top më i madh, më i butë ose me tingull.
- Për sfidë shtesë shtohet lëvizja pas pasimit.

Mision për bashkëmoshatarët

„Do të vërej se kush nuk ka pasur ende mundësi të kontribuojë.“

Vëzhgimi

- A qarkullon topi ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm?
- A e merr një anëtar vazhdimisht përsipër gjithë aksionin?
- A ka kohë të mjaftueshme për reagim?
- A komunikojnë pjesëmarrësit drejtpërdrejt?
- A propozon ekipi ndryshime funksionale?

Fokusi gjithëpërfshirës: Qëllimi nuk është vetëm që ekipi ta mbajë topin, por edhe të ruajë lidhjen ndërmjet të gjithë anëtarëve të vet.

Udhëzim përmbyllës

Në lojërat bashkëpunuese duhet kontrolluar:

- A kërkon vërtet bashkëpunim detyra?
- A ka secili pjesëmarrës rol të rëndësishëm?
- A mund të ndërrohen rolet?
- A e merr një anëtar përsipër të gjithë aktivitetin?
- A është komunikimi i qasshëm?
- A e nxisin apo e kufizojnë rregullat përfshirjen?
- A mund ta përshtatë ekipi strategjinë?
- A matet përparimi edhe përmes pjesëmarrjes dhe përkatësisë?
- A e shmang aktiviteti eliminimin dhe renditjen publike?

Mesazhi kryesor: Në lojën bashkëpunuese ekipi nuk fiton sepse një anëtar ka bërë gjithçka, por sepse ka krijuar kushte që secili anëtar të bëjë diçka të rëndësishme për qëllimin e përbashkët.

4.9. Minindeshje gjithëpërfshirëse

Gara mund të jetë përvojë motivuese, emocionuese dhe zhvilluese, por vetëm kur rregullat, ekipet dhe mënyra e vlerësimit sigurojnë pjesëmarrje dinjitoze dhe të rëndësishëm për të gjithë.

Minindeshja gjithëpërfshirëse nuk e heq sfidën sportive dhe nuk kërkon barazim të paracaktuar të rezultatit. Ajo krijon kushte të drejta ku pjesëmarrësit mund të zbatojnë aftësitë, të marrin vendime, të bashkëpunojnë dhe ta përjetojnë garën pa poshtërim, veçim ose dështim të vazhdueshëm.

Çfarë e bën një ndeshje gjithëpërfshirëse?

Minindeshja gjithëpërfshirëse:

- ka rregulla të qarta dhe të kuptueshme;
- përdor pak lojtarë dhe raunde të shkurtra;
- siguron rol të rëndësishëm për secilin;
- mundëson mënyra të ndryshme kontributi;
- përshtat hapësirën, pajisjet dhe rregullat;
- siguron kohë të mjaftueshme reagimi;
- shmang qëndrimin e gjatë në stol;
- nuk eliminon pjesëmarrësit për një gabim;
- vlerëson rezultatin, por edhe lojën ekipore;
- mundëson pushim dhe rikthim;
- ka rregulla të qarta për respektin dhe mbrojtjen;
- përfundon me reflektim të shkurtër.

Përpara ndeshjes

A i kupton secili pjesëmarrës rregullat?

A janë paraqitur rregullat edhe vizualisht?

A janë formuar ekipet në mënyrë të drejtë?

A ka secili një rol që mund ta ndërrojë?

A është fusha e përshtatshme dhe e sigurt?

A është topi i dukshëm dhe i qasshëm?

A janë dakorduar sinjalet për fillim, ndalim dhe pushim?

A ka plan për zëvendësim dhe rikthim në lojë?

A i dinë të rriturit përgjegjësitë e tyre?

A e dinë pjesëmarrësit kujt t›i drejtohen nëse diçka i shqetëson?

Rregullat duhen provuar në një raund të shkurtër. Nëse dikush mbetet pa mundësi reale pjesëmarrjeje, rregulli ndryshohet para fillimit të ndjekjes së rezultatit.

Formimi i ekipeve

Ekipet duhen krijuar në mënyrë që:

- të mos ketë përzgjedhje publike të lojtarëve „më të mirë“ dhe „më të dobët“;
- të mos formohen sipas diagnozës apo aftësisë së kufizuar;
- të merren parasysh aftësitë, komunikimi dhe dinamika ndërpersonale;
- të shmanget caktimi i përhershëm i një fëmije tek i njëjti ndihmës;
- të sigurohet ekuilibër ndërmjet mbështetjes dhe pavarësisë;
- pjesëmarrësit, kur është e mundur, të kenë zë në zgjedhje;
- përbërjet dhe rolet të mund të ndryshojnë.

Formimi i ekipeve duhet bërë me maturi dhe respekt. Nuk është e përshtatshme t›i shpjegohet grupit se një fëmijë është vendosur në një ekip „sepse ka nevojë për ndihmë“.

Modelet e vlerësimit

Që ndeshja të mos reduktohet vetëm në numrin e golave, mund të ndiqen tri dimensione njësoj të dukshme:

Tabela 18. Vlerësimi i minindeshjes gjithëpërfshirëse

Dimensioni	Çfarë vlerësohet?
Rezultati sportiv	Golat, pasimet e suksesshme ose detyrat e përfunduara
Lidhja ekipore	Përfshirja, komunikimi, ndërrimi i roleve dhe bashkëpunimi
Loja e ndershme dhe mirëqenia	Respekti, siguria, ndihma me pëlqim dhe pranimi i pushimit

Ky model nuk nënkupton se çdo sjellje pozitive duhet të shpërblehet me pikë formale. Në varësi të moshës, mund të përdoren simbole, reflektim ekipor ose informacion kthyes i shkurtër.

Modeli 1: „Çdo prekje e ndërton aksionin“

Qëllimi kryesor:
Zbatimi i pasimit, lëvizjes dhe gjuajtjes në një minilojë.

Qëllimi gjithëpërfshirës:
Ekipi të krijojë aksione ku anëtarë të ndryshëm kanë mundësi të kontribuojnë.

Numri i pjesëmarrësve:
Tre kundër tre ose katër kundër katër.

Kohëzgjatja:
Raunde nga 4 deri në 6 minuta.

Pajisjet:

top i vogël ose mesatar sipas nevojave;
dy porta ose zona të shënuara si cak;
jelekë ose shenja të tjera ekipore;
kartela për rregullat dhe komunikimin

Rregullat bazë

Luhet në fushë të zvogëluar dhe të shënuar qartë.
Para gjuajtjes drejt portës, ekipi kryen numrin e dakorduar të pasimeve.
Pasimi bëhet pasi marrësi të tregojë se është gati.
Nuk ka eliminim pas gabimit.
Zëvendësimet janë të shkurtra dhe dakordohen paraprakisht.
Secili pjesëmarrës mund të kërkojë pushim.

Përshtatje të mundshme

Zvogëlimi i numrit të nevojshëm të pasimeve.
Portë më e gjerë ose zonë më e madhe e cakut.
Përdorimi i topit më të butë, më të madh ose me tingull.
Kohë shtesë për pranimin e topit dhe vazhdimin e lojës.
Zonë ku nuk ushtrohet presion i drejtpërdrejtë nga kundërshtari.
Kufizimi i kontaktit të fortë ose jo të sigurt.
Mundësia që topi të rrokulliset ose të dorëzohet.
Sinjal vizual për fillim dhe ndalim.
Mënyra të ndryshme të përfundimit të aksionit.

E rëndësishme

Rregulli „secili duhet ta prekë topin“ nuk duhet zbatuar në mënyrë të ngurtë nëse krijon presion ose e kthen një fëmijë në pengesë që të gjithë e presin. Formulim më i mirë është:

„Ekipi krijon mundësi reale që secili anëtar të kontribuojë në aksion.“

Kontributi mund të jetë pasim, lëvizje, zgjedhje e drejtimit, sinjal komunikimi ose rol tjetër i dakorduar.

Modeli 2: „Tri zona – një ekip“

Qëllimi kryesor:
Zhvillimi i orientimit, pozicionimit dhe përparimit ekipor me top.

Qëllimi gjithëpërfshirës:
Secili të ketë rol të qartë dhe të dukshëm në një zonë të caktuar, me mundësi ndërrimi.

Numri i pjesëmarrësve:
Ekipe me 3 deri në 6 veta.

Kohëzgjatja:
Raunde nga 5 minuta.

Pajisjet:

kone ose vija për tri zona;

top;

dy porta ose zona fundore si cak;

kartela me role.

Organizimi

Fusha ndahet në:

zonën fillestare;

zonën qendrore;

zonën përfundimtare.

Ekipi duhet ta kalojë topin nëpër zona dhe ta drejtojë drejt cakut.

Rregullat

Në secilën zonë duhet të ketë kontribut të rëndësishëm ekipor.

Lojtarët mund të kalojnë ndërmjet zonave sipas marrëveshjes.

Pas çdo raundi ndërrohen rolet.

Ekipi vendos vetë si do ta kalojë topin.

Sipas nevojës përdoret rregulli për kohë shtesë ose hapësirë të mbrojtur.

Përshtatjet

Zonat bëhen më të gjera ose më të shkurtra.

Zvogëlohet numri i kundërshtarëve.

Në një zonë mund të ketë një partner bashkëmoshatar.

Topi mund të mbahet më gjatë.

Pjesëmarrësi mund të zgjedhë një zonë të përshtatshme, por inkurajohet t›i provojë gradualisht rolet e ndryshme.

Përdoren shenja vizuale për kalimin në zonën tjetër.

Për sfidë më të madhe futet zgjedhja ndërmjet dy shtigjeve.

Rreziku për gjithëpërfshirjen

Nuk duhet që një fëmijë të vendoset vazhdimisht në zonën më pak aktive. Rolet duhet të jenë kuptimplota dhe pjesëmarrësi të ketë mundësi t›i zgjedhë e t›i ndryshojë.

Modeli 3: „Dy caqe– më shumë strategji“

Qëllimi kryesor:
Zhvillimi i vendimmarrjes dhe strategjisë ekipore.

Qëllimi gjithëpërfshirës:
Pjesëmarrësit të zgjedhin ndërmjet rrugëve të ndryshme për të fituar pikë, sipas pikave të forta të ekipit.

Numri i pjesëmarrësve:
Tre kundër tre ose katër kundër katër.

Kohëzgjatja:
Raunde nga 4 deri në 6 minuta.

Pajisjet:

dy zona të ndryshme të cakut për çdo ekip;

top;

shenja vizuale;

kartela strategjie.

Zhvillimi

Secili ekip mund të fitojë pikë në dy mënyra:

duke e drejtuar topin në portë;

duke e pasuar në mënyrë të kontrolluar te bashkëlojtari në zonën e shënuar të cakut.

Ekipi zgjedh strategjinë që do të përdorë.

Pse është e dobishme?

Mënyra e vetme e fitimit të pikëve ndonjëherë favorizon vetëm aftësi të caktuara. Dy caqet mundësojnë:

mënyra të ndryshme kontributi;

më shumë vendime;

pozicionim më të mirë;

përfshirje të pjesëmarrësve me pika të forta të ndryshme;

ndryshim strategjie gjatë lojës.

Përshtatjet

Zona e cakut zgjerohet.

Caqeve mund t›u caktohen vlera të ndryshme, pa nënvlerësuar njërin.

Ekipi mund të kërkojë ndërprerje të shkurtër për t›u marrë vesh.

Futet kartelë vizuale për strategjinë e zgjedhur.

Pjesëmarrësve mund t›u jepet më shumë kohë për kontrollin e topit.

Kontakti kufizohet sipas nevojave të sigurisë.

Modeli 4: „Minifutboll me rotacion“

Qëllimi kryesor:
Zbatimi i roleve të ndryshme të futbollit në raunde të shkurtra garuese.

Qëllimi gjithëpërfshirës:
Të parandalohet mbetja e përhershme e pjesëmarrësve në një rol të paracaktuar.

Numri i pjesëmarrësve:
Ekipe me 4 deri në 6 veta.

Kohëzgjatja:
Katër raunde nga 3 deri në 5 minuta.

Rolet e mundshme

- organizues i fillimit;
- lojtar në mesfushë;
- përfundues i aksionit;
- portier ose mbrojtës i zonës së cakut;
- udhërrëfyes komunikimi;
- zëvendësues që hyn sipas orarit të qartë.

Zhvillimi

Para çdo raundi paraqiten rolet.

Pjesëmarrësit zgjedhin ose dakordojnë rolin fillestar.

Pas raundit të shkurtër bëhet rotacioni.

Pjesëmarrësi mund ta mbajë rolin nëse ndryshimi shkakton pasiguri, por kjo dakordohet me të.

Pas raundit të fundit secili zgjedh rolin që i përshtatej më shumë.

Përshtatjet

Rolet shënohen me simbole.

Rotacioni paralajmërohet paraprakisht.

Pjesëmarrësi mund të kalojë gradualisht në një rol të ri.

Nuk përdoret rotacion i detyruar nëse rrezikon ndjenjën e sigurisë.

Çdo rol ka funksion real.

Sigurohet një periudhë e shkurtër prove para fillimit të matjes së rezultatit.

Fokusi gjithëpërfshirës: Rotacioni nuk do të thotë që të gjithë patjetër të bëjnë gjithçka, por që secili të ketë mundësi të zbulojë kontribute të ndryshme pa u kufizuar paraprakisht.

Roli i rezultatit

Rezultati mund të mbetet pjesë e garës, por nuk duhet të bëhet më i rëndësishëm se siguria, dinjiteti dhe pjesëmarrja e rëndësishme.

Mund të ndiqen:

- golat e shënuar;
- aksionet ekipore të suksesshme;
- anëtarët e përfshirë;
- sinjalet e respektuara të komunikimit;
- ndërrimet e suksesshme të roleve;
- veprimet e drejta dhe mbështetëse;
- përmirësimi në krahasim me raundin e mëparshëm.

Rezultati nuk duhet:

të ndryshohet fshehurazi nga keqardhja;

t›i dhurohet një pjesëmarrësi të caktuar;

të përdoret për poshtërim publik;

t›i nxisë ekipet të përjashtojnë anëtarin më pak të aftë;

të jetë treguesi i vetëm i suksesit.

Fitorja, humbja dhe mbështetja emocionale

Fëmijët kanë të drejtë të përjetojnë edhe fitoren, edhe humbjen në një mjedis të sigurt. Nuk është e nevojshme që çdo ndeshje të përfundojë barazim ose të gjithë të marrin shpërblim identik.

Duhet të sigurohen:

- gjykim i qartë dhe i qëndrueshëm;
- respektim i rezultatit;
- e drejta për të shprehur emocione pa dëmtuar të tjerët;
- kohë e shkurtër për qetësim;
- përqëndrim te ajo që u mësua dhe kontributi;
- urime pa poshtërim;
- mundësi për provë të re.

Pas ndeshjes mund të pyetet:

Çfarë bëmë mirë si ekip?

Kur bashkëpunuam më mirë?

A pati secili rol të rëndësishëm?

Çfarë ishte e vështirë për ne?

Çfarë do të ndryshojmë në raundin tjetër?

Si treguam respekt për ekipin kundërshtar?

Shpërblimet dhe mirënjohjet

Nëse jepen mirënjohje, ato mund të vlerësojnë:

- bashkëpunimin ekipor;
- komunikimin e qartë;
- lojën e ndershme;
- këmbënguljen;
- zgjidhjen krijuese;
- respektimin e zgjedhjes;
- kthimin në aktivitet;
- kontributet e ndryshme.

Nuk duhet që çdo fëmijë të marrë një etiketë ose shpërblim që e krahason me të tjerët. Ndonjëherë mirënjohja më e përshtatshme është një vlerësim konkret:

„Vumë re çastin kur priti bashkëlojtarin dhe e përshtati shpejtësinë e pasimit. Kjo e ndihmoi ekipin ta vazhdonte aksionin.“

Kontroll praktik pas minindeshjes

A ishin rregullat të kuptueshme dhe të drejta?

A pati secili mundësi reale të kontribuojë?

A e kaloi dikush shumicën e kohës jashtë lojës?

A e ruajtën përshtatjet sfidën sportive?

A komunikuan ekipet me respekt?

A e nxiti apo e zvogëloi rezultati pjesëmarrjen?

A ishin të parashikueshme zëvendësimet dhe rotacionet?

A mund të kërkonin pjesëmarrësit pushim?

A u reagua në kohë ndaj sjelljeve të pasigurta ose poshtëruese?

Çfarë duhet të ndryshojë para ndeshjes së ardhshme?

Mesazhi kryesor: Ndeshja gjithëpërfshirëse nuk e heq sfidën dhe nuk dhuron sukses. Ajo krijon kushte të drejta, fleksibile dhe të sigurta ku secili mund të luajë vërtet, të kontribuojë dhe t›i përjetojë me dinjitet si fitoren, ashtu edhe humbjen.

4.10. Shembuj të një seance të plotë gjithëpërfshirëse të futbollit

Seanca e plotë gjithëpërfshirëse i lidh qëllimet sportive, komunikuese, shoqërore dhe zhvillimore në një rrjedhë të qartë dhe të parashikueshme. Ajo nuk është një varg aktivitetesh „të veçanta“ të ndara, por program i përbashkët me shumë mënyra pjesëmarrjeje.

Çdo seancë duhet të përmbajë:

- ardhjen dhe orientimin;
- përshëndetjen dhe prezantimin e rrjedhës;
- aktivitetin përgatitor;
- zhvillimin e aftësisë konkrete të futbollit;
- bashkëpunimin ose detyrën ekipore;
- minilojën;
- qetësimin dhe reflektimin;
- vlerësim të shkurtër nga ekipi profesional.

Modelet e propozuara mund të shkurtohen, zgjaten ose përshtaten sipas moshës, numrit dhe nevojave të pjesëmarrësve.

Modeli A: „Nga zgjedhja te goli i përbashkët“

Qëllimi kryesor:
Zhvillimi i pasimit, pritjes dhe pjesëmarrjes në aksion ekipor..

Qëllimet gjithëpërfshirëse:

- secili pjesëmarrës të bëjë të paktën një zgjedhje të rëndësishme;
- secili të përdorë një mënyrë të qasshme komunikimi;
- të gjithë të kenë rol të rëndësishëm në ekip;
- pjesëmarrësit të ofrojnë, kërkojnë ose pranojnë mbështetje;
- pushimi të jetë i qasshëm pa humbur ndjenjën e përkatësisë.

Mosha orientuese:
Nga 7 deri në 12 vjeç, me përshtatjet e nevojshme

Numri i pjesëmarrësve:
Nga 8 deri në 16.

Kohëzgjatja:
Rreth 45 minuta.

Hapësira:
Sallë sportive, oborr shkolle ose fushë më e vogël.

Pajisjet e nevojshme:

- topa me madhësi dhe butësi të ndryshme;
- kone dhe shenja në dysheme;
- dy porta të vogla ose zona të cakut të shënuara;
- kartelat e komunikimit në futboll;
- Пpasaporta për mbështetjen nga bashkëmoshatarët;
- orar vizual;
- materiale nga këndi i përshtatur;
- ujë dhe pajisje të ndihmës së parë.

Përgatitja e hapësirës

Para ardhjes:

- kontrollohen fusha dhe pajisjet;
- shënohen zonat fillestare, të punës dhe të cakut;
- lihen shtigje të gjera dhe të sigurta;
- topat vendosen në vend të qasshëm;
- orari vizual vendoset në lartësi të dukshme;
- këndi i përshtatur vendoset afër, por jashtë zonës së lojës;
- dakordohen rolet e të rriturve;
- përgatiten variante alternative të detyrave.

Orari vizual

Përshëndetje → Lëvizje → Punë në çift → Detyrë ekipore → Minilojë → Qetësim → Reflektim

1. Ardhja dhe orientimi – 5 minuta

Pjesëmarrësit:

- e shohin hapësirën;
- zgjedhin shenjën fillestare;
- shohin orarin vizual;
- njihen me sinjalet „fillo“, „ndalo“, „pushim“ dhe „mbarova“;
- zgjedhin topin ose vendosin të fillojnë pa top.

Drejtuesi i seancës thotë shkurt:

„Sot do të zgjedhim, do të punojmë në çifte dhe do të krijojmë një gol të përbashkët. Mund të kërkoni ndihmë, ndryshim ose pushim në çdo çast.“

Çfarë vëzhgohet?

- Kush orientohet në mënyrë të pavarur?
- Kujt i duhet mbështetje vizuale ose nga bashkëmoshatarët?
- A shfaq dikush shqetësim për shkak të hapësirës, zhurmës ose pajisjeve?

2. Përshëndetja dhe misioni ekipor – 5 minuta

Grupi përdor përshëndetjen e dakorduar ekipore.

Pastaj zgjidhet një mision i përbashkët nga Pasaporta:

„Do të kontrollojmë nëse secili anëtar ka pasur mundësi të kontribuojë.“

Misioni shpjegohet me një shembull të shkurtër pozitiv dhe një shembull që duhet shmangur.

Kartelat e komunikimit

- radha ime;
- radha jote;
- jam gati;
- prit;
- më ndihmo;
- pushim.

3. Përgatitja: „Lëviz – ndalo – zgjidh“ – 7 minuta

Pjesëmarrësit lëvizin në hapësirën e shënuar.

Me sinjalin „ndalo“ zgjedhin:

- qëndro në vend;
- ndrysho drejtimin;
- lëviz drejt ngjyrës ose simbolit të shënuar;
- vazhdo vetë ose me partnerin.

Në raundin tjetër mund të përfshihet topi.

Përshtatjet

- ecje në vend të vrapimit;
- kohë shtesë për reagim;
- sinjal vizual në vend të sinjalit zanor;
- hapësirë më e vogël;
- lëvizje me partnerin;
- top në duar ose pa top;
- pozicion i qëndrueshëm dhe drejtim i topit nga vendi.

Treguesi i suksesit

Pjesëmarrësi e njeh sinjalin, bën zgjedhje dhe e përshtat lëvizjen në mënyrë të sigurt.

4. Punë në çift: „Pasimi i besimit“ – 8 minuta

Secili çift zgjedh:

- topin;
- distancën;
- mënyrën e pasimit;
- sinjalin e gatishmërisë.

Renditja vizuale është:

Shiko → Prit sinjalin → Paso → Prano → Përsërit

Pas disa provave partnerët vendosin nëse do të ndryshojnë diçka.

Detyrë për bashkëmoshatarët

- pyet përpara se të ndihmosh;
- prit përgjigjen;
- përshtate pasimin;
- thuaj çfarë të përshtatet.

Ndryshime të mundshme

- top më i madh ose më i butë;
- distancë më e shkurtër;
- caku më i gjerë;
- pasim me duar;
- pozicion ulur i qëndrueshëm;
- më shumë kohë;
- demonstrim nga bashkëmoshatari.

5. Detyrë ekipore: „Tri kartela – një marrëveshje“ – 8 minuta

Ekipet me tre ose katër pjesëmarrës zgjedhin tri kartela:

- paso;
- lëviz;
- prit;
- zgjidh drejtimin;
- gjuaj;
- përsërit.

Prej tyre krijojnë një aksion të shkurtër. Secili anëtar merr rol të rëndësishëm.

Pas provës ekipi përgjigjet:

- A mori pjesë secili?
- A ishte e kuptueshme renditja?
- Çfarë duhet të ndryshojmë?

Pastaj e përsërit aksionin e përshtatur.

6. Minilojë: „Secili kontribuon“ – 8 minuta

Luhet tre kundër tre ose katër kundër katër, në raunde të shkurtra.

Rregullat

- secili ekip krijon mundësi që anëtarë të ndryshëm të kontribuojnë;
- pasimi kryhet pas sinjalit të gatishmërisë;
- nuk ka eliminim;
- pushimi është i qasshëm;
- rolet dhe zëvendësimet janë të parashikueshme;
- kontakti fizik jo i sigurt ndërpritet menjëherë.

Goli pranohet sipas rregullave bazë, ndërsa pas raundit ekipi merr një vlerësim të shkurtër për bashkëpunimin.

Përshtatje të mundshme

- portë më e gjerë;
- zonë e mbrojtur për pranimin e topit;
- top më i madh ose më i butë;
- kufizim i numrit të lojtarëve që ushtrojnë presion njëkohësisht;
- kohë shtesë për vazhdim;
- zonë alternative e cakut;
- sinjal vizual për ndërprerje.

7. Qetësimi dhe reflektimi – 4 minuta

Pjesëmarrësit zgjedhin një kartelë:

- më pëlqeu;
- ishte e vështirë për mua;
- më ndihmoi;
- ndihmova;
- dua përsëri;
- herën tjetër dua ndryshe

Në Pasaportë mund të shënohet misioni i sotëm ekipor me një shembull konkret.

Pjesëmarrësi mund të përgjigjet me fjalë, gjest, simbol ose ta tregojë individualisht kartelën e zgjedhur.

Vlerësim i shkurtër i Modelit A

Pas seancës ekipi kontrollon:

- A bëri secili një zgjedhje?
- A ishin kartelat të qasshme dhe funksionale?
- A e respektuan partnerët sinjalin e gatishmërisë?
- A mbeti ndonjë pjesëmarrës pa rol të rëndësishëm?
- A mundësoi pushimi rikthimin në aktivitet?
- Cila përshtatje duhet të ruhet?

Modeli B: „Ekipi që e përshtat lojën“

Qëllimi kryesor:

Zhvillimi i kontrollit të topit, strategjisë ekipore dhe vendimmarrjes.

Qëllimet gjithëpërfshirëse:

- • pjesëmarrësit të dallojnë një pengesë;
- të propozojnë së bashku një përshtatje;
- të ndërrojnë rolet;
- të zbatojnë ndryshimin e zgjedhur;
- të vlerësojnë ndikimin te pjesëmarrja.

Mosha orientuese:
Nga 11 vjeç e lart.

Numri i pjesëmarrësve:
Nga 10 deri në 20.

Kohëzgjatja:
Rreth 60 minuta.

Pajisjet e nevojshme:

- topa të ndryshëm;
- porta ose caqet e shënuara ;
- kone dhe vija;
- kartela „hapësira“, „detyra“, „rregullat“, „pajisjet“ dhe „mbështetja“;
- kartelat e komunikimit në futboll;
- pasaportat për mbështetjen nga bashkëmoshatarët;
- këndi i përshtatur;
- orar vizual.

1. Kontrolli fillestar dhe marrëveshja – 7 minuta

Pjesëmarrësit shohin orarin dhe zgjedhin mënyrën e përshëndetjes.

Përsëriten rregullat:

- κkomunikojmë me respekt;
- pyesim përpara se të ndihmojmë;
- respektojmë sinjalin „ndalo“;
- secili mund të kërkojë pushim;
- e ndryshojmë së bashku lojën kur dikush nuk ka mundësi të marrë pjesë.

Misioni ekipor është:

„Në vend që ta fajësojmë lojtarin, do ta përmirësojmë lojën.“

2. Ngrohja me zgjedhje shtegu – 8 minuta

Vendosen tri shtigje me gjatësi, gjerësi dhe numër të ndryshëm ndryshimesh të drejtimit

Pjesëmarrësit zgjedhin:

- shtegun;
- topin;
- ritmin;
- lëvizjen vetë ose me partnerin.

Pas provës së parë përgjigjen:

- A më përshtatej shtegu?

• A dua ndryshim?
• A më duhej mbështetje?

3. Stacione teknike – 15 minuta

Vendosen tri stacione.

Stacioni 1: Kontrolli
Ndalimi dhe drejtimi i topit.

Stacioni 2: Pasimi
Pasim përmes portës me zgjedhjen e gjerësisë dhe distancës.

Stacioni 3: Përfundimi
Drejtimi i topit drejt cakut të zgjedhur.

Në secilin stacion ofrohen të paktën dy variante. Pjesëmarrësit nuk ndahen sipas nivelit të vlerësuar; ata zgjedhin variantin fillestar dhe mund ta ndryshojnë.

Roli i ekipit

- një person demonstron detyrën;
- një ndjek renditjen;
- një përgatit topin;
- një propozon përshtatjen;
- rolet ndërrohen.

4. Detyrë bashkëpunuese: „Përmirësoje lojën“ – 10 minuta

Ekipi fillon me detyrën e pasimit dhe lëvizjes.

Pas dy minutash aktiviteti ndërpritet dhe secili zgjedh një vlerësim:

mora pjesë plotësisht;
- mora pjesë pjesërisht;
- nuk pata mundësi të mjaftueshme;
- më duhet ndryshim.

Ekipi zgjedh një element::

- hapësirën;
- detyrën;
- rregullin;
- pajisjen;
- mbështetjen.

Bën një ndryshim dhe e realizon sërish detyrën..

Pyetja kryesore

„Çfarë ndryshoi në pjesëmarrje dhe jo vetëm në rezultat?“

5. Minindeshje gjithëpërfshirëse: „Dy caqe– më shumë strategji“ – 15 minuta

Secili ekip mund të fitojë pikë:

- me gol;
- me pasim të kontrolluar në zonën e cakut.

Ekipet zgjedhin strategjinë dhe e ndryshojnë gjatë lojës.

Rregulla shtesë

- raunde të shkurtra e të parashikueshme;
- rotacion i roleve;
- sinjal vizual për fillim dhe ndalim;
- e drejta e ekipit për ndërprerje të shkurtër për marrëveshje;
- e drejta për pushim individual;
- ndalim i fjalëve poshtëruese dhe kontaktit jo të sigurt.

Pas çdo raundi ekipi ka një minutë për t›u marrë vesh::

- Çfarë funksionon?
- Kush nuk pati mundësi të mjaftueshme?
- Çfarë ndryshimi do të bëjmë?

6. Qetësimi dhe reflektimi ekipor – 5 minuta

Secili pjesëmarrës zgjedh njërën nga tri pyetjet::

- Çfarë kontribuova?
- Çfarë më ndihmoi?
- Çfarë duhet të ndryshojmë?

Ekipi shënon një vendim të përbashkët për seancën e ardhshme.

Tregues të mundshëm të ndjekjes

Tabela 19. Tregues për zbatimin e aktiviteteve në mjedisin shkollor

Fusha	Treguesi
Pjesëmarrja	Secili kishte rol të rëndësishëm
Zgjedhja	Pjesëmarrësit zgjodhën pajisje, rol ose nivel
Komunikimi	Mesazhet u kuptuan dhe morën përgjigje
Bashkëpunimi	Vendimet nuk i morën gjithmonë të njëjtët persona
Vetërregullimi	Pushimi ishte i qasshëm dhe u respektua
Pavarësia	Mbështetja nuk e tejkaloi atë që nevojitej
Përkatësia	Kontributi i secilit anëtar u njoh
Siguria	Rreziqet dhe sjelljet e papërshtatshme u trajtuan në kohë
Zhvillimi	U vu re përparim individual ose ekipor

Nëse seanca duhet shkurtuar

Kur koha është e kufizuar, duhen ruajtur::

- orientimi i shkurtër;
- një aktivitet përgatitor;
- një aktivitet për aftësi futbolli;
- një lojë ekipore;
- reflektimi i shkurtër.

Nuk duhet të hiqen orientimi dhe reflektimi vetëm për të lënë më shumë kohë për lojën. Pikërisht ato sigurojnë ndjenjë sigurie, zgjedhje dhe të nxënit nga përvoja.

Nëse grupi është më i madh

Për të zvogëluar pritjen dhe mbingarkesën:

- formohen grupe më të vogla;
- vendosen stacione paralele;
- sigurohen më shumë pajisje;
- përdoren shenja të qarta vizuale;
- yrolet e të rriturve ndahen paraprakisht;
- paralajmërohet kalimi nga një stacion në tjetrin;
- nuk jepen njëkohësisht udhëzime të ndryshme gojore.

Nëse aktivitetin e drejton vetëm një person

Duhet:

- дtë zvogëlohet numri i stacioneve;
- të zgjidhen detyra të thjeshta e të njohura;
- hapësira të jetë kompakte dhe lehtësisht e mbikëqyrshme;
- udhëzimet vizuale të vendosen paraprakisht;
- të shmangen rotacionet e ndërlikuara;
- këndi i përshtatur të jetë brenda fushës së shikimit;
- të mos pranohet numër pjesëmarrësish që tejkalon mbikëqyrjen e sigurt.

Mesazhi kryesor: Seanca e plotë gjithëpërfshirëse ka rrjedhë të qartë, por nuk është e ngurtë. Cilësia e saj shihet te aftësia për të lidhur sfidën sportive, zgjedhjen, komunikimin, bashkëpunimin, pushimin dhe zërin e pjesëmarrësve në një përvojë të përbashkët.

4.11. Zbatimi në mjedisin shkollor

Shkolla është mjedis veçanërisht i rëndësishëm për sportin gjithëpërfshirës, sepse mundëson vazhdimësi, lidhje me qëllimet arsimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi dhe përvoja të ndryshme.

Mjetet dhe aktivitetet e „Touch the Goal“ mund të zbatohen:

- në orët e arsimit fizik dhe shëndetësor;
- në mësimin në klasë;
- në aktivitetet jashtëmësimore dhe të lira të nxënësve;
- gjatë pushimit aktiv;
- në seksionet sportive shkollore;
- në ditë sportive dhe turne;
- në veprimtaritë e bashkësisë së nxënësve;
- në programet e qendrave mbështetëse;
- në aktivitetet e përbashkëta me familjet dhe komunitetin lokal.

Qëllimi nuk është krijimi i një programi të veçantë futbolli vetëm për nxënës të caktuar. Duhet që aktivitetet ekzistuese shkollore të bëhen më të kuptueshme, më të qasshme dhe më fleksibile.

Lidhja me qëllimet arsimore

Aktiviteti gjithëpërfshirës i futbollit mund të mbështesë njëkohësisht:

- zhvillimin fizik dhe motorik;
- komunikimin dhe shprehjen gjuhësore;
- aftësitë shoqërore dhe emocionale;
- pavarësinë dhe vendimmarrjen;
- ndjekjen e rregullave dhe renditjes;
- orientimin në hapësirë dhe kohë;
- konceptet matematikore, numërimin dhe krahasimin;
- zgjidhjen e problemeve;
- përgjegjësinë dhe lojën e ndershme;
- respektimin e dallimeve;
- ndjenjën e përkatësisë në klasë dhe shkollë.

Aktiviteti duhet të mbetet përvojë sportive të rëndësishme, por potenciali i tij arsimor mund të planifikohet dhe të ndiqet me vetëdije.

Zbatimi në orën e arsimit fizik dhe shëndetësor

Në orë duhet planifikuar një qëllim i përbashkët me disa mënyra pjesëmarrjeje.

Përpara orës

Mësimdhënësi dhe profesionistët e përfshirë duhet të përcaktojnë:

- cili është qëllimi kryesor mësimor;
- cilat aftësi i kanë tashmë nxënësit;
- cilat pengesa mund të shfaqen;
- cilat përshtatje do të jenë në dispozicion;
- si do të organizohen grupet;
- si do të jepen udhëzimet;
- cilat mjete të „Touch the Goal“ do të përdoren;
- si do të bëjnë zgjedhje nxënësit;
- si do të sigurohen pushimi dhe siguria;
- çfarë do të vëzhgohet dhe dokumentohet.

Nuk është e nevojshme që çdo orë të ketë përgatitje të ndërlikuar individuale. Kur planifikohen paraprakisht disa mënyra pjesëmarrjeje, një pjesë e madhe e nevojave përfshihet brenda organizimit të përbashkët.

Gjatë orës

Është e dobishme:

- orari vizual të vendoset para fillimit;
- detyra të shpjegohet dhe demonstrohet;
- nxënësit të kenë mundësi prove;
- pajisjet të jenë në dispozicion për zgjedhje;
- grupet të jenë të vogla;
- koha e pritjes të jetë e shkurtër;
- rolet të ndërrohen;
- mbështetja të jetë pa imponim;
- përshtatjet të bëhen gjatë aktivitetit;
- secili nxënës të marrë informacion kthyes konkret.

Pas orës

Mësimdhënësi mund të shënojë:

- shkallën e pjesëmarrjes;
- mbështetjen që ishte e suksesshme;
- pengesën që mbeti;
- mënyrën si komunikoi dhe bashkëpunoi nxënësi;
- nëse shfaqi përparim;
- çfarë duhet ruajtur apo ndryshuar herën tjetër.

Pjesëmarrje në vend të lirimit automatik

Kur nxënësi nuk mund ta realizojë aktivitetin në mënyrën e zakonshme, hapi i parë nuk duhet të jetë lirimi i tij nga aktiviteti ose lënia mënjanë.

Fillimisht duhet kontrolluar nëse mund të përshtaten:

- qëllimi;
- hapësira;
- detyra;
- rregullat;
- pajisjet;
- kohëzgjatja;
- mënyra e komunikimit;
- forma e mbështetjes;
- roli i nxënësit.

Nëse për arsye shëndetësore ose sigurie një lëvizje e caktuar nuk është e përshtatshme, nxënësit duhet t›i jepet një aktivitet tjetër të rëndësishëm dhe i lidhur me temën, jo të kalojë orën në mënyrë pasive.

Roli alternativ nuk duhet të jetë gjithmonë numërimi i rezultatit ose mbledhja e mjeteve. Kur është e mundur, nxënësi duhet të ketë mundësi për pjesëmarrje fizike dhe sportive në përputhje me aftësitë e tij.

Lidhja me qëllimet individuale arsimore

Kur nxënësi mëson sipas një programi të individualizuar ose të modifikuar, aktivitetet e futbollit mund të lidhen me qëllimet e tij arsimore dhe zhvillimore.

Për shembull:

Tabela 20. Lidhja e qëllimeve individuale me aktivitetet e futbollit

Qëllimi individual	Zbatimi në aktivitet futbolli
Ndjekja e një udhëzimi me dy hapa	„Merre topin dhe qëndro te koni blu“
Bërja e zgjedhjes	Zgjedhja e topit, partnerit, shtegut ose rolit
Komunikimi funksional	Kërkimi i ndihmës, pushimit ose përsëritjes
Pritja e radhës	Punë në çift ose grup të vogël
Orientimi në hapësirë	Lëvizja ndërmjet zonave të shënuara
Koordinimi	Ndalimi, drejtimi dhe kontrolli i topit në lëvizje
Ndërveprimi me bashkëmoshatarët	Detyrë e përbashkët ose mision ekipor
Vetërregullimi	Njohja e nevojës për pushim dhe rikthimi
Pavarësia	Zgjedhja e pavarur dhe përdorimi i mbështetjes vizuale

Qëllimi individual duhet të realizohet brenda aktivitetit të përbashkët sa herë që është e mundur.

Roli i mësimdhënësit dhe ekipit mbështetës

Mësimdhënësi mbetet përgjegjës për planifikimin, drejtimin dhe vlerësimin e orës. Profesionistët e tjerë kontribuojnë me ekspertizën e tyre, por nuk e marrin përsipër mësimdhënien në vend të tij.

Mësimdhënësi:

- përcakton qëllimin mësimor;
- drejton gjithë grupin;
- organizon hapësirën dhe aktivitetet;
- siguron disa mënyra pjesëmarrjeje;
- ndjek përparimin;
- jep informacion kthyes;
- bashkëpunon me ekipin gjithëpërfshirës të shkollës..

Edukatori special dhe rehablitatori:

- ndihmon në identifikimin e pengesave;
- propozon përshtatje funksionale;
- përgatit ose zgjedh mbështetjen vizuale;
- kontribuon në ndjekjen e pjesëmarrjes;
- mbështet lidhjen me qëllimet individuale;
- forcon kapacitetet e mësimdhënësit dhe ekipit.

Asistenti arsimor:

- mbështet zbatimin e strategjive të dakorduara;
- ndihmon nxënësin të kuptojë udhëzimin;
- e drejton te mbështetja vizuale;
- lehtëson komunikimin me bashkëmoshatarët;
- ofron ndihmë vetëm kur nevojitet;
- e zvogëlon gradualisht mbështetjen e drejtpërdrejtë.

Asistenti nuk duhet ta veçojë nxënësin dhe të realizojë paralelisht një aktivitet krejt tjetër, përveç rasteve kur kjo është e arsyetuar profesionalisht, e planifikuar dhe e përkohshme.

Zbatimi në klasë

Mjetet mund të përdoren edhe jashtë sallës sportive.

Kartelat e komunikimit në futboll mund të ndihmojnë për:

- ndjekjen e renditjes;
- bërjen e zgjedhjes;
- punën në grup;
- kërkimin e ndihmës;
- shprehjen e ndjenjave;
- sinjalizimin e pushimit;
- dhënien e informacionit kthyes.

Pasaporta për mbështetjen nga bashkëmoshatarët mund të përdoret për:

- punë në çifte;
- projekte në grup;
- nisma të nxënësve;
- aktivitete kundër dhunës mes bashkëmoshatarëve;
- ndërtimin e komunitetit të klasës;
- udhëheqjen nga nxënësit.

Këndi i përshtatur mund të përdoret për:

- pushim të shkurtër;
- vetërregullim;
- komunikim të qasshëm;
- përgatitje për kalimin ndërmjet aktiviteteve;
- rikthim të sigurt në mësim.

Përdorimi i mjeteve në situata të ndryshme shkollore ndihmon që nxënësit t›i zbatojnë aftësitë e mësuara edhe jashtë aktiviteteve të futbollit.

Pushimi aktiv

Gjatë pushimit aktiv aktivitetet duhet të jenë të thjeshta, vullnetare dhe të lehta për t›u mbikëqyrur.

Mund të organizohen:

- pasime të shkurtra me partnerin;
- shtigje me zgjedhje;
- caqe futbolli pa renditje sipas rezultatit;
- sfida bashkëpunuese;
- misione ekipore nga Pasaporta;
- zona të shënuara vizualisht për intensitete të ndryshme.

Nuk duhet që çdo pushim të strukturohet nga të rriturit. Duhet lënë hapësirë për lojë spontane, por edhe të sigurohen mundësi të qasshme për nxënësit që e kanë të vështirë të përfshihen pa mbështetje.

Seksioni sportiv shkollor

Në seksion mund të sigurohet zbatim afatgjatë përmes:

- orarit të rregullt vizual;
- zhvillimit gradual të aftësive;
- ndryshimit të misioneve ekipore;
- mbajtjes së Pasaportës për mbështetjen nga bashkëmoshatarët;
- minindeshje periodike;
- pjesëmarrje të nxënësve në planifikim;
- ndjekje të përparimit individual dhe ekipor;
- lidhje me klasa e shkolla të tjera.

Seksioni nuk duhet të jetë në dispozicion vetëm për nxënësit që tashmë kanë zhvilluar aftësi futbolli. Kriteret e pjesëmarrjes duhet të mundësojnë nivele fillestare dhe forma kontributi të ndryshme.

Ditët sportive dhe turnetë shkollore

Për ngjarje më të mëdha nevojitet planifikim shtesë:

- hyrje dhe shtigje të qasshme;
- sinjalistikë e qartë;
- program vizual;
- grupe më të vogla;
- raunde të shkurtra;
- vend për pushim;
- tualete dhe ujë në dispozicion;
- numër i mjaftueshëm të rriturish përgjegjës;
- mbështetje mjekësore dhe sigurie;
- pëlqim për fotografim dhe incizim;
- mënyrë për raportimin e shqetësimeve;
- plan rezervë në rast moti të keq.

Shpërblimet dhe mirënjohjet publike duhet t›i paraqesin të gjithë pjesëmarrësit me dinjitet. Fëmijët me aftësi të kufizuara nuk duhet të paraqiten si frymëzim vetëm sepse morën pjesë.

Ndjekja dhe vlerësimi

Në mjedisin shkollor nuk duhet të vlerësohet vetëm realizimi teknik. Mund të ndiqen

- përparimi individual;
- kuptimi i detyrës;
- përpjekja e bërë;
- zbatimi i aftësisë;
- pavarësia;
- komunikimi;
- bashkëpunimi;
- respektimi i rregullave;
- sjellja e sigurt;
- aftësia për reflektim.

Kriteret duhet të jenë të qarta, të shpjeguara paraprakisht dhe të përshtatura me qëllimet arsimore dhe nevojat e nxënësit.

Distanca e zvogëluar, pajisjet e ndryshme ose koha shtesë nuk duhet të nënkuptojnë automatikisht vlerësim më të ulët. Vlerësohet arritja e qëllimit të përcaktuar, jo njëjtësia e kushteve.

Përfshirja e nxënësve në planifikim

Zëri i nxënësit mund të përfshihet përmes:

- zgjedhjes së aktiviteteve;
- propozimit të rregullave ekipore;
- krijimit të kartelave të reja;
- zgjedhjes së misionit për bashkëmoshatarët;
- propozimit të përshtatjeve;
- pjesëmarrjes në vlerësim;
- organizimit të një minieventi shkollor;
- përgatitjes së mesazheve për sportin gjithëpërfshirës.

Pjesëmarrja në planifikim nuk do të thotë që nxënësit të marrin përgjegjësinë e të rriturve për sigurinë dhe organizimin. Ata marrin zë real në çështjet që formësojnë përvojën e tyre.

Model i shkurtër për orën shkollore

Tabela 21. Shembull i strukturës së një ore shkollore

Faza	Koha	Shembulli
Orientimi	3–5 min.	Orari vizual dhe rregullat
Ngrohja	5–7 min.	Lëvizje me zgjedhje
Zhvillimi i aftësisë	10–15 min.	Pasim ose drejtim topi në disa variante
Detyrë ekipore	8–10 min.	Lojë bashkëpunuese
Minilojë	8–12 min.	Lojë e shkurtër me rregulla të përshtatura
Qetësimi	3–5 min.	Frymëmarrje, shtrirje ose pasime të qeta
Reflektimi	3–5 min.	Kartela dhe vlerësim i shkurtër

Modeli përshtatet sipas kohëzgjatjes së orës shkollore dhe kushteve.

Kontroll praktik për shkollën

- A ka secili nxënës qasje në aktivitetin e përbashkët?
- A shmanget lirimi automatik nga ora?
- A janë të lidhura qëllimi mësimor dhe ai gjithëpërfshirës?
- A janë planifikuar paraprakisht përshtatjet?
- A kanë mësimdhënësi dhe ekipi role të qarta?
- A e rrit mbështetja pavarësinë?
- A bashkëpunojnë bashkëmoshatarët pa marrë përgjegjësitë e të rriturve?
- A është përfshirë zëri i nxënësve?
- A vlerësohet përparimi në mënyrë të drejtë?
- A është aktiviteti i sigurt, dinjitoz dhe i lidhur me ndjenjën e përkatësisë?

Mesazhi kryesor: *Në mjedisin shkollor futbolli gjithëpërfshirës nuk është aktivitet i ndarë për një numër të vogël nxënësish. Është qasje përmes së cilës ora, pushimi, seksioni ose ngjarja sportive e përbashkët bëhen hapësirë për të nxënë, zgjedhur, bashkëpunuar dhe ndier përkatësi për të gjithë.*

4.12. Zbatimi në shkollat e futbollit dhe klubet sportive

Kontakti i parë me fëmijën dhe familjen

Kur fëmija ka nevojë për mbështetje shtesë për t'u përfshirë në aktivitetet e futbollit, një bisedë e shkurtër me të dhe familjen mund ta ndihmojë trajnerin të zgjedhë fillimin e duhur. Është e dobishme të dihet çfarë e intereson fëmijën, çfarë i pëlqen të bëjë tashmë me topin, si i kupton më lehtë udhëzimet dhe si tregon se ka nevojë për ndihmë ose pushim. Sipas nevojës, takimi i parë mund të përfshijë njohjen me hapësirën, trajnerin dhe disa pajisje.

Biseda mund të drejtohet me disa pyetje të thjeshta:

- Cilat aktivitete i duken interesante fëmijës?
- Çfarë e ndihmon të kuptojë një detyrë të re dhe të ndihet i sigurt?
- Si e bën më lehtë zgjedhjen ose kërkon mbështetje?
- A i përshtatet pjesëmarrja më e shkurtër ose përfshirja graduale në grup?

Informacionet e nevojshme shëndetësore dhe të sigurisë mund të ndahen në mënyrë konfidenciale, vetëm aq sa është e rëndësishme për pjesëmarrjen. Vërejtjet e familjes plotësohen me njohjen e drejtpërdrejtë të fëmijës gjatë aktivitetit.

Mundësitë e zbatimit në grupe të ndryshme

Përvojat nga zbatimi pilot i „Touch the Goal" mund të shërbejnë si mbështetje praktike për shkollat e futbollit dhe klubet sportive. Trajneri mund të përdorë udhëzime, shembuj dhe mjete të veçanta sipas programit dhe nevojave konkrete të pjesëmarrësve.
Në grupet e fëmijëve me aftësi të kufizuara, doracaku mund të ndihmojë në shpjegimin e detyrave, zhvillimin e aftësive të futbollit, komunikimin dhe bashkëpunimin ekipor. Përshtatjet zgjidhen sipas aftësive dhe interesave individuale, sepse edhe brenda të njëjtit grup nevojat për mbështetje ndryshojnë.
Në grupet ku stërviten së bashku fëmijët me dhe pa aftësi të kufizuara, si edhe gjatë përfshirjes së një fëmije të ri në grupin ekzistues, procedura të caktuara mund të lehtësojnë kuptimin e detyrës, bashkëpunimin me bashkëlojtarët dhe pjesëmarrjen graduale. Ndonjëherë mjafton një ndryshim i vogël: demonstrim i shkurtër, më shumë kohë për përgjigje, distancë më e vogël ose rol i dakorduar qartë.

Mundësi praktike për trajnerin

Udhëzimet e zhvilluara për mësimdhënësit e arsimit fizik dhe shëndetësor në kapitujt 2 dhe 4 mund të përshtaten edhe për stërvitjet në klub. Sipas nevojës, trajneri mund të zgjedhë:

- shpjegim të shkurtër me demonstrim, në vend të disa udhëzimeve njëkohësisht;
- provë të detyrës me një bashkëlojtar para përfshirjes në gjithë grupin;
- përshtatje të distancës, ritmit, pajisjeve ose kohëzgjatjes;
- disa mënyra për arritjen e të njëjtit qëllim futbolli;
- bisedë të shkurtër me fëmijën pas aktivitetit për atë që e ndihmoi dhe që do të donte të përsëriste.

Mjetet si mbështetje shtesë

Kartelat e komunikimit në futboll mund të ndihmojnë në shpjegimin e renditjes, zgjedhjen e aktivitetit ose kërkimin e ndihmës. Kutia mobile gjithëpërfshirëse POP-UP mundëson eksplorimin e pozicioneve dhe aksioneve të futbollit përmes tabelës dhe figurave, individualisht ose në bashkëpunim. Pasaporta për mbështetjen nga bashkëmoshatarët mund të ofrojë mision të thjeshtë ekipor, si ftesa ndaj bashkëlojtarit për lojë ose inkurajimi pas një përpjekjeje.

Kur është e nevojshme dhe kushtet janë të përshtatshme, këndi i përshtatur mund të shërbejë si vend për punë më të qetë me mjetin ose për pushim të shkurtër. Kutia është mjet që mund të përdoret në hapësira të ndryshme; këndi është hapësirë e përshtatur që zgjidhet sipas nevojës së fëmijës dhe kushteve të punës.

Shembull praktik

Një fëmijë që i bashkohet grupit për herë të parë e ka të vështirë të ndjekë disa udhëzime gojore njëri pas tjetrit. Trajneri mund ta demonstrojë ushtrimin me një bashkëlojtar, të përdorë dy kartela për renditjen dhe të mundësojë pasim provë nga një distancë më e shkurtër. Pas disa provave mund të zgjedhë bashkë me fëmijën nëse detyra do të vazhdojë në çift ose në grup të vogël. Qëllimi bazë mbetet pasimi dhe bashkëpunimi, ndërsa mënyra e pjesëmarrjes përshtatet.

Zbatimi mund të fillojë me një procedurë ose një mjet të vetëm. Shkëmbimi i shkurtër me fëmijën, familjen dhe, kur është e nevojshme, me një profesionist, ndihmon të kuptohet çfarë ishte e dobishme dhe çfarë mund të përshtatet në stërvitjen tjetër. Kështu doracaku mbetet burim i qasshëm idesh dhe ndihme praktike për trajnerët që kanë nevojë për të.

4.13. Përshtatja e aktiviteteve në kushte të ndryshme

Aktiviteti gjithëpërfshirës i futbollit nuk varet nga fusha ideale, numri i madh i mjeteve apo hapësira e pajisur posaçërisht. Ai mund të zhvillohet në sallë sportive, klasë, oborr shkolle, klub, park, komunitet lokal ose hapësirë të organizuar përkohësisht.

Cilësia varet nga sa me kujdes aktiviteti përputhet me:

- hapësirën në dispozicion;
- numrin dhe moshën e pjesëmarrësve;
- kushtet e motit;
- pajisjet në dispozicion;
- numrin e të rriturve;
- larminë gjuhësore dhe kulturore;
- nevojat e komunikimit, shqisore dhe motorike;
- kohën në dispozicion;
- kushtet e sigurisë dhe mbrojtjes.

Përshtatja nuk nënkupton uljen e cilësisë. Ajo do të thotë të ruhet qëllimi dhe të krijohet një rrugë tjetër realisht e qasshme për ta arritur.

Kur hapësira është e vogël

Në një sallë të vogël, klasë ose oborr të kufizuar, përparësi duhet t›u jepet aktiviteteve me lëvizje të kontrolluar.

Zgjidhje të dobishme

- punë në çifte ose grupe të vogla;
- stacione me rotacion;
- pasim dhe pritje nga vendi;
- rrokullisje në vend të gjuajtjeve të forta;
- përdorim i topave të butë;
- zona personale të shënuara vizualisht;
- shtigje të shkurtra e të qarta;
- lëvizje me radhë, jo të gjithë njëkohësisht;
- detyra për zgjedhje, komunikim dhe planifikim ekipor;
- distanca më të mëdha sigurie.

Duhet shmangur

- vrapimi i pakontrolluar;
- shumë topa që lëvizin njëkohësisht;
- goditjet e forta;
- shtigjet e ngushta që kryqëzohen;
- radhët e gjata;
- pajisjet afër mureve, dyerve ose dritareve.

Shembull

Në vend të minindeshjes, mund të organizohen tri stacione:

- pasim përmes një porte të gjerë;
- ndalim dhe zgjedhje e drejtimit;
- krijim ekipor i aksionit të futbollit me kartela.

Kur nuk ka fushë standarde futbolli

Nëse aktiviteti zhvillohet në park, oborr ose hapësirë të përbashkët:

- kufijtë duhet të shënohen qartë;
- sipërfaqja duhet kontrolluar;
- të hiqen gurët, mbeturinat dhe rreziqet e tjera;
- portat të zëvendësohen me kone të qëndrueshme ose zona të cakut;
- të sigurohen hyrje dhe dalje të sigurta;
- të kontrollohet lëvizja e personave dhe automjeteve të tjera;
- të caktohet vend për ujë, pajisje dhe pushim;
- të sigurohet mbikëqyrje e dukshme e gjithë grupit.

Pajisjet e improvizuara nuk duhet të krijojnë rrezik shtesë. Objektet e rënda, ndërtimet e paqëndrueshme dhe pjesët metalike të pasiguruara nuk duhet të përdoren si porta.

Kur ka pak pajisje

Mungesa e pajisjeve mund të tejkalohet përmes organizimit që zvogëlon pritjen dhe rrit bashkëpunimin.

Zgjidhje të mundshme

- një top për grup të vogël;
- detyra në çift dhe ekip;
- rotacion ndërmjet stacioneve;
- përdorim i objekteve të buta e të sigurta;
- kartela vizuale të punuara me dorë;
- vija dhe zona të shënuara me shirit;
- kartela detyrash në vend të shumë mjeteve;
- aktivitete pa top për orientim dhe komunikim;
- një cak i përbashkët në vend të shumë portave.

E rëndësishme

Materialet e improvizuara duhet të jenë:

- të pastra;
- të qëndrueshme;
- mjaftueshëm të mëdha që të vërehen;
- pa skaje të mprehta;
- të përshtatshme për moshën;
- të kontrolluara para përdorimit.

Nuk duhet përdorur një objekt i papërshtatshëm vetëm sepse është në dispozicion.

Kur grupi është i madh

Grupi i madh mund të krijojë:

- pritje të gjatë;
- më pak mundësi kontakti me topin;
- zhurmë më të madhe;
- vështirësi në ndjekjen e udhëzimeve;
- rrezik më të madh përplasjesh;
- më pak informacion kthyes individual.

Zgjidhjet e rekomanduara

- ndarje në grupe të vogla e të qëndrueshme;
- stacione paralele;
- aktivitete të shkurtra;
- rotacion vizual të qartë;
- vende pritjeje të shënuara;
- topa të mjaftueshëm ose detyra alternative;
- role të përcaktuara paraprakisht për të rriturit;
- sinjale të dakorduara;
- demonstrim para ndarjes;
- mbështetje nga bashkëmoshatarët me ndërrim partnerësh.

Nëse numri i pjesëmarrësve e tejkalon kapacitetin e mbikëqyrjes së sigurt, aktiviteti duhet të riorganizohet, kufizohet ose të zhvillohet në disa termine.

Kur aktivitetin e drejton vetëm një person

Në këto kushte duhen zgjedhur aktivitete të lehta për mbikëqyrje.

Është e dobishme:

- hapësira të jetë kompakte;
- të ketë më së shumti dy detyra paralele;
- udhëzimet të vendosen vizualisht;
- të përdoren rregulla të njohura;
- kalimet të jenë të rralla dhe të qarta;
- pajisjet të përgatiten paraprakisht;
- këndi i përshtatur të jetë brenda fushës së shikimit;
- pjesëmarrësit të dinë ku dhe si kërkohet ndihma;
- të shmangen aktivitetet me kontakt fizik të ndërlikuar;
- të zvogëlohet numri i pjesëmarrësve nëse siguria nuk mund të garantohet.

Bashkëmoshatarët mund të ndihmojnë në demonstrim dhe organizim, por nuk marrin përgjegjësinë për mbikëqyrjen dhe mbrojtjen.

Kur grupi përfshin mosha të ndryshme

Në grupin me mosha të përziera duhet shmangur që më të rriturit automatikisht të bëhen ndihmës dhe më të vegjlit marrës pasiv të ndihmës.

Mund të zbatohen:

- qëllim i përbashkët me nivele të ndryshme sfide;
- zgjedhje e roleve;
- partneritete sipas interesit, jo vetëm moshës;
- detyra ku përvoja nuk është përparësia e vetme;
- rotacion i roleve drejtuese;
- distanca dhe pajisje të ndryshme;
- mundësi që pjesëmarrësi më i vogël të tregojë një pikë të fortë;
- reflektim i përbashkët në format të qasshëm.

Mënyra e komunikimit, materialet dhe dizajni vizual duhet të jenë dinjitozë dhe të përshtatshëm për moshën e të gjithë pjesëmarrësve.

Kur pjesëmarrësit kanë përvojë të ndryshme në futboll

Nuk është e nevojshme që grupi të ndahet në mënyrë rigoroze në „fillestarë“ dhe „të avancuar“. I njëjti aktivitet mund të ofrojë sfida të ndryshme.

Tabela 22. Nivele të ndryshme mbështetjeje dhe sfide në të njëjtin aktivitet

Aktiviteti bazë	Mbështetje më e madhe	Sfidë shtesë
Pasim te partneri	Distancë më e shkurtër dhe cak më i gjerë	Pasim gjatë lëvizjes
Drejtimi i topit	Shteg i drejtë dhe i gjerë	Ndryshim drejtimi dhe ritmi
Gjuajtje drejt portës	Pozicion më i afërt dhe portë më e madhe	Zgjedhje e zonës së cakut
Aksion ekipor	Më pak hapa	Disa zgjidhje të mundshme
Minilojë	Më shumë kohë për kontrollë	Vendimmarrje e shpejtë

Pjesëmarrësi i avancuar nuk duhet të bëjë vazhdimisht detyrën në vend të të tjerëve. Sfida e tij mund të jetë saktësia më e lartë, vendimi më i ndërlikuar, roli tjetër ose partneriteti cilësor.

Kur përdoren disa gjuhë

Larmia gjuhësore nuk duhet të jetë pengesë për pjesëmarrjen.

Mund të përdoren:

- kartela vizuale;
- demonstrim;
- fjalë kyçe të shkurtra dhe të qëndrueshme;
- simbole dhe ngjyra;
- gjeste;
- orar vizual shumëgjuhësh;
- mbështetje gjuhësore nga bashkëmoshatarët;
- kontroll përmes realizimit praktik;
- kohë e mjaftueshme për të kuptuar dhe përgjigjur.

Nuk duhet supozuar se pjesëmarrësi nuk e kupton aktivitetin vetëm sepse nuk përgjigjet rrjedhshëm në gjuhën e drejtuesit.

Bashkëmoshatari mund të ndihmojë me përkthim, por nuk duhet të mbajë përgjegjësi të përhershme për gjithë komunikimin. Informacionet e rëndësishme për sigurinë dhe pëlqimin duhet të përcillen saktë dhe në mënyrë të kuptueshme.

Kur aktiviteti zhvillohet jashtë

Para fillimit duhet kontrolluar:

- temperatura;
- ekspozimi në diell;
- era;
- shiu dhe lagështia;
- gjendja e sipërfaqes;
- cilësia e ajrit;
- prania e hijes;
- qasja te uji;
- siguria e pajisjeve;
- mundësia për strehim të shpejtë.

Në mot të nxehtë

- aktiviteti planifikohet në pjesën më të freskët të ditës;
- sigurohen pushime më të shpeshta;
- zvogëlohet intensiteti;
- sigurohen ujë dhe hije;
- ndiqen shenjat e mbinxehjes;
- respektohen nevojat individuale shëndetësore.

Në mot të ftohtë ose të lagësht

- kontrollohet sipërfaqja;
- shkurtohet koha e pritjes;
- pjesëmarrësit lëvizin vazhdimisht me intensitet të moderuar;
- sigurohet veshje e përshtatshme;
- aktiviteti ndërpritet nëse kushtet bëhen të pasigurta.

Në ndryshim të papritur të motit

Organizatori duhet të ketë plan rezervë, hapësirë alternative ose procedurë të qartë për ndërprerjen dhe marrjen e sigurt të fëmijëve.

Kur hapësira është e zhurmshme ose me ngarkesë të madhe shqisore

Mund të:

- zëvendësohet fishkëllima me sinjal vizual;
- zvogëlohet numri i aktiviteteve të njëkohshme;
- formohen grupe më të vogla;
- hiqet muzika e panevojshme;
- vendoset këndi i përshtatur larg zhurmës kryesore;
- ofrohen kufje për zvogëlimin e zhurmës;
- përdoret orar vizual i qartë;
- paralajmërohet çdo ndryshim;
- sigurohen pushime të shkurtra;
- shkurtohet kohëzgjatja e seancës.

Nëse pjesëmarrësi duhet të tërhiqet vazhdimisht, nevojitet ndryshimi i mjedisit kryesor, jo vetëm zgjatja e kohës së kaluar në këmbë.

Kur aktiviteti duhet të jetë i shkurtër

Edhe në një seancë prej 20–30 minutash duhen ruajtur elementet bazë.

Shembull i seancës 25-minutëshe

Tabela 23. Struktura e seancës 25-minutëshe

Faza	Koha
Përshëndetja dhe orari vizual	3 min.
Aktiviteti përgatitor	4 min.
Aftësia bazë e futbollit	7 min.
Detyrë ekipore ose minilojë	7 min.
Qetësimi dhe reflektimi	4 min.

Orientimi dhe reflektimi nuk duhet të lihen plotësisht jashtë. Ato ofrojnë parashikueshmëri dhe informacion për planifikimin e ardhshëm.

Kur aktiviteti zhvillohet në komunitet

Në park, fushë publike ose ngjarje në mjedis të hapur duhet planifikuar gjithashtu:

- leja për përdorimin e hapësirës;
- qasja;
- shënimi i zonës;
- lëvizja e vizitorëve;
- mbikëqyrja;
- identifikimi i ekipit;
- vendi i regjistrimit;
- kontaktet me familjet;
- procedura nëse një fëmijë largohet;
- ndihma e parë;
- fotografimi dhe incizimi;
- kushtet e motit;
- mbledhja dhe largimi i sigurt i pjesëmarrësve.

Fëmijët nuk duhet të fotografohen nga vizitorët apo mediat pa pëlqimin e duhur dhe kontrollin organizativ.

Kur nuk mund të bëhen të gjitha përshtatjet

Ndonjëherë nuk është e mundur të hiqen menjëherë të gjitha pengesat. Atëherë ekipi duhet:

- të identifikojë qartë pengesën;
- të vlerësojë rrezikun;
- të bisedojë me pjesëmarrësin dhe familjen;
- të sigurojë zgjidhjen më të përshtatshme të përkohshme;
- të përcaktojë çfarë nevojitet për përmirësim të përhershëm;
- të caktojë personin përgjegjës;
- të përcaktojë afatin e masave;
- të kontrollojë nëse zgjidhja mundësoi vërtet pjesëmarrje.

Zgjidhja e përkohshme nuk duhet të bëhet justifikim i përhershëm për përjashtim.

Matricë për përshtatje të shpejtë

Tabela 24. Përshtatja sipas kushteve dhe rreziqeve

Kushti	Rreziku kryesor	Zgjidhja praktike
Hapësirë e vogël	Përplasje dhe lëvizje e kufizuar	Çifte, topa të butë dhe detyra statike
Grup i madh	Pritje dhe mbikëqyrje e dobët	Grupe të vogla dhe stacione paralele
Pak pajisje	Pasivitet	Detyra bashkëpunuese dhe rotacion
Një drejtues	Mbikëqyrje e pamjaftueshme	Organizim i thjeshtë dhe zonë kompakte
Mosha të ndryshme	Pabarazi në pozita	Zgjedhje dhe rotacion i roleve
Përvojë e ndryshme	Dominim ose dështim	Disa nivele të së njëjtës detyrë
Disa gjuhë	Udhëzime të pakuptuara	Demonstrim, simbole dhe fjalë kyçe
Mjedis i zhurmshëm	Mbingarkesë	Sinjale vizuale dhe më pak stimuj
Aktivitet në mjedis të hapur	Rreziqe nga moti dhe hapësira	Vlerësim, plan rezervë dhe pushime
Kohë e shkurtër	Lënia jashtë e fazave të rëndësishme	Rrjedhë e shkurtër, por e plotë e seancës

Kontrolli përfundimtar

Para realizimit duhet të marrin përgjigje këto pyetje:

- Cilat janë kushtet reale dhe jo ato të dëshiruara?
- Cilat pengesa mund të hiqen paraprakisht?
- Çfarë është e domosdoshme për sigurinë?
- Cilat materiale mund të zëvendësohen në mënyrë të sigurt?
- Si do të zvogëlohet pritja?
- Si do të sigurohet komunikimi i qasshëm?
- A ekzistojnë disa mënyra pjesëmarrjeje?
- Si do të kërkojnë pjesëmarrësit ndihmë ose pushim?
- Cili është plani rezervë?
- Çfarë duhet të përmirësohet afatgjatë?

Mesazhi kryesor: *Praktika gjithëpërfshirëse nuk pret kushte ideale, por nuk e sakrifikon kurrë sigurinë dhe dinjitetin. Ajo e ruan qëllimin, i vlerëson realisht rrethanat dhe krijon rrugën më të mirë të mundshme të pjesëmarrjes me burimet në dispozicion.*

Përfundime dhe udhëzime për zbatimin praktik

Nga aktiviteti te përvoja cilësore gjithëpërfshirëse

Modelet praktike të këtij kapitulli tregojnë se një aktivitet nuk bëhet gjithëpërfshirës vetëm sepse marrin pjesë fëmijë me aftësi të ndryshme. Gjithëpërfshirja varet nga mënyra si përcaktohet qëllimi, organizohet hapësira, ofrohen zgjedhjet, ndahen rolet dhe nëse secili ka mundësi reale të kontribuojë.

Nuk ekziston një aktivitet i vetëm i përshtatshëm për të gjitha grupet dhe kushtet. Prandaj vlera profesionale e doracakut nuk qëndron te përsëritja fjalë për fjalë e shembujve, por te aftësia për t›i zgjedhur, përshtatur dhe përmirësuar me kujdes.

Gjashtë elementet e aktivitetit gjithëpërfshirës

Përpara, gjatë dhe pas aktivitetit duhen kontrolluar:

Tabela 25. Pyetjet kryesore për aktivitetin gjithëpërfshirës

Elementi	Pyetja kryesore
Qëllimi	A është i qartë dhe i arritshëm në disa mënyra?
Hapësira	A mundet secili të hyjë, orientohet dhe lëvizë në mënyrë të sigurt?
Detyra	A është e kuptueshme, të rëndësishme dhe me sfidë të përshtatshme?
Rregullat	A krijojnë rregullat mundësi të drejta për pjesëmarrje?
Pajisjet	A janë pajisjet të sigurta, të qasshme dhe funksionale?
Mbështetja	A e rrit mbështetja pavarësinë dhe lidhjen me ekipin?

Para aktivitetit: përgatit

Para fillimit duhet:

- të përcaktohet qëllimi sportiv dhe gjithëpërfshirës;
- të njihen pjesëmarrësit dhe nevojat e tyre;
- të kontrollohen hapësira dhe pajisjet;
- të parashikohen pengesat e mundshme;
- të përgatiten të paktën dy mënyra realizimi;
- të zgjidhen mjetet e nevojshme;
- të sigurohet mënyrë e qasshme komunikimi;
- të caktohet hapësirë për pushim;
- të dakordohen rolet e të rriturve;
- të përcaktohet çfarë do të vëzhgohet.

Gjatë aktivitetit: vëzhgo dhe përshtat

Gjatë realizimit duhet ndjekur:

- kush fillon pa vështirësi;
- kush pret gjatë;
- kush nuk e kupton detyrën;
- kush nuk merr top ose rol të rëndësishëm;
- kush varet vazhdimisht nga një i rritur;
- kush mbingarkohet;
- cilat rregulla e lehtësojnë apo vështirësojnë lojën;
- si komunikojnë bashkëmoshatarët;
- nëse përshtatja jep rezultat;
- çfarë tregojnë dhe thonë vetë pjesëmarrësit.

Ndryshimi i nevojshëm duhet të bëhet në kohë, jo vetëm pas përfundimit të aktivitetit.

Pas aktivitetit: dëgjo dhe përmirëso

Pas përfundimit duhen mbledhur tre lloje informacionesh:

1. Përvoja e pjesëmarrësit

- Çfarë i pëlqeu?
- Çfarë ishte e vështirë për të?
- Çfarë e ndihmoi?
- A pati zgjedhje?
- A u ndie pjesë e ekipit?
- Çfarë dëshiron të jetë ndryshe herën tjetër?

2. Vëzhgimi i ekipit

- A mori pjesë secili?
- Cilat pengesa u shfaqën?
- Cila përshtatje ishte e suksesshme?
- A ishte e përshtatshme mbështetja?
- A ishte aktiviteti i sigurt?
- Çfarë duhet ndryshuar?

3. Përparimi i dukshëm

- pavarësi më e madhe;
- kuptim më i mirë;
- komunikim më i qartë;
- lidhje më të forta me bashkëmoshatarët;
- kontroll më i mirë i topit;
- pjesëmarrje aktive më e gjatë;
- kërkim i suksesshëm i pushimit/pauzës;
- rikthim më i lehtë;
- siguri dhe motivim i shtuar.

Tetë tregues të cilësisë

Aktiviteti praktik mund të konsiderohet cilësor kur:

- **Secili pjesëmarrës ka qasje në aktivitet.**
- **Secili ka rol të rëndësishëm, jo vetëm formal.**
- **Ka disa rrugë drejt qëllimit të përbashkët.**
- **Komunikimi është i kuptueshëm dhe i dyanshëm.**
- **Mbështetja nuk krijon varësi të panevojshme.**
- **Pushimi dhe rikthimi janë pjesë normale e aktivitetit.**
- **Siguria dhe dinjiteti kanë përparësi ndaj rezultatit.**
- **Mendimi i pjesëmarrësve ndikon në planifikimin e ardhshëm.**

TOUCH THE GOAL - FUTBOLL PËR ÇDO FËMIJË

Kapitulli 5

NGA PRAKTIKA TE ZBATIMI

Udhëzime praktike, përvoja dhe mësime të nxjerra Touch the Goal - Futboll për çdo fëmijë

Hyrje

Qasja „Touch the Goal - Futboll për çdo fëmijë“ synon krijimin e mundësive që secili fëmijë të marrë pjesë në aktivitete futbolli dhe sporti në një mënyrë që merr parasysh interesat, aftësitë, mënyrat e komunikimit dhe nevojat e tij për mbështetje. Vlera e saj praktike shihet nga mënyra se si idetë dhe mjetet zbatohen në kushte reale arsimore e sportive.

Ky kapitull i lidh përvojat nga trajnimet për mësimdhënësit e arsimit fizik dhe shëndetësor, seancat stërvitore dhe aktivitetet e realizuara me rekomandime për zbatimin e ardhshëm. Vend i veçantë i kushtohet zërit të profesionistëve dhe këndvështrimit të nxënësve, sepse përvojat e tyre ndihmojnë të kuptohet çfarë është e dobishme, cilat sfida shfaqen dhe çfarë mund të përmirësohet.

Praktika nuk nënkupton se çdo aktivitet do të zhvillohet pa vështirësi ose se e njëjta zgjidhje do t’i përshtatet të gjithëve. Ajo kërkon planifikim, vëzhgim, dëgjim të pjesëmarrësve dhe gatishmëri për përshtatje. Qëllimi nuk është që të gjithë ta kryejnë detyrën në të njëjtën mënyrë, por që secili të ketë mundësi reale të marrë pjesë, të zgjedhë, të komunikojë dhe të kontribuojë.

5.1. Pilotimi

Pilotimi i „Touch the Goal - Futboll për çdo fëmijë“ mundësoi që qasjet, mjetet dhe njohuritë e fituara gjatë trajnimeve të provohen në kushte reale arsimore e sportive. Përmes aktiviteteve të realizuara të futbollit, profesionistët patën mundësi të shihnin drejtpërdrejt zbatueshmërinë e tyre dhe t›i lidhnin me interesat, aftësitë dhe nevojat për mbështetje të nxënësve.

Qëllimi ishte të identifikoheshin kushtet që nxisin pjesëmarrjen aktive, si dhe sfidat që shfaqen gjatë realizimit. Vëmendje e veçantë iu kushtua kuptimit së udhëzimeve, mënyrave të komunikimit, mundësive për zgjedhje, bashkëpunimit me bashkëmoshatarët dhe rolit të profesionistëve në sigurimin e mbështetjes së përshtatshme.

Përvojat nga pilotimi nxorën në pah nevojën për qasje fleksibil, ku aktivitetet, rregullat, hapësira, pajisjet dhe komunikimi përshtaten sipas situatës konkrete dhe nevojave të pjesëmarrësve. Është e rëndësishme që mbështetja të mos përqëndrohet vetëm te përfshirja në aktivitet, por edhe te nxitja e pavarësisë, sigurisë, bashkëpunimit dhe ndjenjës së përkatësisë së secilit nxënës.

5.2. Nga modeli te praktika: planifikimi dhe realizimi

Realizimi i suksesshëm i aktiviteteve gjithëpërfshirëse të futbollit fillon me qëllim të përcaktuar qartë dhe njohje në kohë të pengesave të mundshme për pjesëmarrje. Mësimdhënësi i arsimit fizik dhe shëndetësor ose trajneri duhet të parashikojë mënyra të ndryshme përfshirjeje, pa i kufizuar paraprakisht mundësitë e nxënësve në bazë të supozimeve.

Përgatitja para aktivitetit

Gjatë planifikimit, ekipi duhet të shqyrtojë pyetjet e mëposhtme:

- A është i qartë qëllimi i aktivitetit dhe a ka secili nxënës mundësi të kontribuojë?
- A janë udhëzimet të shkurtra, të kuptueshme dhe, sipas nevojës, të mbështetura me demonstrim ose mjete vizuale?
- A mundësojnë hapësira dhe pajisjet pjesëmarrje të sigurt dhe mënyra të ndryshme realizimi?
- A janë dakorduar rolet e mësimdhënësit, asistentit arsimor dhe bashkëmoshatarëve?
- A ka nxënësi mundësi të bëjë zgjedhje, të kërkojë ndihmë ose pushim?
- Si do të sigurohet informacioni kthyes nga nxënësit dhe profesionistët e përfshirë?

Gjatë përgatitjes duhen përdorur vetëm informacione që kanë rëndësi për aktivitetin konkret: mënyra e komunikimit, interesat, faktorët motivues dhe mbështetja që i përshtatet nxënësit. Kështu krijohen kushte për pjesëmarrje pa veçim të panevojshëm.

Gjatë aktivitetit

Gjatë realizimit, vëmendja e mësimdhënësit ose trajnerit duhet të përqëndrohet jo vetëm te kryerja e detyrave, por edhe te pjesëmarrja e vërtetë e secilit nxënës. Pritja e gjatë, udhëzimet e paqarta, mundësitë e kufizuara për përfshirje ose mungesa e rolit të rëndësishëm në ekip tregojnë se duhet bërë përshtatje.

Ndonjëherë edhe një ndryshim i vogël mund ta përmirësojë aktivitetin: udhëzim më i shkurtër, demonstrim shtesë, punë në grup më të vogël, më shumë kohë për provë, pajisje të tjera ose sinjal i dakorduar qartë. Çdo përshtatje duhet t›i përgjigjet nevojës konkrete, duke respektuar dinjitetin dhe pavarësinë e nxënësit.

Pas aktivitetit

Shqyrtimi i shkurtër i përbashkët i aktivitetit të realizuar i ndihmon profesionistët të dallojnë qasjet e suksesshme, sfidat e shfaqura dhe ndryshimet që duhen bërë herën tjetër. Veçanërisht e rëndësishme është të dëgjohen përvojat e nxënësve. Ata mund të japin informacion kthyes përmes bisedës, kartelave vizuale, figurave, simboleve ose një mënyre tjetër të qasshme komunikimi.

Informacioni kthyes nuk shërben për të vlerësuar aftësitë e nxënësit, por për të përmirësuar organizimin, aktivitetet dhe mbështetjen. Nëse një strategji nuk jep rezultatin e pritur, duhet rishikuar konteksti i realizimit, në vend që arsyeja t›i atribuohet automatikisht nxënësit.

5.3. Zëri i praktikës: përvoja nga projekti

Përvojat e pjesëmarrësve janë burim i rëndësishëm njohurish për zbatimin praktik të modelit „Touch the Goal - Futboll për çdo fëmijë“. Përmes vëzhgimeve të tyre mund të fitohet një pamje më e gjerë e mënyrës si u realizuan aktivitetet e projektit, e qasjeve dhe përshtatjeve të përdorura, si edhe e përfitimeve dhe sfidave që dolën nga pjesëmarrja e drejtpërdrejtë.

Përvojat e mësimdhënësve të arsimit fizik dhe shëndetësor ndihmojnë të kuptohet si ka ndikuar trajnimi në të menduarit dhe qasjen e tyre ndaj futbollit gjithëpërfshirës, cilat strategji kanë zbatuar dhe me cilat sfida janë përballur gjatë realizimit praktik. Veçanërisht të rëndësishme janë vëzhgimet e tyre mbi përdorshmërinë e njohurive të fituara në praktikën e përditshme mësimore. Përshtatja e rregullave, hapësirës, pajisjeve, kohëzgjatjes dhe mënyrës së dhënies së udhëzimeve krijon më shumë mundësi për pjesëmarrje aktive të të gjithë nxënësve. Njëkohësisht, roli i mësimdhënësit është të dallojë kur nevojitet mbështetje shtesë dhe kur nxënësi mund ta marrë në mënyrë të pavarur rolin e vet në ekip.

Asistentët arsimor kanë rol të rëndësishëm në krijimin e kushteve për pjesëmarrjen e nxënësve që kanë nevojë për mbështetje shtesë. Gjatë aktiviteteve të futbollit, përvojat e tyre mundësojnë të kuptohet më mirë si i ndjekin nxënësit udhëzimet, si komunikojnë me pjesëmarrësit e tjerë, si i pranojnë përshtatjet dhe si zhvillojnë gradualisht pavarësi më të madhe. Këndvështrimi i tyre është i rëndësishëm edhe për bashkëpunimin me mësimdhënësit e arsimit fizik dhe shëndetësor. Planifikimi i përbashkët, dakordimi i roleve dhe shkëmbimi i vërejtjeve para dhe pas aktiviteteve bëjnë që mbështetja të jetë në përputhje me qëllimet e aktivitetit dhe nevojat individuale të nxënësit.

Vend të veçantë zënë këndvështrimet e nxënësve me zhvillim tipik dhe atipik. Përvojat dhe përjetimet e tyre lejojnë që aktivitetet të shihen nga këndvështrimi i atyre për të cilët janë menduar në radhë të parë. Përmes përshtypjeve të tyre mund të kuptohet rëndësia e lojës së përbashkët, bashkëpunimit ekipor, pranimit të ndërsjellë dhe ndjenjës së përkatësisë. Këto përvoja janë tregues të rëndësishëm të mënyrës si sporti mund të krijojë hapësirë ku secili nxënës ka mundësi të marrë pjesë dhe të kontribuojë në aktivitetin e përbashkët.

5.3.1. Përvoja nga trajnimi për mësimdhënësit të arsimit fizik dhe shëndetësor

Trajnimi për mësimdhënësit e arsimit fizik dhe shëndetësor ishte hap i rëndësishëm në përgatitjen për zbatimin e futbollit gjithëpërfshirës në praktikën shkollore. Përmes përmbajtjeve teorike dhe ushtrimeve praktike, pjesëmarrësit patën mundësi të njihen me qasje dhe strategji për përshtatjen e aktiviteteve të futbollit, organizimin e lojës ekipore dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive të të gjithë nxënësve.

Përvojat dhe vëzhgimet e mësimdhënësve që morën pjesë në trajnim ofrojnë njohuri të drejtpërdrejta mbi mënyrën si i përjetuan njohuritë e fituara, cilat aspekte i konsiderojnë veçanërisht të dobishme dhe çfarë rëndësie ka trajnimi për punën e tyre të ardhshme.

Përvojë nga trajnimi - mësimdhënës i arsimit fizik dhe shëndetësor

„Pjesa teorike dhe veçanërisht ajo praktike e trajnimit më dhanë ide të shumta e të larmishme për punën me fëmijë me zhvillim atipik. Përmes aktiviteteve praktike patëm mundësi të njihemi me qasje dhe mënyra të ndryshme të përshtatjes së aktiviteteve sipas nevojave dhe mundësive të secilit fëmijë. Kjo përvojë më ndihmoi të mendoj në mënyrë më krijuese, të kërkoj zgjidhje të reja dhe të kuptoj se me mbështetjen dhe përshtatjet e duhura, çdo fëmijë mund të përfshihet në aktivitete dhe të kontribuojë sipas mundësive të veta.“

Burimi: Pyetësor për vlerësimin e trajnimit (përgjigje anonime)

Përvojë nga trajnimi - mësimdhënës i AFSh-së

„Trajnimi më dha motivim dhe nxitje më të madhe për të qenë më krijuese në punën me fëmijët. Më ndihmoi të mendoj ide dhe mënyra të reja për përshtatjen e aktiviteteve me nevojat dhe mundësitë individuale të secilit fëmijë. Mendoj se qasja krijuese dhe gatishmëria për të provuar zgjidhje të ndryshme janë të rëndësishme për të nxitur interesin e fëmijëve, pjesëmarrjen aktive dhe kënaqësinë nga aktivitetet e përbashkëta.“

Burimi: Pyetësor për vlerësimin e trajnimit (përgjigje anonime)

Përvojë nga trajnimi - mësimdhënës i AFSH-së

„Kartelat e komunikimit vizual dhe ora praktike e arsimit fizik dhe shëndetësor ishin pjesë veçanërisht të dobishme të trajnimit. Kartelat na mundësuan të kuptojmë më mirë si mjetet vizuale i ndihmojnë fëmijët të kuptojnë më lehtë udhëzimet, të ndjekin aktivitetet dhe të shprehin më qartë nevojat e tyre. Ora praktike na dha mundësi të shohim si mund të zbatohen njohuritë e fituara në situata reale dhe si aktivitetet fizike mund të përshtaten për të nxitur pjesëmarrjen, bashkëpunimin dhe përfshirjen e të gjithë fëmijëve.“

Burimi: Pyetësor për vlerësimin e trajnimit (përgjigje anonime)

Përvojat e ndara tregojnë se trajnimi ishte mundësi e rëndësishme zhvillimi profesional për mësimdhënësit e arsimit fizik dhe shëndetësor, sidomos për kuptimin dhe zbatimin e qasjeve gjithëpërfshirëse në mësimdhënie. Lidhja e përmbajtjeve teorike me aktivitetet praktike dhe njohja me mjete konkrete, përfshirë kartelat e komunikimit vizual (Football Talk Cards), u dhanë pjesëmarrësve ide të reja dhe gatishmëri më të madhe për të përshtatur aktivitetet sipas nevojave dhe mundësive individuale të nxënësve. Këto vëzhgime konfirmojnë rëndësinë e trajnimeve të orientuara drejt praktikës, të cilat jo vetëm ofrojnë njohuri të reja, por nxisin krijimtarinë, fleksibilitetin dhe qasjen proaktive për krijimin e kushteve të pjesëmarrjes për çdo fëmijë.

5.3.2. Përvoja nga stërvitjet dhe aktivitetet e realizuara

Stërvitjet ishin hapësira ku njohuritë dhe idetë e fituara u shndërruan në praktikë të drejtpërdrejtë. Përmes aktiviteteve të përbashkëta të futbollit, nxënësit patën mundësi të merrnin pjesë në lojë ekipore, të ndiqnin udhëzimet, të bashkëpunonin dhe të dakordoheshin për rolet brenda ekipit. Njëkohësisht, zbatimi praktik mundësoi të vërehej si ndikonin qasjet, përshtatjet dhe format e ndryshme të mbështetjes në pjesëmarrjen e secilit nxënës.

Përvojat nga stërvitjet paraqiten nga këndvështrimi i mësimdhënësve të arsimit fizik dhe shëndetësor, asistentëve arsimor dhe nxënësve. Vëzhgimet e tyre mundësojnë shqyrtimin e aktiviteteve nga aspekte të ndryshme dhe identifikimin e përfitimeve, sfidave dhe rëndësisë së pjesëmarrjes së përbashkët.

Përvojë nga stërvitja - mësimdhënës i AFSh-së

„Aktivitetet i organizuam në përputhje me aftësitë motorike dhe nevojat individuale të nxënësve. Rregullat dhe mënyrën e kryerjes së ushtrimeve i përshtatëm sipas mundësive të tyre dhe mënyrave të parapëlqyera të komunikimit. Vëmendje të veçantë i kushtuam sigurisë së tyre gjatë aktiviteteve. Përmes përshtatjeve të duhura u përpoqëm të krijojmë atmosferë pozitive ku secili fëmijë ndihet i pranuar, i mirëseardhur dhe i motivuar për pjesëmarrje.“

[Filip Milenkovski, mësimdhënës i AFSh, SHFK „Magdalena Antova“ – Kumanovë]

Përvojë nga stërvitja - mësimdhënës i AFSh

„Projekti është organizuar në nivel të lartë profesional dhe shpresoj që realizimi i tij të vazhdojë edhe në të ardhmen, sepse paraqet mundësi të shkëlqyer për të gjitha shkollat. Pajisjet që morëm në kuadër të projektit përbëjnë mbështetje të rëndësishme për zhvillimin e aktiviteteve të futbollit.“

[Borçe Spiridonov, mësimdhënës i AFSh SHFK „Koço Racin“ – Kratovë]

Përvojë nga stërvitja - mësimdhënëse e AFSh

„Pjesëmarrja në projekt, ku u përfshinë së bashku nxënës me zhvillim tipik dhe atipik, na tregoi se të gjithë nxënësit kënaqen me aktivitetet e përbashkëta. Shpresoj që këto aktivitete të vazhdojnë, sepse ndihmojnë që nxënësit të jenë të lumtur dhe të kënaqur, ta pranojnë njëri-tjetrin dhe të ndërtojnë marrëdhënie të bazuara në bashkësi dhe respekt.“

[Kristina Mladenovska-Kuzmanoska, mësimdhënëse e AFSh, SHFK „Koço Racin“ – Kratovë]

Përvojat e ndara tregojnë se realizimi i suksesshëm i aktiviteteve sportive gjithëpërfshirëse nuk varet vetëm nga zgjedhja e ushtrimeve të përshtatshme dhe sigurimi i kushteve materiale, por edhe nga gatishmëria e mësimdhënësve për t'i përshtatur aktivitetet, për të njohur aftësitë individuale të nxënësve dhe për të krijuar kushte për pjesëmarrjen e tyre të barabartë. Pikërisht kjo lidhje e njohurive të fituara me praktikën e drejtpërdrejtë përbën një nga vlerat e rëndësishme të stërvitjeve të projektit.

Përveç përvojave të mësimdhënësve, kontribut të rëndësishëm për të kuptuar zbatimin praktik të projektit kanë edhe asistentët arsimor. Përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë gjatë stërvitjeve ata patën mundësi të ndiqnin reagimet e nxënësve, mënyrën e përfshirjes në aktivitete, komunikimin dhe bashkëpunimin me pjesëmarrësit e tjerë.

Përvojë nga stërvitja – asistent arsimor

„Te nxënësi të cilit i jap mbështetje vura re shumë ndryshime pozitive. Në fillim ai kundërshtonte çdo aktivitet sportiv, por me fillimin e projektit tek ai u zhvillua interes dhe dashuri për futbollin. Tani merr pjesë aktivisht në çdo stërvitje dhe shfaq dëshirë për sport.

Po ashtu vura re ndryshime pozitive në ndërveprimin e tij me bashkëmoshatarët. Gradualisht mësoi të presë radhën, të respektojë rregullat e lojës dhe të pranojë se nuk mund të jetë gjithmonë në qendër të vëmendjes, por se edhe pjesëmarrësit e tjerë duhet të kenë mundësi të gjuajnë drejt portës, të mbrojnë dhe të marrin role të ndryshme në lojë.

Do të veçoja një situatë që më la përshtypje të veçantë. Pas tre vitesh pune aktive dhe mbështetjeje nga ana ime si asistenti i tij arsimor, nxënësi për herë të parë më tregoi qartë se dëshironte ta provonte aktivitetin në mënyrë të pavarur dhe se në atë moment nuk kishte nevojë për ndihmën time të drejtpërdrejtë. Ky ishte një çast veçanërisht emocional për mua, sepse një nga qëllimet e mia kryesore është të nxis pavarësinë, autonominë dhe lirinë e tij në veprim.

Për mua, një nga rezultatet më të vlefshme të këtij projekti është se e ndihmoi nxënësin të ndërtojë vetëbesim dhe të bëhet më i pavarur në kryerjen e ushtrimeve, pa mbikëqyrje dhe mbështetje të vazhdueshme nga ana ime.“

[Viktor Veliçkovski, asistent arsimor]

Përvojë nga stërvitja - asistente arsimore

„Si kontributin më të rëndësishëm të këtij projekti do të veçoja përfshirjen e nxënësve me zhvillim tipik dhe atipik në aktivitetet e përbashkëta. Nxënësit morën mbështetjen e nevojshme, sidomos nga mësimdhënësit e arsimit fizik dhe shëndetësor, ndërsa i rëndësishëm ishte edhe pëlqimi dhe mbështetja e prindërve për pjesëmarrjen e tyre.

Te nxënësi të cilit i jap mbështetje vërej ndryshime pozitive, sidomos duke pasur parasysh se më parë nuk dëshironte të përfshihej në aktivitete grupore. Tani merr pjesë gjithnjë e më shpesh në aktivitete me grupe më të mëdha, shfaq dëshirë për bashkëpunim dhe ndjek udhëzimet e përshtatura me nevojat dhe mundësitë e tij.“

[Angela Bozhinovska, asistente arsimore]

Përvojë nga stërvitja - asistente arsimore

„Ka shumë çaste nga ky projekt që më kanë mbetur në kujtesë dhe më kanë prekur veçanërisht. Njëri prej tyre ishte situata kur një nxënëse u tërhoq mënjanë dhe nuk donte të merrte pjesë në aktivitete. Megjithatë, një nga trajnerët, falë aftësive, përvojës dhe njohurive të tij, arriti ta përfshinte sërish në aktivitet. Kështu na tregoi se ndonjëherë mjafton vetëm një hap i vogël dhe një dorë e zgjatur për të bërë shumë dhe për t›i mundësuar çdo fëmije të jetë pjesë e aktiviteteve të përbashkëta.

Përmes këtij projekti kuptova gjithashtu sa e rëndësishme mund të jetë mbështetja nga bashkëmoshatarët, sepse ata mund të kenë rol të rëndësishëm në inkurajimin dhe përfshirjen e fëmijëve që kanë nevojë për mbështetje shtesë.“

[Julija Jakimovska, asistente arsimore]

Përvojat e asistentëve arsimor tregojnë ndryshimet pozitive që mund të nxiten nga pjesëmarrja e vazhdueshme në aktivitete sportive gjithëpërfshirëse. Vëzhgimet e tyre theksojnë veçanërisht përparimin në pavarësinë, vetëbesimin dhe komunikimin e nxënësve, si edhe rëndësinë e mbështetjes dhe inkurajimit të duhur për përfshirje më aktive në aktivitetet e përbashkëta.

Megjithatë, përvoja nga stërvitjet nuk do të paraqitej e plotë pa dëgjuar edhe zërin e vetë nxënësve. Përshtypjet dhe përjetimet e tyre mundësojnë që aktivitetet të shihen nga këndvështrimi i tyre dhe të kuptohet çfarë kuptimi kishin për ta loja e përbashkët, shoqërimi, bashkëpunimi ekipor dhe mundësia për të qenë pjesë e ekipit të futbollit.

Përvojë nga stërvitja - nxënës *„Më së shumti gëzohesha për topin dhe kur shënoja gol.“* [L. Gj., nxënës]
Përvojë nga stërvitja - nxënës *„U ndjeva shumë mirë që mora pjesë në këtë projekt; ishte interesante të luaja futboll. Unë jam portieri më i mirë.“* [F. D., nxënës]
Përvojë nga stërvitja – nxënës *„Ishte shumë interesante për mua të merrja pjesë në projektin „Touch the Goal“. Shpresoj që aktivitetet të vazhdojnë dhe të bëj shokë të rinj.“* [M. H., nxënës]

Këndvështrimet e ndryshme të mësimdhënësve të arsimit fizik dhe shëndetësor, asistentëve arsimor dhe nxënësve plotësojnë pamjen e përvojave nga aktivitetet e projektit. Vëzhgimet e tyre tregojnë se realizimi i suksesshëm i aktiviteteve sportive gjithëpërfshirëse dallohet jo vetëm nga mundësia e secilit nxënës për të marrë pjesë në lojë, por edhe nga ndryshimet që nxiten në pavarësinë, vetëbesimin, komunikimin dhe bashkëpunimin e tij me bashkëmoshatarët. Gëzimi nga goli i shënuar, dëshira për të marrë pjesë sërish, krijimi i miqësive të reja dhe ndjenja e përkatësisë janë tregues po aq të rëndësishëm të vlerës së këtyre aktiviteteve.

Përvojat nga projekti „Touch the Goal – Futboll për çdo fëmijë“ konfirmojnë se futbolli gjithëpërfshirës është shumë më tepër se aktivitet sportiv. Ai është mundësi për të nxënë, për pranimin e ndërsjellë, ndërtimin e marrëdhënieve dhe krijimin e një mjedisi ku secili fëmijë mund të marrë pjesë, të përparojë dhe të kontribuojë sipas mënyrës së vet.

5.4. Çfarë mësuam: monitorimi i pjesëmarrjes dhe përmirësimi i praktikës

Pas aktivitetit shënohen kushtet që e lehtësuan pjesëmarrjen, pengesat e vërejtura dhe përshtatjet e dobishme. Ndjekja mund të jetë e shkurtër dhe praktike.

Elementet kryesore për ndjekje:

- Qasja dhe kuptimi: detyrë e kuptueshme dhe udhëzime të qasshme.
- Pjesëmarrja aktive: mundësi për lojë dhe rol të rëndësishëm.
- Komunikimi dhe zgjedhja: shprehja e dëshirës, zgjedhja, kërkimi i ndihmës ose pushimit.
- Pavarësia: realizim pa mbështetje të drejtpërdrejtë të panevojshme.
- Ndërveprimi me bashkëmoshatarët: bashkëpunimi, inkurajimi dhe vendimmarrja e përbashkët.
- Siguria dhe pranimi: siguri dhe ndjenjë përkatësie.

Këto elemente janë udhëzime për përmirësimin e kushteve të pjesëmarrjes, jo listë formale për vlerësimin e nxënësit.

- Përshtatini udhëzimet, ritmin, organizimin dhe mbështetjen sipas nevojave të vërejtura. Vështirësitë e papritura janë arsye për rishikimin dhe përmirësimin e qasjes.

Nga vëzhgimi te ndryshimi

Vëzhgimet lidhen me një ndryshim konkret përmes elementeve të mëposhtme:

Tabela 26. Nga vëzhgimi te ndryshimi: elemente për shënim

Elementi	Çfarë është e rëndësishme të shënohet
Situata	Cili aktivitet u zhvillua dhe në çfarë kushtesh?
Pengesa ose nevoja	Çfarë e vështirësoi pjesëmarrjen ose çfarë kërkuan pjesëmarrësit?
Ndryshimi i bërë	Çfarë u ndryshua në udhëzime, hapësirë, pajisje, ritëm ose role?
Reagimi i vërejtur	Çfarë u vërejt ose u tha vërtet, pa supozime?
Hapi tjetër	Çfarë duhet ruajtur, përshtatur ose kontrolluar më tej?

- Nëse nuk ka përmirësim, shqyrtojini sërish detyrën, ritmin, grupin, pajisjet, komunikimin dhe rolin e pjesëmarrësit. Pengesa e dukshme nuk është domosdoshmërisht shkaku i vetëm.
- Kërkoni informacion kthyes nga nxënësit në mënyrë të qasshme: çfarë i ndihmoi, çfarë ishte e vështirë dhe çfarë duan të jetë ndryshe.
- Shkëmbeni vëzhgimet me mësimdhënësin e arsimit fizik dhe shëndetësor, asistentin arsimor dhe personat e tjerë të përfshirë dhe dakordoni hapin tjetër.

Vëzhgim → pyetje → ndryshim → rishikim me pjesëmarrësit.

5.5. Nga përvoja e projektit te praktika e qëndrueshme

Kushtet kryesore për zbatimin e qëndrueshëm të „Touch the Goal - Futboll për çdo fëmijë

- bpërfshirja në planifikimin e rregullt;
- materiale të qasshme dhe të mirëmbajtura;
- profesionistë të përgatitur;
- bashkëpunim ekipor;
- pjesëmarrja e nxënësve në planifikim.

Rekomandime për mësimdhënësit e arsimit fizik dhe shëndetësor dhe trajnerët

- Planifikojeni qëllimin e aktivitetit në mënyrë që të ketë disa forma pjesëmarrjeje të rëndësishme;
- Shpjegoni shkurt dhe qartë, ndërsa kur është e dobishme, demonstrojeni detyrën;
- Parashikoni mundësi zgjedhjeje, prove shtesë, pushimi dhe rikthimi;
- Ndiqni kush merr pjesë vërtet, jo vetëm kush është i pranishëm në fushë;
- Bisedoni me nxënësit për atë që i ndihmon dhe çfarë dëshirojnë të provojnë;
- Shqyrtojini sfidat me kolegët dhe planifikoni ndryshime për aktivitetin vijues.

Rekomandime për shkollat dhe organizatat

- Siguroni kohë për planifikim të përbashkët dhe reflektim të shkurtër pas aktiviteteve;
- Qartësoni rolet e mësimdhënësve, asistentëve arsimor dhe personave të tjerë të përfshirë;
- Mbajini mjetet dhe materialet në vend të qasshëm dhe planifikoni mirëmbajtjen e tyre;
- Përfshini familjet në shkëmbimin e informacioneve relevante duke respektuar privatësinë;
- Dokumentoni aktivitetet dhe mësimet e nxjerra me pëlqimin e duhur dhe pa zbuluar të dhëna personale të panevojshme;
- Ndani shembuj të verifikuar me shkolla dhe organizata të tjera sportive për të nxitur shkëmbimin e përvojave.

Kontroll i shkurtër para aktivitetit

- Qëllimi dhe udhëzimet janë të qarta.
- Hapësira dhe pajisjet i përshtaten detyrës.
- Ekzistojnë mënyra të ndryshme pjesëmarrjeje dhe kontributi.
- Rolet e profesionistëve janë dakorduar.
- Pjesëmarrësit mund të bëjnë zgjedhje, të kërkojnë ndihmë ose pushim.
- Ekziston mënyrë që nxënësit të japin informacion kthyes.
- Parashikohet shqyrtim i shkurtër i përvojës pas aktivitetit.

Përfundime

„Touch the Goal - Futboll për çdo fëmijë“ thekson mundësinë që futbolli të jetë hapësirë për lëvizje, të nxënë, bashkëpunim dhe përkatësi. Kalimi nga modeli te praktika ndodh kur profesionistët e vëzhgojnë aktivitetin, i dëgjojnë pjesëmarrësit dhe bëjnë ndryshime që mundësojnë pjesëmarrjen.

Përvojat nga trajnimet, stërvitjet dhe aktivitetet e realizuara kanë vlerë të veçantë kur ndahen me kujdes dhe besueshmëri. Ato nuk shërbejnë vetëm për paraqitjen e arritjeve, por edhe për reflektim profesional dhe përmirësim të mëtejshëm. Zëri i nxënësve është pjesë e rëndësishme e këtij procesi, sepse cilësia e aktivitetit gjithëpërfshirës duhet vlerësuar edhe nga mënyra si e përjetojnë vetë pjesëmarrësit.

Praktika e qëndrueshme gjithëpërfshirëse ndërtohet përmes vendimeve konkrete: komunikimit të qartë, organizimit fleksibil, bashkëpunimit, mundësisë për zgjedhje dhe respektimit të individualitetit. Kur këto vendime bëhen pjesë e punës së përditshme, futbolli mund të hapë më shumë rrugë që çdo fëmijë të marrë pjesë, të kontribuojë dhe të jetë pjesë e ekipit.

FJALËT KYÇE

Futboll i përshtatur - Aktivitet futbolli ku rregullat, pajisjet, hapësira ose mënyra e lojës përshtaten sipas aftësive dhe nevojave të pjesëmarrësve, duke ruajtur qëllimin themelor dhe vlerën e lojës.

Pjesëmarrje aktive - Përfshirja e fëmijës në aktivitet përmes një roli me vlerë për të dhe grupin. Nuk kufizohet vetëm në praninë fizike, por nënkupton mundësinë e fëmijës për të zgjedhur, komunikuar, bashkëpunuar dhe kontribuar.

Komunikim alternativ - Mënyra dhe mjete që i mundësojnë fëmijës të shprehë nevojat, dëshirat, zgjedhjet dhe mendimet kur komunikimi me të folur nuk mjafton ose nuk është mënyra më e përshtatshme e shprehjes.

Mbështetje vizuale - Përdorimi i figurave, simboleve, fotografive, kartelave ose materialeve të tjera vizuale për të kuptuar më lehtë udhëzimet, rrjedhën e aktivitetit, rregullat dhe mundësitë e zgjedhjes.

Mbështetje nga bashkëmoshatarët - Mbështetja që ofrojnë fëmijët e tjerë përmes inkurajimit, bashkëpunimit dhe ndihmës për përfshirje në lojë. Ndihmon në ndërtimin e marrëdhënieve pozitive dhe ndjenjës së përkatësisë.

Mbështetje individuale - Mbështetje e ofruar sipas nevojave konkrete të fëmijës dhe kushteve të aktivitetit. Mund të përfshijë sqarimin e udhëzimeve, demonstrimin, ndihmën vizuale ose mbështetjen në komunikim.

Futboll gjithëpërfshirës - Qasje ndaj aktiviteteve të futbollit që mundëson pjesëmarrjen e çdo fëmije duke marrë parasysh interesat, aftësitë, mundësitë dhe nevojat e tij për mbështetje. Qëllimi nuk është që të gjithë fëmijët ta realizojnë aktivitetin në të njëjtën mënyrë, por secili të ketë mundësi për pjesëmarrje të rëndësishëm.

Mjedis sportiv gjithëpërfshirës - Mjedis ku krijohen kushte për qasje, siguri, pranim dhe pjesëmarrje aktive të të gjithë fëmijëve. Ai ndërtohet përmes organizimit të aktiviteteve, marrëdhënieve ndërmjet pjesëmarrësve dhe mbështetjes së përshtatshme.

Lojë bashkëpunuese - Mënyrë loje ku pjesëmarrësit bashkëpunojnë drejt një qëllimi të përbashkët, në vend që theksi të jetë vetëm te gara dhe rezultati individual.

Kutia mobile gjithëpërfshirëse POP-UP (Football Pop-Up Inclusion Corner) – Mjet portativ me tabelë vizuale futbolli dhe figura për eksplorimin e pozicioneve, planifikimin e aksioneve, komunikimin dhe bashkëpunimin.

Këndi i përshtatur – Vend i përshtatur ku fëmija mund të punojë në kushte më të qeta, të përdorë mjete, të komunikojë ose të bëjë pushim të shkurtër, me mundësi rikthimi në aktivitetin e përbashkët.

Pasaporta për mbështetjen nga bashkëmoshatarët (Peer Power Passport) - Mjet i projektit që nxit mbështetjen nga bashkëmoshatarët, bashkëpunimin dhe përfshirjen aktive të fëmijëve në aktivitetet e përbashkëta.

Informacion kthyes - Informacion i marrë nga pjesëmarrësit ose nga vëzhgimi, që ndihmon të kuptohet çfarë ishte e dobishme, çfarë paraqiti vështirësi dhe çfarë mund të ndryshojë.

Qasje - Sigurimi i kushteve ku fëmija mund ta kuptojë aktivitetin, të ketë qasje në të dhe të marrë pjesë. Lidhet me hapësirën, pajisjet, udhëzimet, rregullat dhe mënyrën e komunikimit.

Përshtatje - Ndryshim i elementeve të aktivitetit, si rregullat, hapësira, pajisjet, kohëzgjatja, ritmi ose rolet, për të hequr pengesat dhe mundësuar pjesëmarrjen.

Reflektim profesional - Procesi i shqyrtimit dhe analizës së aktivitetit të realizuar për të njohur qasjet e suksesshme, pengesat dhe mundësitë për përmirësim.

Vetërregullim - Aftësia e fëmijës për të njohur gradualisht dhe menaxhuar emocionet, reagimet dhe nevojat e veta. Në aktivitetet sportive mund të mbështetet përmes parashikueshmërisë, pushimeve, zgjedhjes dhe strategjive të qetësimit.

Pavarësi - Mundësia që fëmija të ndërmarrë veprime, të bëjë zgjedhje dhe të marrë pjesë me nivelin më të ulët të nevojshëm të mbështetjes. Mbështetja duhet ta nxisë pavarësinë, jo ta zëvendësojë.

Mbingarkesë shqisore - Gjendje kur intensiteti ose sasia e stimujve shqisorë bëhet tepër rënduese për fëmijën. Mund të shfaqet me shqetësim, tërheqje ose nevojë për pushim.

Nevoja shqisore - Nevoja individuale që lidhen me mënyrën si fëmija merr dhe përpunon informacionet shqisore, si tingulli, drita, prekja, lëvizja dhe stimujt hapësinorë.

Kartelat e komunikimit në futboll (Football Talk Cards) - Mjet i projektit me kartela vizuale për mbështetjen e komunikimit dhe shprehjen e zgjedhjeve, nevojave dhe mesazheve gjatë aktiviteteve të futbollit.

Ndjenja e përkatësisë - Përjetimi i fëmijës se është pjesë e pranuar dhe e rëndësishme e grupit apo ekipit dhe se prania e kontributi i tij vlerësohen.

LITERATURA DHE BURIMET

Doracaku „Touch the Goal - Preke Golin“ është përgatitur mbi bazën e përvojave praktike, aktiviteteve të realizuara dhe mjeteve novatore të zhvilluara në kuadër të nismës së zbatuar nga SHFQR „Idnina“ - Shkup, me mbështetjen e Federatës së Futbollit të Maqedonisë (FFM) dhe UEFA Foundation for Children (Fondacioni i UEFA-s për Fëmijët).

Dokumente referuese shtesë

Parimet e mundësive të barabarta, qasjes, pjesëmarrjes aktive, mbështetjes nga bashkëmoshatarët dhe gjithëpërfshirjes, mbi të cilat mbështeten qasjet e paraqitura në doracak, janë në përputhje me udhëzimet dhe orientimet më të gjera të UEFA-s, të përfshira në dokumentet e mëposhtme:

1. UEFA. (2023). UEFA Grassroots Charter, 2023 Edition. [Karta e UEFA-s për futbollin masiv, botimi i vitit 2023.] Burimi zyrtar
2. UEFA. (2024). UEFA Accessibility Guidelines. [Udhëzimet e UEFA-s për qasjenë.] Burimi zyrtar
3. UEFA. (2026). UEFA Equality, Diversity and Inclusion Toolkit. [Doracaku i UEFA-s për barazi, diversitet dhe gjithëpërfshirje.] Burimi zyrtar

Referencë për shembullin vizual të fazave

FIFA. (2025). FIFA Disability Football Toolkit. September 2025. [Doracaku i FIFA-s për futbollin e personave me aftësi të kufizuara, shtator 2025.] Referencë për shembullin fillestar vizual me faza, f. 50. Burimi zyrtar

Burimi i piktogrameve

ARASAAC. Piktogramet për kartelat e komunikimit. Autor: Sergio Palao. Gobierno de Aragón (Qeveria e Aragonit). https://arasaac.org. Licenca CC BY-NC-SA. Kushtet e përdorimit: https://arasaac.org/terms-of-use.

Dokumentet e përmendura përbëjnë kornizë referuese shtesë për kuptimin dhe përmirësimin e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse në aktivitetet e futbollit.

SHTOJCA 1.
FORMULAR PËR PLANIFIKIMIN E AKTIVITETIT GJITHËPËRFSHIRËS TË FUTBOLLIT

I destinuar për mësimdhënësit e arsimit fizik dhe shëndetësor, trajnerët dhe profesionistët e tjerë që planifikojnë dhe realizojnë aktivitete futbolli.

Formulari mundëson shqyrtimin paraprak të qëllimit, organizimit dhe mënyrave të mundshme të pjesëmarrjes, si edhe të përshtatjeve të nevojshme. Nuk është e domosdoshme të plotësohet çdo fushë për çdo aktivitet.

A. Informacione bazë

Tabela 27. Informacione bazë për planifikimin e aktivitetit

Të dhënat	Përgjigjja
Emri i aktivitetit	
Data dhe vendi	
Mosha / klasa e pjesëmarrësve	
Numri i pjesëmarrësve	
Personi që drejton aktivitetin	
Kohëzgjatja	

B. Planifikimi i aktivitetit

Tabela 28. Plani i aktivitetit gjithëpërfshirës të futbollit

Elementi	Planifikimi
Qëllimi i aktivitetit - Çfarë duam që pjesëmarrësit të mësojnë, ushtrojnë ose arrijnë?	
Organizimi i hapësirës - Si do të organizohet hapësira për të mundësuar qasje dhe pjesëmarrje të sigurt?	
Detyra dhe udhëzimet - Si do ta shpjegojmë dhe demonstrojmë aktivitetin?	
Rregullat - Cilat rregulla janë të domosdoshme dhe a mund të thjeshtohen ose përshtaten?	
Pajisjet - Cilat pajisje duhen dhe a duhet të përshtaten?	

C. Mundësitë për pjesëmarrje dhe mbështetje

Tabela 29. Planifikimi i mundësive për pjesëmarrje dhe mbështetje

Çfarë mund ta lehtësojë pjesëmarrjen?	Si do ta sigurojmë?
Mënyra të ndryshme të realizimit të detyrës	
Mundësi për zgjedhjen e rolit ose aktivitetit	
Mbështetje vizuale ose tjetër për komunikimin	
Mbështetje nga bashkëmoshatari ose i rrituri	
Mundësi për pushim dhe rikthim në aktivitet	
Kohë shtesë ose udhëzim i thjeshtuar	

D. Rolet dhe përgjegjësitë

Tabela 30. Ndarja e roleve dhe përgjegjësive

Pjesëmarrësi në realizim	Roli / përgjegjësia
Mësimdhënësi i arsimit fizik dhe shëndetësor / trajneri	
Asistenti arsimor (nëse është i përfshirë)	
Profesionistë të tjerë	
Bashkëmoshatarët / nxënësit e klasës	

E. Ndjekja e pjesëmarrjes

Tabela 31. Ndjekja e pjesëmarrjes në aktivitetin e planifikuar

Si do ta vërejmë nëse të gjithë kanë mundësi të përfshihen aktivisht?	
Si do të mund të kërkojnë pjesëmarrësit ndihmë, të bëjnë zgjedhje ose të shprehin nevojën për pushim?	
-Në ç'mënyrë do të mbledhim informacion kthyes pas aktivitetit?	
Shënime për përshtatje shtesë	

SHTOJCA 2.
LISTË E KONTROLLIT PËR AKTIVITETIN GJITHËPËRFSHIRËS TË FUTBOLLIT

Listë e shkurtër vetëkontrolli para, gjatë dhe pas aktivitetit.

Lista mund të përdoret si kujtesë për aspektet kryesore të aktivitetit gjithëpërfshirës. Qëllimi i saj nuk është vlerësimi formal, por identifikimi në kohë i pengesave të mundshme dhe i nevojës për ndryshime.

A. Para aktivitetit

Tabela 32. Listë kontrolli para aktivitetit

Pyetja e kontrollit	Po	Nevojitet përshtatje
A është i qartë qëllimi i aktivitetit?	□	□
A janë udhëzimet të shkurtra dhe të kuptueshme?	□	□
A është parashikuar demonstrim ose mbështetje vizuale kur nevojitet?	□	□
A është hapësira e sigurt dhe a mundëson mënyra të ndryshme lëvizjeje?	□	□
A janë pajisjet të përshtatshme dhe të qasshme?	□	□
A janë parashikuar mënyra të ndryshme pjesëmarrjeje?	□	□
A janë të qarta rolet e personave që mbështesin aktivitetin?	□	□
A e dinë pjesëmarrësit si të kërkojnë ndihmë ose pushim?	□	□

B. Gjatë aktivitetit

Tabela 33. Listë kontrolli gjatë aktivitetit

Pyetja e kontrollit	Po	Nevojitet përshtatje
A e kuptojnë pjesëmarrësit detyrën?	□	□
A ka secili mundësi të kontribuojë?	□	□
A respektohen zgjedhja dhe ritmi i pjesëmarrësve?	□	□
A është komunikimi i qartë dhe i qasshëm?	□	□
A zhvillohet mbështetja nga bashkëmoshatarët me respekt dhe pa imponim?	□	□
A vërehen shenja lodhjeje ose mbingarkese?	□	□
A bëhen ndryshime kur një mënyrë pune nuk funksionon?	□	□

C. Pas aktivitetit

Tabela 34. Listë kontrolli pas aktivitetit

Pyetja e kontrollit	Po	Nevojitet përshtatje
A iu mundësua pjesëmarrësve të ndajnë përvojën?	□	□
A u vërejtën mënyra të suksesshme pjesëmarrjeje?	□	□
A u identifikuan pengesat që u shfaqën?	□	□
A u përcaktuan ndryshimet për aktivitetin vijues?	□	□

Çfarë funksionoi mirë?
Çfarë duhet ndryshuar ose përmirësuar?
Cilin ndryshim do ta zbatojmë herën tjetër?

SHTOJCA 3.
FORMULAR PËR VËZHGIM, PËRSHTATJE DHE REFLEKTIM

Formular pune për dokumentimin e situatave konkrete dhe vendimeve të marra gjatë aktivitetit.

Formulari ndihmon të lidhen situata e vërejtur, pengesa e identifikuar, përshtatja e bërë dhe ndikimi i saj në pjesëmarrje. Mund të plotësohet për një ose disa situata brenda aktivitetit.

A. Informacione bazë

Tabela 35. Informacione bazë për vëzhgim

Të dhënat	Përgjigjja
Aktiviteti	
Data	
Personi që vëzhgon	
Pjesa e aktivitetit / situata	

B. Vëzhgimi dhe përshtatja

Tabela 36. Shënimi i situatës dhe përshtatjes

Hapi	Përshkrimi
1. Çfarë vura re? – Situatë ose sjellje konkrete që mund të përshkruhet.	
2. Cilën pengesë ose nevojë identifikova?	
3. Çfarë përshtatjeje ose mbështetjeje zbatuam?	
4. Si reagoi pjesëmarrësi? – Çfarë ndryshoi në pjesëmarrjen e tij?	
5. A ndihmoi përshtatja?	□ Po □ Pjesërisht □ Jo
6. Çfarë duhet të bëjmë më tej?	

C. Reflektimi pas aktivitetit

Tabela 37. Reflektimi pas aktivitetit

Çfarë mësuam nga kjo situatë?	
Cilën përshtatje do të ruanim?	
Çfarë do të bënim ndryshe herën tjetër?	
A nevojitet bashkëpunim ose mbështetje shtesë?	

Shënim: Gjatë plotësimit të formularit shënohen situata konkrete dhe të vëzhgueshme, jo supozime për aftësitë, motivet apo qëllimet e pjesëmarrësit. Qëllimi është të rishikohen kushtet dhe mënyra e zhvillimit të aktivitetit, jo të vlerësohet fëmija.

SHTOJCA 4.
FORMULAR PËR PLANIFIKIMIN DHE ORGANIZIMIN E MBËSHTETJES NGA BASHKËMOSHATARËT

Ky formular u dedikohet mësimdhënësve të arsimit fizik dhe shëndetësor, trajnerëve dhe personave të tjerë të përfshirë në realizimin e aktiviteteve gjithëpërfshirëse të futbollit. Qëllimi i tij është të ndihmojë në planifikimin e mbështetjes nga bashkëmoshatarët si mënyrë për të nxitur bashkëpunimin, pjesëmarrjen e ndërsjellë dhe ndjenjën e përkatësisë në grup.

Mbështetja nga bashkëmoshatarët duhet të mbështetet në vullnetarizëm, respekt të ndërsjellë dhe pjesëmarrje të përbashkët. Ajo nuk nënkupton që një fëmijë të jetë vazhdimisht përgjegjës për mbështetjen e një tjetri ose t'i kryejë detyrat në vend të tij. Është e rëndësishme që të gjithë nxënësit të mund të kontribuojnë, të marrin mbështetje dhe të ndërrojnë role.

A. Informacione bazë

Tabela 38. Informacione bazë për mbështetjen nga bashkëmoshatarët

Të dhënat	Përgjigjja
Emri i aktivitetit	
Data dhe vendi	
Klasa / grupmosha	
Numri i pjesëmarrësve	
Personi që planifikon / drejton aktivitetin	

B. Planifikimi i mbështetjes nga bashkëmoshatarët

Tabela 39. Plani i mbështetjes nga bashkëmoshatarët

Pyetja	Planifikimi / shënimet
Në cilën pjesë të aktivitetit do të nxitet mbështetja nga bashkëmoshatarët?	
Çfarë lloj bashkëpunimi parashikohet? (p.sh. pasim topi, kryerje e përbashkët e detyrës, demonstrim, inkurajim)	
Si do të shpjegohet detyra dhe roli i nxënësve?	
Si do t'u mundësohet nxënësve të zgjedhin nëse dhe në ç'mënyrë do të marrin pjesë në mbështetje?	
Si do të nxitet ndërrimi i partnerëve dhe roleve?	
Si do të sigurohet që mbështetja të mos e kufizojë pavarësinë e nxënësit?	

C. Ndarja e roleve

Tabela 40. Ndarja e roleve ndërmjet bashkëmoshatarëve

Roli / detyra	Kush merr pjesë?	Shënime
Kryerja e përbashkët e detyrës		
Pasimi ose dorëzimi i topit		
Demonstrimi i aktivitetit		
Inkurajimi dhe komunikimi i ndërsjellë		
Formë tjetër bashkëpunimi		

Rolet mund të ndërrohen gjatë aktivitetit që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të kontribuojnë në mënyra të ndryshme.

D. Ndjekja e mbështetjes nga bashkëmoshatarët

Tabela 41. Ndjekja e mbështetjes nga bashkëmoshatarët

Çfarë vëzhgojmë?	Shënime
A bashkëpunojnë nxënësit dhe a e respektojnë njëri-tjetrin?	
A ofrohet mbështetja pa imponim?	
A ka nxënësi mundësi të vendosë vetë nëse do ta pranojë mbështetjen?	
A kanë të gjithë nxënësit mundësi të kontribuojnë?	
A ndërrohen partnerët dhe rolet?	
A e lehtëson mbështetja nga bashkëmoshatarët pjesëmarrjen në aktivitet?	

E. Reflektimi pas aktivitetit

Çfarë funksionoi mirë në organizimin e mbështetjes nga bashkëmoshatarët?

Cilat sfida u shfaqën në bashkëpunimin ndërmjet nxënësve?

Çfarë do të ndryshonim herën tjetër në organizimin e mbështetjes nga bashkëmoshatarët?

Cilat forma bashkëpunimi do të donim t'i zbatonim sërish?

Udhëzime të rëndësishme për zbatimin

Mbështetja nga bashkëmoshatarët ofrohet duke respektuar zgjedhjen dhe pavarësinë e secilit nxënës.

Përpara dhënies së ndihmës, duhet kontrolluar nëse nxënësi ka nevojë dhe e pranon ndihmën e ofruar.

Mbështetja duhet të jetë e ndërsjellë, ndërsa partnerët dhe rolet të ndërrohen.

Secili nxënës duhet të mund të kontribuojë në aktivitet në mënyrën që i përshtatet.

Mbështetja nga bashkëmoshatarët nuk e zëvendëson përgjegjësinë e mësimdhënësit të arsimit fizik dhe shëndetësor, trajnerit ose personave të tjerë të përfshirë.

Formulari mund të përshtatet sipas llojit të aktivitetit, moshës së nxënësve dhe mënyrës së organizimit të grupit.

SHTOJCA 5.
FOOTBALL TALK CARDS - KARTELAT E KOMUNIKIMIT NË FUTBOLL

Autor i piktogrameve: Sergio Palao. Burimi: ARASAAC (https://arasaac.org). Mbajtësi i të drejtave: Gobierno de Aragón (Qeveria e Aragonit), Spanjë. Licenca: Creative Commons BY-NC-SA.

Kartelat e komunikimit në futboll (Football Talk Cards) janë mjet praktik për mbështetjen e kuptimit, shprehjes së zgjedhjeve dhe nevojave dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e futbollit.

Në këtë shtojcë paraqitet grupi origjinal i Kartelave të Komunikimit në Futboll (Football Talk Cards), i përgatitur në kuadër të „Touch the Goal - Futboll për çdo fëmijë“.


 1. Aut	 2. Ujë	 3. Gol	 4. Portier	 5. Paso
 6. Karton i verdhë	 7. Zëvendësim	 8. Goditje nga këndi	 9. Fund	 10. Prapa
 11. Përpara	 12. Pushim	 13. Penallti	 14. Pikë	 15. Përshëndetje
 16. Fillim	 17. Vazhdo	 18. Fishkëllimë	 19. Ulu në rreth	 20. Ulu në karrige
 21. Kërce	 22. Ndalo	 23. Gjyqtar	 24. Ekip	 25. Top
 26. Trajner	 27. Faull	 28. Futbollist	 29. Karton i kuq	 30. Gjuajtje

Figura 17. Kompleti origjinal i 30 kartelave të komunikimit në futboll. Numrat poshtë kartelave shërbejnë për gjetjen më të lehtë të termave; burimi i piktogrameve është shënuar në fillim të shtojcës.

SHTOJCA 5.
KARTELA SHTESË NGA ARASAAC

Përzgjedhje shtesë piktogramesh për komunikimin, shprehjen e nevojave dhe aktivitetet e futbollit. Këto kartela plotësojnë kompletin origjinal të paraqitur në faqen e mëparshme; ato nuk paraqiten si pjesë e kompletit të përdorur gjatë projektit.



 **1. Ndihmë** ARASAAC: 4570	 **2. Prit** ARASAAC: 36914	 **3. Po** ARASAAC: 5584	 **4. Jo** ARASAAC: 5526	 **5. Më dhemb** ARASAAC: 2367
 **6. Lodhje** ARASAAC: 2314	 **7. Tualet** ARASAAC: 5921	 **8. Gëzim** ARASAAC: 3250	 **9. Trishtim** ARASAAC: 2606	 **10. Nuk kuptoj** ARASAAC: 37827
 **11. Sulm** ARASAAC: 36496	 **12. Mbrojtje** ARASAAC: 36521	 **13. Mbrojtja e portës** ARASAAC: 39835	 **14. Këpucë futbolli** ARASAAC: 16585	 **15. Fushë futbolli** ARASAAC: 3073

Figura 18. Përzgjedhje shtesë prej 15 piktogramesh nga ARASAAC. Mesazhet shërbejnë për shprehjen e nevojave, ndjenjave dhe termave të futbollit. Poshtë çdo kartele shënohet edhe identifikuesi i burimit.

Autor i piktogrameve: Sergio Palao. Burimi: ARASAAC (https://arasaac.org). Mbajtësi i të drejtave: Gobierno de Aragón (Qeveria e Aragonit), Spanjë. Licenca: CC BY-NC-SA. Emërtimet në maqedonisht janë shtuar për nevojat e këtij doracaku.

Burimi individual: https://arasaac.org/pictograms/en/ + numri i shënuar poshtë kartelës. Kushtet e përdorimit: https://arasaac.org/terms-of-use.

EKIPI I REALIZIMIT TË PROJEKTIT NGA SHFQR „IDNINA“ - SHKUP

Tabela 42. Ekipi për realizimin e projektit nga SHFQR „Idnina“

Emri dhe mbiemri	Funksioni / profesioni
Lloreta Andreevska	Drejtoreshë; edukator special dhe rehabilitator
Katerina Veliçkovska	Edukator special dhe rehabilitator
Pavell Mirçevski	Edukator special dhe rehabilitator
Zoran Pançevski	Mësimdhënës i arsimit fizik dhe shëndetësor
Mr. Irena Novaçeska Makalloska	Edukator special dhe rehabilitator
Nikollçe Neshevski	Edukator special dhe rehabilitator

SHKOLLAT DHE ANËTARËT E EKIPIT

Në realizim morën pjesë nëntë shkolla fillore partnere dhe SHFQR „Idnina“ - Shkup. Në vijim renditen anëtarët e ekipit sipas listës së dorëzuar.

Tabela 43. Shkollat dhe anëtarët e ekipeve

SHFK/Komuna	Emri dhe mbiemri/roli
SHFQR „Idnina“ - Shkup	Zoran Pançevski
SHFK „Zhivko Brajkovski“ - Butel	Nikollçe Neshevski
SHFK „Zhivko Brajkovski“ - Butel	Nikolla Piljuroviq, mësimdhënës i AFSh
SHFK „Koço Racin“ - Petrovec	Besar Fejzullov, mësimdhënës i AFSh, koordinator
SHFK „Koço Racin“ - Petrovec	Teodora Dimitrovska, mësimdhënëse e AFSh, koordinatore
SHFK „Hristijan Karposh“ - Kumanovë	Josif Stankoviq, mësimdhënës i AFSh
SHFK „Hristijan Karposh“ - Kumanovë	Nevena Stojmanoviq, mësimdhënëse e a AFSh, koordinatore
SHFK „Koço Racin“ - Kratovë	Stefan Ilievski, mësimdhënës i AFSh
SHFK „Koço Racin“ - Kratovë	Borçe Spiridonov, mësimdhënës i AFSh, koordinator
SHFK „Magdalena Antova“ - Kumanovë	Kristina Mlladenovska Kuzmanoska, mësimdhënëse e AFSh
SHFK „Magdalena Antova“ - Kumanovë	Filip Milenkovski, mësimdhënës i AFSh, koordinator
SHFK „Ilinden“ - Kriva Pallankë	Aleksandra Kocevska Denkoviq, mësimdhënëse e AFSh

SHFK/Komuna	Emri dhe mbiemri/roli
SHFK „Ilinden“ - Kriva Pallankë	Biljana Jovanovska, mësimdhënëse e AFSh koordinatore
SHFK „Imri Elezi“ - Çair	Kristijan Stanojkovski, AFSh
SHFK „Imri Elezi“ - Çair	Sabri Ramadani, AFSh, koordinator
SHFK „Vasill Gllavinov“ - Çair	Enes Arifi, mësimdhënës i AFSh
SHFK „Vasill Gllavinov“ - Çair	Nijazi Elmazov, mësimdhënës i AFSh, koordinator
SHFK „Kiro Gligorov“ - Qendër	Driton Idrizi, mësimdhënës i AFSh
SHFK „Kiro Gligorov“ - Qendër	Nikollçe Todorovski, mësimdhënës i AFSh
	Jane Stojkov, mësimdhënës i AFSh, koordinator

Botuesi:
Shkolla Fillore me Qendër Resurse „Idnina“ - Shkup

Redaktore:
Lloreta Andreevska

Bashkëpunëtore profesionale:
Mr. Irena Bakrevska Milloshevska, Federata e Futbollit e Maqedonisë (FFM)

Autor i programit të aktiviteteve të futbollit:
Zoran Pançevski

Përkthimi: Lindita Daci, Adelina Haskaj

Shtypi: PRINT TIM SHPK SHKUP

Tirazhi: 100

Vendi dhe viti i botimit
Shkup, 2026



Me mbështetjen e Federatës së Futbollit të Maqedonisë (FFM)
dhe UEFA Foundation for Children (Fondacioni i UEFA-s për fëmijët)